



SUPLEMENTI "FUNDJAVA" ▶ Faqe 13-17

- **OLEN ÇEZARI: SI E SHOH SHQIPËRINË**
Violinisti me famë botërore flet pas koncertit në Romë
- **BISKOTA ME TËRSHËRË E PENE ME SPECIA**
"Luga e Argjendtë", receta e Dhurata Thanasit



Vrasja në Elbasan
24-vjeçarja e vvarë, vajza e kryekomunarit italian

▶ Faqe 9

[SHQIPTARJA.com]

LEKË 30 SHQIPTARJA.com + Suplementi "FUNDJVA"

VITI III - NR. 24 E premte, 01-02-2013

Fjalëkryqet e fundit nga Kadri Vokopola

▶ Faqe 23

MESAZHET E KOMENTUESVE

Statusi për miliarderët, akuza për qeverinë dhe familjen e kryeministrit

REVOLTE ANTI-BERISHE NE FB

"Duam punë, bukë, ujë dhe drita"

Postimi i kryeministrit kundër deputetit Fidel Ylli, komentuesit kundër: Shiko Lul Bashën, ministrat, Argitën. Analiza për heqjen e taksës mbi rogat, si fitojnë vetëm të pasurit ▶ Faqe 2-3

VIZITA E KRYEDIPLOMATIT NE SHQIPTARJA.COM

▶ Faqe 6



NË FOTO: Drejtoresha e Free & Fair Media Group, Alba Maltezi, drejtoresha e Shqiptarja.com, Anila Basha duke i treguar ambasadorit amerikan Arvizu numrin e ri të gazetës

Arvizu në Shqiptarja.com: Mbështes median e lirë
Intervista në "A1 Report": Pse ka rëndësi lëvizja "ACT Now" dhe si ka reaguar shoqëria shqiptare

Editorial



NGA ARBEN KROZHANI

Të vërtetat (jo)virtuale

Kryeministri Berisha dhe më pas vartësit e tij prej disa javësh po "takohen" me popullin përmes rrjetit social, Facebook. Idea është që të thithin sa më shumë hallet, shqetësimet dhe sugjerimet e atij që shihet si populli votues për përmirësimin e imazhit të një force politike qeverisëse, prej gati... ▶ vijon në faqe 22

Koment



NGA ADRI NURELLARI

Premtime pa këmbë mbi tokë

Filimi i vitit ka shënuar tashmë edhe nisjen e fushatës, dhe sikurse e do tashmë tradita tipike shqiptare parti të ndryshme kanë nisur të mobilizojnë anëtarësinë dhe të ndjellin votues duke shpalosur premtime nga më të ndryshmet. Duke qenë se gara premtion që të jetë goxha agresive... ▶ vijon në faqe 22

DENONCIMI

▶ Faqe 12



"Fiks Fare":
Fishekët shiten në dyqanet e bukës

BASHKKURTI ▶ Faqe 10-11

"Ramiz Alia nga shkolla e KGB, Sali Berisha një hipokrit"

VOTAT E KOALICIONIT OPOZITAR

Aleatët e Ramës: Duam 5 deputetë në listën e PS-së

Llogaritë e kërkesave të të vegjëlve. Dule: S'do jem me të majtë



TIRANE

JAKIN MARENA

Partitë aleate të PS priten që të propozojnë në kërkesat e tyre për Ramën dhe përfshirjen e emrave të krerëve të... ▶ Faqe 4-5

NERANXI

... gjithmonë një hap përpara...

Patatina Nachos dhe Meksikane shoqëruar me salcat dhe djathin përkatës

Adresa: Autostrada Tirana-Durrës, km 7, Yrëhekë Tirani. Tel: 042 406 500; 042 406 501; Fax: 042 406 502; e-mail: neranxi@neranxi.com; www.neranxi.com



Kryeministri i Bosnje-Hercegovinës viziton Shqipërinë

Kryeministri Berisha ka pritur dje Kaspidite kryeministrin e Federatës së Bosnje-Hercegovinës, Nermin Niksiç, i cili zhvilloi një vizitë zyrtare dyditore në vendin tonë. Pas ceremonisë zyrtare të pritjes, u zhvilluan bisedimet dypalëshe ndërmjet delegacioneve përkatëse nga të dy vendet. Në përfundim të bisedimeve, dy kryeministrat dhanë një prononcim të

përbashkët për mediat. Kryeministri Berisha e vlerësoi vizitën e kryeministrin Niksiç si tepër të rëndësishme dhe e konsideroi atë një nxitje të madhe në bashkëpunimin e mëtejshëm midis dy vendeve. "Me kryeministrin Niksiç identifikuam fusha të një interesi të madh të përbashkët bashkëpunimi. Fusha të tilla si turizmi, agrobiznesi,

energji paraqesin realisht mundësi shumë të mëdha bashkëpunimi midis dy vendeve", tha ai. Nga ana e vet, kryeministri boshnjak deklaroi se "ne e kemi marrë Shqipërinë si shembull në ndërtimin e infrastrukturës rrugore. Dëshiroj të shpreh kënaqësinë se edhe për këtë fushë ne kemi diskutuar dhe kemi shkëmbyer përvojat tona".

Statusi i kryeministrit Berisha, dyndje ankesash nga "fans"-at

'Duam punë, bukë, ujë' revolta në Facebook

"Kryeministri ta nisë anti-korrupsionin nga familja"

Lajmi

Kërkesa të shumta për punë dhe të ardhura më të mira kanë vërshuar në adresë të kryeministrit Sali Berisha, pasi ai ka ndarë me fansat e tij mendime lidhur me "miliardëre" në PS apo ndryshime në "taksën e sheshtë"



Statusi i kryeministrit Sali Berisha në Facebook dhe postimet e lexuesve

detyrë t'i bëni. Duhet të kishit bërë shumë më shumë se kaq!

Kupe Jani

Dil njëherë andej nga tregu, se 10 %-it të taksës i shtohet edhe një zero

Ernest Kokaj

Çfarë do të fitoj unë që nuk jam i punësuar dhe nuk arrij të marr as edhe një kredi të vogël për t'u ndërtuar fëmijëve të mi një strehë

Pashako Fatjon

Po ne, që jemi papunë akoma, do të bëhet gjë apo do të vuajmë akoma?

Gerit Shtylla Sofija

Po ndonjë vend pune për ne të papunët do të hapet?

Florenc Sula

O Sali, po për ne që jemi pa shtëpi, a ka ndonjë ndihmë të vogël?

Ilda Durrës

Po rrogën e policëve kur do e rrisni, se me rrogë minimale 300 mijë lekë dhe duke vdekur përditë nuk është gjë e mirë?

Artur Turi

Shiko na gjei ndonjë vend pune, o Sali, edhe me dy diploma nuk po gjejmë më punë

Petrit e Marjana Hotaj

O Salë, po premtimin e dëmshpërbimit të përmbytjeve në vitin 2010, kur do ta bësh realitet?

Edi Soni

Ore, do ta na i bësh këtë rrugën, ore burrë, se 12 km është?

Ilir Ranxha

Po për ne që jemi pa punë, si i bëhet?

Egri Aliaj

O zoti kryeministër, po andej nga Skrapari do vini ndonjë dorë për rregullime, se kemi ngelur mos më keq. Deri tani asgjë nuk po shohim të bëni për vendin tonë

Ergys Tafa

O zoti kryeministër, ne jetojmë në vitin 2013 dhe qyteti i Beratit nuk ka ujë me ditë të tëra. Populli i ka vajtur thika në palcë çdo ditë me cmi-met e larta e ju vetëm për vota e karrige diskutoni. Është gjynah nga zoti të katandiset populli në



këtë gjendje mjerimi, pa punë e pa rrogë, me çmime si në Evropë

Gjovalin Kura

Një pjesë e madhe e popullit shqiptar jeton në kushte të papranushme jetese, poshtë nivelit zero, çdo ditë në lajme shohim vrasje viktime te pafajshme

Përparim Doko

Nuk merret vesh, taksën 10% e vutë ju, tani po e hiqni; ku është sukses këtu? Kur të ze paniku i humbjes, del zbuluar pa e kuptuar. Ju qoftë rrugë e mbarë më 23 qershor

Bledar Kalia

Si e keni llogaritur rrogën mesatare 57 mijë lekë, kur vetë pohoni se ka rreth 215 mijë të punësuar që marrin deri në 30 mijë lekë, ose më pak?

Laura Liberto

Ka aq të papunë në Shqipëri, sa që nuk di kush realisht përfiton nga ky 10%! Sa të rinj kanë studiuar jashtë vendit e kur kthehen për të kontribuar me dije në vendin e tyre askujt nuk i intereson se ku ke studiuar apo nëse ke bërë 10 vite shkollë (+ master)

Altin Ukta

Ti ndoshta i shton me 10% rrogat, por desha të di se çfarë force ka monedha jonë në tregjet ndërkombëtare? Mjaft me këto premtime, që vetëm fëmijët mund të jenë. Njerëzit kanë më shumë se 10 vjet që po vdesin urie

TIRANE

GENC KONDI

Statusi i Kryeministrit Berisha i publikuar në Facebook mëngjesin e së enjtes, në lidhje me heqjen e mandatit të deputetit të partisë socialiste Fidel Ylli dhe propozimin e tij për ndryshimin e taksimit për pagat e ulta, ka marrë komente të shumta nga miqtë e tij në Facebook. Si rrallë herë, Facebook-u i kryeministrit ka pranuar dhe komentet negative të miqve të tij, që duket se ishin kaq të shumta në numër, sa administratorët e patën të vështirë t'i fshinin në kohë. Nuk dihet nëse, më pas, administratorët e faqes së kryeministrit do t'u bëjnë bllok këtyre fansave, siç kanë vepruar në të shumtën e rasteve. Sipas shumë komentuesve, kryeministri duhet ta fillojë luftën ndaj korrupsionit nga vetja. Ata akuzojnë se familja kryeministore po pasurohet çdo ditë në mënyrë abuzive. Sa më poshtë, janë përzgjedhur disa nga mesazhet kritike.

Marjeta Shkodranja

Të lutem, ujin në fshatin Krushkull, te Bashkia Sukth. Vdiqën nënat tona me karruçë, sa fola me të. Në këtë të ftohtë duke mbetur ujë... Je i madh, të duam shumë, gjithmonë kemi votuar për ty, po tani s'di çka të mendojmë

Niku Cool

Po na thuaj ndonjë gjë të bukur në mëngjes, z.kryeministër. Na thuaj ndonjë vend pune që hapet, ndonjë rritje rroge apo mirëqenie. S'na hyn në punë sa miliardëre ka Shqipëria, duam bukë, ujë, punë dhe mirëqenie.

Esjona Ejsi

Mirëmëngjes, zoti Sali Berisha. Të

gjithë deputetët në ditët e sotme janë bërë miliardëre, vetëm populli i shkrete mbeti rrugëve të kurbetit.

Erind Xhaka

Na thuaj ndonjë vend pune, se nuk na duhet sa miliardëre ka Shqipëria

Silvi Gresi

Çfarë thua? Kush është në pushtet dhe nuk është hajdut? Sa ishte PS, vodhi sa i donte qejfi, erdhët ju, më keq se ata : keni pushtuar gjithë pasurinë e Shqipërisë. Ke menduar veç për fëmijët e tu, z.Sali, po fëmijët e tjerë s'kanë bukë të hanë ; fëmijët e ngujuar nuk dinë se ç'do të bëhet me ta. Edhe ata duan të jetojnë siç jetojnë fëmijët apo nipat e tu.

Hyrjet Sinani

Të është lehtësuar puna z. SB, përmes FB do t'i zgjidhësh problemet e popullit tani. Lum si ju

Osman Alla

Z. Sali, sa mirë do kishte qenë sikur luftën kundër korrupsionit ta kishte filluar nga vetja, nga fëmijët e tu, se po pasuroheni aq shumë, sa për popullin nuk u vjen keq. Lere Fidelin, se ke plot si ai në kabinetin tënd apo dhe atë që bërë kryetar Bashkie në Tiranë.

Ermel Begaj

Po goca juaj nga e gjeti gjithë atë pasuri, apo me një rrogë 40.000 lekë në muaj? Ne po punojmë si familje e

nuk po ja dalim dot me ushqime e shkollime. Si mua ke dhe plot të tjerë, që as bukë s'kanë të hanë. Mjafton të vish e të shikosh listën e një furre buke.

Silvi Gresi

Z.Sali, zona e Dibrës ta ka dhënë votën, por ti e ke lënë pas dore: papunësia në maksimum, rrugët skandal, turp me i përmend, po turp ty dhe qeverisë tënde se nuk jeni për asgjë

Pavlin Leka

Mendimi im është që jeni një qeveri e paafte për të luftuar korrupsionin, duhet ta luftoni, se është e vetmja moto që ju solli në pushtet, me duar të pastra, që faktikisht nuk u pas-truan kurrë

Ilir Koxha

Po fëmijët e tu nga të dolën miliardëre? Apo ke trashëgime në Viçitold?

Jorgo Pano

Zoti Berisha, ne nuk na intereson Fidelin, por problemet e përditshme, që, pavarësisht dëshirës tuaj për t'i zgjidhur, ende janë të shumta

Denisa Xhepa

Nuk kishte pse të vihej taksa që në fillim të pagat e ulta. Tani, edhe pse ju thoni që nuk është për qëllim elektoral, është që ç'ke me të për qëllim elektoral. Dhe, ju lutem, mos u mburrni për gjëra që e keni për



8.4 për qind më pak pasagjerë në Rinas, Belle Air 50% të tregut

Trafiku ajror ka shënuar shifra negative gjatë vitit të kaluar. Kjo ka të bëjë me të gjithë sektorët e shërbimeve që ofron aeroporti ndërkombëtar në Rinas. Numri i pasagjerëve në Aeroportin Ndërkombëtar të Tiranës (TIA) pësoi një rënie me 8.4 përqindësh në vitin 2012, bëri të ditur dje njoftimi zyrtar i kompanisë gjermane, që ka nën

koncension aeroportin. Kjo është rënia e parë vjetore në trafikun e pasagjerëve, e regjistruar në aeroport, si pasojë e dukshme e krizës në fushën e fluturimeve apo të bizneseve në eurozonë, theksuan zyrtarët e aeroportit. Vitin e kaluar, 1.665.331 pasagjerë fluturuan nga TIA, në rënie ndaj 1.817.073 pasagjerëve që u regjistruan në vitin 2011. Ndërkohë,

lëvizjet e trafikut ajror ranë edhe ato në masën 10.7 për qind në krahasim me vitin 2011, ndërkohë që dërgesa e mallrave, një tregues i cili monitoron shëndetin e ekonomisë, ra me 14.9 për qind. Kompania ajrore që ka dominuar tregun e fluturimeve, duke rrëmbyer më shumë se gjysmën e tij (50.1 për qind), rezultoi të jetë ajo vendase "Belle Air".



Në foto: Kryeministri Sali Berisha, gjatë një takimi me elektoratin

Berisha korrighon disi goditjen ndaj pagave të ulta

Taksat, kush doli i fituar nga reforma

Rritja më e madhe e barrës, pagës mesatare

TIRANE

GENC KONDI

Me propozimin për të hequr tatimfitimin prej 10 përqindësh ndaj pagave më të ulta, deri në 30.000 lekë në muaj, qeveria korrighon, me shumë vonesë, një goditje, që u bëri në barrën fiskale të punësuarve që marrin më pak para se të tjerët. Kjo u vu në dukje nga specialistët që në momentin kur ka hyrë në fuqi taksat e sheshtë, e njëjlojtë për të gjithë, në vitin 2007, por u deshën 6 vjet që Berisha ta korrighonte për kategorinë me të ardhura më të ulta. Kjo masë u mor pa asnjë konsultim me grupet e interesit nga qeveria Berisha-1 dhe u paraqit si një pjesë e reformës fiskale lidhur me pagat e taksat. Pjesa tjetër, që vendosi paga referencë për çdo profesion, u shfuqizua vitin e kaluar.

Pas gjashtë vjetësh, në periudhë elektorale, qeveria ka marrë përsipër ta rishikojë pjesërisht edhe këtë taksë, nga e cila, sipas llogaritjeve, janë lehtësuar realisht pagat e larta, ndërkohë që pagat e ulta u detyruan të paguajnë më shumë taksat se sa paguanin me sistemin fiskal, që Berisha gjeti kur erdhi në pushtet dhe që parashikonte nivele të ndryshme taksimi për paga të ndryshme - taksat progresive, e vendosur që në kohën kur Berisha ishte president i Republikës dhe e kishte dekretuar vetë një ligj të tillë.

Taksa e sheshtë rriti më shumë barrë fiskale për pagën mesatare, atë 35.000 lekë, taksimi i së vilës me tatimfitimi u rrit, jo me përqindje, por me 2.9 herë, duke qenë se më parë taksat për këtë kategori ishte 1.190 lekë, por katori në 3.500 lekë në muaj. Po kështu, 2.2 herë më shumë tatohet deri tani 2.2 herë një pagë mujore 25.000 lekë (nga 690 lekë, në 1.500 lekë) apo 2.8 herë më shumë

TAKSA E SHESHTE	
Niveli i taksave mbi të ardhurat nga puna para dhe pas vendosjes së "taksës së sheshtë"	
ISHTE	Tatimi

0-14.000 lekë/muaj	1%
14.001-40.000	140 lekë + 5% të shumës mbi 14.000
40.001-90.000	1.440 + 10% të shumës mbi 40.000
90.001-200.000	6.440 + 15% të shumës mbi 90.000
Mbi 200.000	22.940 + 20% të shumës mbi 200.000

U BE	
Të ardhurat	Tatimi
0-10.000 lekë/muaj	0
10.001-30.000	10% të shumës mbi 10.000 lekë
Mbi 30.000	10% të totalit

SHEMBUJ PËR NDRYSHIMIN E BARRËS FISKALE PAS "TAKSËS SË SHESHTE"			
Paga (lekë)	Ishte	U bë	Ndryshimi
25.000	690	1.500	+2,2 herë
30.000	940	2.000	+2,2 herë
35.000	1.190	3.500	+2,9 herë
40.000	1.440	4.000	+2,8 herë
50.000	2.440	5.000	+2 herë
60.000	3.440	6.000	+1,75 herë
70.000	4.440	7.000	+1,6 herë
80.000	5.440	8.000	+1,5 herë
90.000	6.440	9.000	+1,4 herë
100.000	7.310	10.000	+1,37 herë
150.000	15.440	15.000	-3%
180.000	19.940	18.000	-9%
300.000	42.940	30.000	-30%
500.000	82.940	50.000	-40%

një pagë 40.000 lekëshe (nga 1.440 më parë, tatohet 4.000 lekë në muaj).

Në të kundërt, një pagë 150.000 lekëshe paguan 3 për qind më pak taksë se më parë, ndërkohë që diferenca sa vjen e rritet me rritjen e pagës. Kështu, arritjmë në 9% më pak tatimfitim për

një pagë 180 mijë lekë të reja, ku tatimi është 18.000 lekë, nga 19.940 që ishte më parë, apo 30 për qind më pak tatim për një pagë 300 mijë lekëshe (nga 42.940, në 30.000 lekë). Ndërkohë, një pagë prej 500 mijë lekësh, paguan 40 për qind më pak tatimfitimi.

? PYETJE PERGJIGJE

■ Kush janë pluset dhe minuset e taksimit të njëjlojtë për të gjithë?

Në dukje, kjo është një taksë e drejtë. Por, me taksimin progresiv paguajnë më shumë ata që kanë më shumë dhe një gjë të tillë e ushtrjnë shumica e vendeve të botës. Shumë vende nga ish-kampi komunist, në të kundërt, kanë adoptuar taksën e sheshtë në nivele të ndryshme. Në Shqipëri, u diskutua një nivel 17 për qind paraprakisht, më pas u vendos për nivelin 10 për qind për të gjitha pagat. Në fakt, pagat e ulta paguajnë më shumë se më parë, ndërkohë që paguajnë më pak më të pasurit. Sipas përkrahësve të taksës së sheshtë, një gjë e tillë u jep më shumë mundësi financiare bizneseve për punësim dhe investime, që sjell mirëqenien.


■ A kanë qenë konsultuar ekspertët ndërkombëtarë për adoptimin e taksës së sheshtë në Shqipëri?

"Reforma e qeverisë shqiptare për të vendosur taksën e sheshtë nuk është urgjente. Sistemi aktual i taksave në Republikën e Shqipërisë është i pranueshëm". Sipas ish-përgjegjësit për Shqipërinë në selinë qendrore të Fondit Monetar Ndërkombëtar në Washington, Istvan Szekely, e vetmja taksë që edhe mund të ndryshohet ishte ajo e punës ose taksat korporative. Këto deklarata u bënë në Tiranë në fund të prillit 2007. Kjo nuk e pengoi qeverinë të vijonte me këtë reformë.

Qeveria

Suzana Guxholli: Taksa e sheshtë është më pozitive

Heqja e tatim-fitimit prej 10 përqindësh për pagat deri në 30.000 lekë është një hap tjetër i qeverisë Berisha në ndihmë të popullsisë dhe njerëzve në nevojë dhe në përmirësimin e standardeve të jetesës, deklaroi dje këshilltarja e kryeministrit për politikë ekonomike, Suzana Guxholli. Kjo bëhet për të "vaksinuar" dhe imunizuar shqiptarët dhe ekonominë nga kriza dhe për të treguar se qeverisja Berisha vazhdon hapat përpara dhe të shpejta për të bërë Shqipërinë nga një vend në zhvillim, në një vend të zhvilluar, tha ajo, duke shtuar se kjo nisim është një mbështetje e fuqishme që



Suzana Guxholli

i bëhet biznesit.

"Rimbursimi i kapitalit dhe rritja e të ardhurave krijojnë kushte për rritjen e punësimit në vend", theksoi Guxholli, duke thënë se afërsisht 120 mijë të punësuar në fasonë përfitojnë nga nisma e qeverisë Berisha.



PSE, Hannes Swoboda:
Shqipëria, nevojë për
ndryshim qeverisjeje

Drejtuesit e Grupit Parlamentar të PS Gramoz Ruçi e Taulant Balla morën pjesë në mbledhjen e Grupit Socialist e Demokrat në PE ku ishin të ftuar dhe drejtuesit të grupeve parlamentare të partive të majta nga gjithë vendet e Ballkanit. "Në dallim nga e djathta evropiane, ne mendojmë se BE duhet të vazhdojë zgjerimin dhe me vendet e Ballkanit Perëndimor", tha presidenti i Grupit Swoboda. Ai nënvizoi se

Shqipëria ka nevojë për ndryshim të qeverisjes dhe se zgjedhjet e këtij viti kanë një rëndësi të madhe për euroin dhe procesit të integritimit. Ndërkohë Fajon shprehu shqetësimin se disa vende anëtare të BE po kërkojnë rivendosjen e vizave për në disa vende të Ballkanit. Ndërsa Ruçi tha se qytetarët shqiptarë kanë respektuar në tërësi kushtet e lëvizjes së lirë dhe numri i azilkërkuessve nga Shqipëria është i pakonsiderueshëm në krahasim me vendet e

tjera. Ruçi foli për rritjen e retorikës nacionaliste në Shqipëri, dhe se Berisha po mundohet të kapet me dëshpërim pas fantazmës së nacionalizmit primitiv ballkanik. Ndërkohë i njohu eurodeputetët edhe me problematikat që lidhen me përgatitjen e procesit zgjedhor të 23 qershorit dhe përsëritet angazhimin e Parlamentit Europian për monitorimin e këtyre zgjedhjeve.

Partitë e koalicionit opozitar pa PDK e PBDNJ, 190 mijë vota më 8 maj 2011

Aleatët e Ramës: Emrat në listat prioritare të PS

Llogaritja, 5 deputetë. Mungesa e garancisë çoi Ndokën te Berisha

Lajmi

Partitë aleate të PS pritet që të propozojnë në kërkesat e tyre për Ramën dhe përfshirjen e emrave të krerëve të tyre në listat e PS në pozicione prioritare në mënyrë që të luftojnë pastaj për një mandat të dytë. Pritet të vendoset dhe rezultati që garanton post ministri.



juar qeverinë e re. Mësohet se do të kërkohet dhe vendosja e një dyshemeje limit për aleatët, ku në bazë të rezulttit të zgjedhjeve të 23 qershorit të përcaktohet pjesëmarrja në bashkëqeverisje me post ministri, zv.ministri drejtor drejtorie e me radhë. Debatit është përqëndruar tek kjo dysheme, ku mësohet se do jetë rezultati prej 25 mijë votash për secilin parti që ajo të përfaqësohet në rang ministri, ndërsa poshtë këtij rezultati përcaktohen nivelet e tjera të qeverisjes. Duke parë rezultatet e zgjedhjeve parlamentare të 2009 dhe atyre



vendore të 2011 mendohet se vetëm 3-4 parti mund të tejkalojnë këtë shifër dysheme për të patur një portofol ministror. Duke u rikthyer problemit të

TIRANE
JAKIN MARENA

Kuvend e disa prej krerëve të partive kryesore të Kuvendit. Nën zë është diskutuar se krerët e PSD, PDS, PSV 91, por dhe Ngjela e kreu i G99 Mete do të kërkojnë përfshirjen e emrit në listat e PS për të pasur të sigurtë

një deputet dhe më pas të luftojnë për deputetin e dytë. Pasi sipas tyre bashkë me aleatët e vegjël ata arrijnë të marrin gjashtë 6 deputetë që janë rezultat neto për PS për të kri-

Partitë përbërëse të koalicionit opozitar që pritet të firmosin së shpejti marrëveshjen me kryetarin socialist Edi Rama, pritet të zhvillojnë një takim tjetër. Duke qënë se në takimin e fundit kreu i PS kishte kërkuar, mbështetur nga vetë krerët e partive opozitare, që kërkesat e tyre të ishin konkrete, paralel dhe me angazhimin për fushatën zgjedhore, partitë aleate të PS tashmë i kanë formatuar përgjithësisht kërkesat dhe detyrimet e tyre ndaj koalicionit të prishëm. Kështu mbështetur dhe në rezultatet e zgjedhjeve të fundit për pushtetin vendor të 2011, por dhe ato parlamentare të 2009 krerët aleatë llogarisin që në zgjedhjet e kënaqeshme për 6 mandate de-

"Bashkë me aleatët e vegjël ata arrijnë të marrin gjashtë 6 deputetë që janë rezultat neto për PS për të krijuar qeverinë e re"

puteti. Pavarësisht se janë 26 parti aleate deri më tani që i janë bashkuar PS, përfshirë këtu dhe partitë që kanë vota siç janë PSD e Gjinushit, PDS e Milos, PSV 91 e Koçit por dhe G99 apo partia e Ngjelës, numri i votave që kanë marrë në zgjedhjet e fundit për pushtetin vendor është mbi 190 mijë, një shifër modeste kjo për një koalicion aq të gjërë. Por pikërisht mbi këtë bazë, partitë me sa duket kanë mbështetur dhe kërkesat e tyre, ku pritet që pikë e parë të jetë përfshirja në

LISTA E PARTIVE NË KOALICIONIN OPOZITAR, 8 MAJ 2011

Partia Socialiste	Edi Rama	432.823 vota
Partia Komuniste Shqiptare	Qemal Cicollari	2.000 vota
Partia e Punës Shqiptare e Reformuar	Marko Dajti	4.066 vota
Partia Komuniste Shqiptare e Reformuar	Preng Cuni	2.150 vota
Partia e Bashkimit Republikan Shqiptar	Zane Llazhi	4.211 vota
Partia për Prosperitet Demokratike	Izeir Fetahu	3.062 vota
Partia Socialiste e Vërtetë 91	Petro Koçi	23.617 vota
Partia Socialiste e Moderuar	Gjergj Koja	5.988 vota
Partia Aleanca Arbnore Kombëtare	Gjet Ndoj	9.227 vota
Partia për Unitet Kombëtar	Idajet Beqiri	4.618 vota
Lëvizja për Drejtësi e Shqiptarëve	Astrit Kosturi	540 vota
Partia e Gjelbër PGJ	Edlir Petanaj	8.448 vota
Partia e Çështjeve Shqiptare	Bujar Shurdhi	366 vota
Partia G99	Ervin Mete	15.265 vota
Partia Ardhmëria Shqiptare	Emin Subashi	2.503 vota
Partia Demokracia Sociale	Paskal Milo	53.203 vota
Partia për Drejtat e Emigrantëve	Ymer Kurti	860 vota
Partia Ligj dhe Drejtësi	Spartak Ngjela	7.782 vota
Partia Rrugë e Lirisë	Kurt Kola	1.355 vota
Partia kristian Demokratike	Dhimitër Muslia	495 vota
Partia për Mbrojtjen e Punëtorëve	Adri Isufaj	389 vota
Partia Reformatore Demokratike	Skënder Halili	1.653 vota
Partia Toleranca e Re e Shqipërisë	Avdi Keci	700 vota
Partia Demokratike e Bashkimit	Mysliman Sabri Jacaj	1.726 vota
Partia Demokratike për Integrim e Prosperitet	Halim Seitaj	74 vota
Partia Socialdemokratike	Skënder Gjinushi	43.828 vota
Partia e Punës së Shqipërisë	Muharrem Xhafaj	2.100 vota

KANË IKUR NGA KOALICIONI

Partia Demokristiane	Nard Ndoka	47.930 vota
PBDNJ	Vangjel Dule	40.710 vota



VITI 2011

- Në proporcional**
671.612 vota
- Aleatët me PDK**
219 785 vota
- Aleatët me PBDNJ**
260 585 vota
- Ikin**
47 mijë vota të PDK
- Aleatët e rinj**
11 mijë vota
- Aleatët tani**
190 mijë vota

përfshirjes së krerëve të partive aleatet në listat e PS në vende të sigurta për deputetë, mësohet se pikërisht ngurrimi i kreu të PS Rama asokohe për të pranuar këtë formulë bëri që kreu i PDK Nard Ndoka të largohet nga koalicioni, pasi vendin e sigurte në Kuvend ia garantoi Berisha. Madje Ndoka e ka deklaruar publikisht në fakt të tillë, duke nënvizuar faktin se Rama nuk e garantoi se do përfaqësohej partia e tij në Kuvend, pavarësisht se në zgjedhjet vendore të 8 majit 2011, PDK ka marrë mbi 47 mijë vota. Vajten e detyruar të Ndokës te Berisha e tregon dhe fakti se pavarësisht se tashmë është zv.ministër i Brendshëm në qeverinë e djathtë, në pushtetin vendor asnjë prej këshilltarëve të PDK nuk ka kaluar djathtas, duke mos prishur koalicionin me PS. Çka tregon se ndoshta vendimi për përfshirjen e krerëve aleatë në listat e PS mund të funksionojë dhe për PDK në të ardhmen. Pa përfshirjen aleancat parcale me PBDNJ e Vangjel Dules që ka marrë në zgjedhjet e fundit mbi 40 mijë vota.



AK: Mandatet i çojmë në Kushtetuese. Do mbrojmë zgjedhjet

Aleanca Kuq e Zi ka reaguar pas vendimit të Kuvendit, që me votat e mazhorancës la në fuqi shpërndarjen e mandateve të deputetëve sipas vitit 2009. Aleanca ka thënë se koalicioni i tradhtarëve po shkatërrohet zgjedhjet, duke mos dëgjuar apelin e ambasadorit amerikan, Arvizu. Partia e drejtuar nga ana e Kreshnik Spahiut ka thënë se do t'i drejtohet Kushtetueses për ta hedhur poshtë këtë

vendim. "Aleanca Kuq e Zi reagon ashpër për ndarjen e mandateve nga Kuvendi sipas skemës së vitit 2009. AK i cilëson atentatorë të Kushtetutës 72 deputetë e Parlamentit Shqiptar, që votuan pro ndarjes së mandateve nga Kuvendi e jo KQZ", thuhet në deklaratë. Sipas AK koalicioni i tradhtarëve po shkatërrohet zgjedhjet e 23 qershorit. "Kuvendi shpërfilli mesazhin e ambasadorit të SHBA,

Arvizu për këtë çështje kaq të ndjeshme për të ardhmen e vendit dhe themelet e demokracisë. AK do t'i drejtohet Gjykatës Kushtetuese për pezullimin e këtij vendimi, që cenon rëndë themelet e demokracisë dhe ku shqiptarëve i mohohet e drejta për të votuar si barabartë. Me standardin e miratuar nga Kuvendi dy vota në Tiranë janë të barabarta me një votë në Tropojë", thuhet në deklaratën e Aleancës Kuq e Zi.



Miratimi

Në zgjedhje me ndarjen e mandateve të 2009, PS: Po vriten zgjedhjet që tani

■■■ TIRANE

Vendi do të shkojë në zgjedhje si pas ndarjes së deputetëve më 2009. LSI, PDIU e ish-deputeti i PS Islami kanë bashkuar votat me PD për të lënë në fuqi ndarjen e deputetëve sipas zgjedhjeve të shkuara, duke bërë që vendimi i shumdebatur të marrë 72 vota pro, votën kundër të PS, ndër- sa Dule abstencion, kurse numri dy i FRD Oketa s'mori pjesë. PD refuzoi ofertën e PS për konsensus në ndarjen e re të mandateve. "Të mos e votojmë sot, të vazhdojmë ashtu sikurse kemi patur të gjithë precedentët parlamentarë, të përafrojmë qëndrimet tona politike, në zbatim të Kushtetutës, ndryshe e kemi kompromentuar procesin zgjedhor të 2013 që sot",



Gramoz Ruçi

tha kreu i grupit të PS Ruçi. "Kuvendi e ka deleguar me vullnet konsensual administrimin e zgjedhjeve të një institucioni tjetër. Mos e bllokoni atë njësoj si statusin ", tha kreu i grupit të PD Pa-

tozi. Opozita deklaroi se ky vendim, që sot i bën zgjedhjet të pabarabarta, duke shkelur nenin kushtetues se çdo votë ka të njëjtën peshë. "Çfarë po bëni? Po prodhoni edhe një produkt të paligjshëm që në fillim. Po ndani mandate në kundërshtim me barazinë e votës, po ndani mandate ku qytetarë e Durrësit dhe të Tiranës, 60 mijë qytetarë janë të papërfaqësuar politikisht", tha Gjijnuri. N Alibeaj tha se duke kërkuar heqjen e një deputeti në Berat PS kërkon të penalizojë LSI. Blushi nënvizon se "ajo që ju bëni sot është njësoj si një kampionat futboll, që ai ka fituar, vendos për rregullat e kampionatit të ri". Ndërsa Klosi tha se "Mungesa e kryeministrit në sallë si ideator e autorit e realizues i këtij procesi, është arsyeja e mbi mijë arsyeje për të dëshmuar një largesë më të madhe nga konsensusi mes dy forcave politike".

Kreu i PBDNJ paralajmëron aleancë më vete me 2-3 parti politike

Dule: S'do jem pjesë e koalicionit të majtë

"Bërja opozitë, me PS ndajmë qëndrime të ndryshme"

■■■ TIRANE

JAKIN MARENA

Partia Bashkimi për të Drejtat e Njeriut nuk do të jetë pjesë e koalicionit të majtë në zgjedhjet e 23 qershorit. Një fakt i tillë është zyrtarizuar dje nga kreu i PBDNJ, Vangjel Dule, teksa ka komentuar dhe arsyet e pamundësisë së një aleançe të tillë parazgjedhore qoftë dhe rajonale. Në deklarinim për mediat, Dule shprehet se PBDNJ do të krijojë koalicion më vete me dy ose tre parti të tjera, emrat e të cilave nuk i ka bërë të ditur. Lidhur me ndarjen nga PS, Dule shprehet se me këtë forcë politike, kanë pasur shumë qëndrime të ndryshme për çështje të caktuara. Duke mos pranuar ta quajë veten aleat të PS, por thjesht një opozitar, Dule kritikon pa rezervë PS për mënyrën sesi ka drejtuar opozitën këto vitet e fundit. "Ne për disa aspekte, shpesh herë të parëndësishme, ndajmë qëndrime të ndryshme me PS. Edhe për mënyrën e të bërit opozitë, ne kemi kërkuar një opozitë më koherente, me një vizion strategjik dhe taktika koherente dhe efikase. Gjë që ka munguar. I takonte asaj që ta kishte orientuar aktivitetin opozitar në drejtime të tjera, që do ta kishin vënë në pozitë shumë më të vështirë sesa është sot qeverinë", shprehet Dule. Ai ka nënvizuar se mënyra sesi

Sarandë

Tre këshilltarë të PS-së deklaruan aderimin në LSI

Tre këshilltarë të PS kanë ikur drejt LSI. Kjo është bërë publike nga kryetari i këshillit bashkiak, Ilir Nikolla, në mbledhjen e djeshme. Ai tha se me këtë ndryshim të përkatësisë politike të këshilltarëve Enkelejdja Vasili, Delfin Hajno dhe Hajri Goxhaj, këshilli bashkiak pëson konfigurim të ri. Disa këshilltarë socialistë e kanë konsideruar këtë vendim të kolegëve të tyre si deformim të votës së PS nga këta këshilltarë. Të njëjtin deklarinim 3 këshilltarë e kanë paraqitur edhe në kryesinë e degës së PS në Sarandë.

PS bërë opozitë gjatë viteve të fundit ka dhënë kosto për partitë aleate, por edhe kosto për vendin. "Partia Socialiste gjatë këty 4-vjeçarit, nuk dha shumë beteja politike dhe disa beteja të tjera, i dha vetëm pjesërisht dhe këto, sigurisht që kanë dhënë efektet e tyre në këto katër vite, që u janë fatuar

partive respektive. Por ajo çka është më e rëndësishme, u janë fatuar zhvillimeve politike", tha Dule. Kreu i PBDNJ-së komentoi dhe koalicionin e ri ku do të marrë pjesë, por pa dhënë detaje për emrat dhe kahet politike të cilëve u përkasin këto parti, gjë që ka preferuar ta bëjë me dije pak më vonë.



Edi Rama dhe Vangjel Dule

Largimet

PS-ja pritet të shkojë në zgjedhjet e 23 qershorit me 26 parti politike, ndërkohe që nga koalicioni i saj pas vitit 2009, është larguar PBDNJ dhe PDK e Ndokës, që do të jetë pjesë e koalicionit qeverisës, në zgjedhjet e ardhshme.

të cilin është shumë e rëndësishme që të realizohet një ide e tillë që ka qënë një qëllim i kahershme për të kryesuar një koalicion parazgjedhor me parti të tjera politike. Por deklarata e Dules ka intriguar me të vërtetë ambientin politik në vend, pasi ai refuzon koalicionin me PDIU të Idrizit dhe me AK të Spahiut. Por Idrizi është

drejt një koalicioni me Metën, duke përfshirë mundësinë e një aleançe PBDNJ-LSI. Kreu i PBDNJ-së ndalet dhe në situatën politike në vend. Dule shprehet se dy forcat kryesore politike, duhet që të kishin gjetur kohë më përpara konsensusin, për procesin e integritimit. "Duhet të ishte gjetur kohë më parë konsensusi mes dy aktorëve më të mëdhenj të politikës, PD dhe PS dhe me konsensus integritimi i vendit të ishte vendosur mbi ballafaqimin politik të ditës", tha dje kreu i PBDNJ-së, Vangjel Dule. Partia Socialiste organizoi pak ditë më parë tryezën e partive të koalicionit, por në këtë tryezë mungoi Dule, mungesë që u argumentuar me problemet personale të tij.



Rama: Politikës i rrija larg, tani ajo më mori sportin për ndryshimin

Mua ma mori sportin politika, i rrija larg se nuk i duroja dot as erën, politikës", kështu hapi zemrën para të rinjve të FRESH, kryetari i PS Edi Rama gjatë aktivitetit kushtuar sportit. Sipas tij ky mendim i tij i dikurshëm mori rrjedhë tjetër sepse, hyrja në politikë ka një qëllim, bërjen të mundur të gjërave. "Por, politika si një pasion i brendshëm i çdo njeriu që dëshiron të bëjë gjithçka që

gjërat të ndryshojnë që fundi i viteve 80, vigjilja e viteve 90 dhe instikti i ndryshimi, era e ndryshimit e sigurisht dëshira për ndryshimin dhe unë kështu preferova në vend të merresha me sport çdo ditë, i dedikohesha kësaj pjese që ishte komplementare me aktivitetin politik", tha Rama. Kreu i selisë rozë nuk ka kursyer edhe batutat, teksa ka ndarë me të pranishmit përvojën e tij si

ish-basketbollist. "Asokohe njerëzit si unë të gjatë ishin pak, numëroreshin me numra dhe kriter ishte gjatësia, nëse ishe i gjatë ishe edhe futbollist. Fideli do mbetet një yll në sport, ndërsa unë isha dhe do mbetet një i gjatë që shikoja yjet. Megjithëse disa miq të mi mendojnë se po ta vazhdoja sportin do kisha arritur të kapja yjet, unë se besoj këtë gjë.", tha Rama.

Mesazhi i diplomatit amerikan me "Act Now" për A1 Report: Po ju mundeni

TIRANE

EDVIN PARRUCA

Ambasadori Amerikan Aleksandër Arvizu vizitoi dje ambientet e gazetës Shqiptarja.com dhe televizionit A1Report duke u njohur nga afër me punën e gazetarëve në këtë media e duke u ndalur me shumë në gazetarinë investigative. Ambasadori amerikan Aleksandër Arvizu përshëndeti stafin e gazetës shqiptarja.com, për çështjen e investimit të lajmit ndërkohë që premtoi pas kërkesës së shqiptarja.com, se shumë shpejt do të ndihmojë me asistencë në fushat e diskutuara. Ndërkohë ai në studion e A1Report ka folur për nismën Act Now dhe impaktin që ka pasur në publik.



Në foto: Drejtoresha e Free & Fair Media Group, Alba Malltezi, drejtoresha e Shqiptarja.com, Anila Basha duke i regjurguar ambasadorit amerikan Arvizu numrin e ri të gazetës

oni do ti jepet një çmim nga ambasadori. Ne shpresojmë që duke spikatur këto aktivitete, këto organizata ose këta njerëz, do të inkurajojnë të tjerët që të frymëzohen e të dalin e të bëjnë të njëjtin gjë...dhe nis me projekte të vogla, si një stacion autobusi.

Zoti ambasador ju e nisët nismën Act Now me një fjalim të stilit Unë kam një ëndërr, që bëri shumë përshtypje në opinionin publik. Si mendoni se do të jetë falimi në fund?

Është vështirë të krahasohesh me Martin Luther King, por e vlerësoj shumë atë mendim dhe ndjenjë dhe në fakt ka një lidhje, pasi Doktor King foli vërtetë për një ëndërr, dhe shiko se sa shumë ka përparuar SHBA që nga koha kur ai mbajti atë fjalim. Kështu që këtu në Shqipëri mendoj se do të ishte, përta të paktën një temë të përshatshme, parrulla e Presidentit Obama në fushatën e 2008: Yes we can (Po ne mundemi) sidomos kur flasim për të rinjtë dhe sic përmendi më parë [Zonja Barnhan, gjëja e këndshme e këtij projekti është bashkëpunimi mes një OJQ-je shumë të angazhuar, një komune e cila ishte gjithashtu e përkushtuar, por edhe Universitetit Polilis, përfshirë këtu profesorët dhe studentët. Pra PO, ju mundeni të ndryshoni mënyrën se si ju mund të ndjeheni për veten, vendin tuaj dhe qeverinë tuaj.

Janë këto gjëra të vogla që do të prodhojnë ndryshimin për të cilin Shqipëria ka nevojë.

Zonja Barnheart, cilat kanë qenë vështirë të mënda në këtë periudhë: kur ju keni thënë se është e pamundur?

Ndoshta sfida më e madhe me të cilën ne po përballlemi deri tani përta i përkritet kësaj iniciativë është cinizmi. Ndjenja që njerëzit nuk mund të bëjnë ndryshime, nuk mund të ndikojnë qeverinë, nuk mund të ndikojnë mënyrën si jetojnë në komunitet e tyre pasi kjo është thjesht mënyra se si shkojnë gjërat. Ajo çfarë ne duam të bëjmë është që të vejmë në pah se këto ndryshime të vogla ndikojnë për të sjellë ndryshime në shoqëri. Kur njerëzit të ndjehen se e kanë fuqinë për të bashkëpunuar me të tjerët dhe me autoritetet e tyre, atëherë këtu do të fillojmë të shikojmë ndryshimin. Kjo për mua është sfida më e madhe dhe me këtë nismë të ambasadorit le të punojmë së bashku me popullin shqiptar.

Nuk më ngelet tju uroj suksese ju dhe gjithë qytetarëve shqiptarë që do të angazhohen në këtë iniciativë dhe ju falenderoj shumë për praninë tuaj në studio.

Ambasadori: Ju falemdierit shumë që na dhatë mundësinë për të shpjeguar këtë iniciativë.

Ambasadori Arvizu në zyrat e Shqiptarja.com

Diplomati në takime me drejtuesit e medias, dhe dëgjon shqetësimet e tyre

I ftuar në studion tonë është ambasadori amerikan në Tiranë Arvizu dhe kordinatorja e projektit Act Now, Susan Bernhardt. Ju vini këtu nga Kashari ku keni qenë një stacion autobusi të veçantë dhe doja tju pyesja pse sot keni qënë atje.

Susan Bernhardt: Ne jemi shumë të lumtur që sot shpallëm kampionin e parë të Act Now dhe grupi quhet "Co-PLAN" dhe në bashkëpunim me komunën e Kasharit, kanë krijuar një plan për të ndëratur së bashku një stacion autobusi pranë Universitetit që gjithashtu është përfshirë në projekt, që duket i vogël por është e një rëndësie të veçantë dhe në fakt janë gjërat e vogla që na frymëzojnë për të punuar së bashku.

Zoti ambasador, ju i nihni shqiptarët dhe kam në mendje disa njerëz që do të thonë gjithë kjo bujë për Act Now dhe kampionë janë disa shishe plastike. Çfarë ka kaq të rëndësishme ky stacion autobusi?

Ambasadori: Kjo është një pyetje e shkëlqyer. Ne kemi lanuar këtë nismë para 6 muajve dhe sikur në çdo projekt ose në ide duhet kohë për të shpjeguar se çfarë po bëjmë me njëri tjetrin dhe kush është tema e veçantë. Që projekti të ketë sukses nuk është e rëndësishme se si ndihet ambasada por se si ndihen shqiptarët

Ju në Facebook testoni vazhdimisht publikun me pyetje...

Ambasadori: Ne kemi një kategori në faqen tonë të fb dhe ku kemi 25 mijë ndjekës dhe e di që shumë prej tyre vizitojnë faqen e Act Now. Jemi shumë krenarë që faqja jonë në fb shërben si forum, ku njerëzit shkëmbejnë këto ide dhe siq tha Zonja Barnheart, ajo se çfarë po përpiqemi të bëjmë është të promovojmë konceptin dhe nocionin e përfshirjes aktive të qytetarëve në komunitet, qoftë ai i

vogël apo i madh si Tirana.

Njerëzit identifikojnë problemet dhe shqetësimet duke punuar së bashku me autoritetet dhe OJQ-të dhe kjo është në fakt thelbi i Act Now: që demokracia në Shqipëri mund të forcohet vetëm përmes pjesëmarrjes aktive të qytetarëve. Dhe nuk po flasim vetëm për zgjedhjet kur zakonisht njerëzit janë shumë aktivë. Kjo është fantastike dhe shumë e rëndësishme. Por ajo ku po përqëndrohemi është qeverisja dhe kjo është një marrëdhënie mes aktorëve qeverisës lokalë e qëndror dhe qytetarëve.

Përpara se të kthehem sërisht tek Zonja Bernhardt, një tjetër pyetje për zotin ambasador. A mendoni që ka një ndryshim mentaliteti midis mënyrës së demokracisë në SHBA ku gjërat janë krijuar nga pjesëmarrja lokale e cila ndryshon dhe me aktivizmin në Europë që është më gjeneralë, me ide politike më të mëda, dhe në Shqipëri? Sa kohë duhet për të aplikuar filosofinë mendo globalisht, ve-pro lokalisht?

Ambasadori: Kjo është një pyetje e shkëlqyer. Ekzistojnë disa probleme që lehtësisht mund të politizohen: kemi partizanë si në Shqipëri, SHBA dhe

Europë, por ekzistojnë shumë probleme dhe çështje të cilat u përkasin të gjithëve dhe shembulli më i mirë që në SHBA kemi është organizimin e nënave kundër ngjarjes së makinave në gjëndje të dehur. Kjo është një çështje që prek si demokratët dhe republikanët dhe ky është një grup nënash që kanë humbur fëmijët e tyre dhe ato kanë mundur të ushtrojnë presion mbi qeverinë vendore dhe partitë dhe kjo është një nga gjërat që unë shpresoj me të vërtetë se mund të bëjmë edhe në Shqipëri. Le të mar-

rim shembullin e dhunës në familje që prek të gjithë, qofshin blu apo rozë. Pra nuk ka arsye pse njerëzit nuk mund të mblidhen së bashku për çështje si kjo.

Zonja Bernhardt, si do të vazhdojë kjo praktikë e shpalljes se një kampioni?

Ajo që shpresojmë të bëjmë është të marrim nga shqiptarët, nga qytetarët, nga ata persona që po punojnë në mënyrë aktive në komunitet e tyre, që të mund të përfshijnë autoritetet në planet e tyre dhe është kjo lloj bisede që zhvillohet mes palëve. Çfarë do që të zhvillohet prej kësaj është diccka estra që do të burojë. Por ajo që ka rëndësi është që qytetarët mund të mblidhen së bashku pavarësisht nga orientimet e tyre politike dhe për shkak se ne e duam Shqipërinë, duam të punojmë për diccka të mirë. Dhe për ta bërë këtë, duhet ti kërkojmë llogari qeverisë tonë, për shembull të lidhje me spitalet, shkollat, forcat e policisë, për mblidhjen e mbeturinave dhe për çfarë çdo lloj gjëje që na intereson, ne duhet të punojmë së bashku me qeverinë, në mënyrë që të përmisojmë diccka në komunitetin ku jetojnë. Dhe ajo që ne shpresojmë të bëjmë është të spikatim gjatë gjithë vitit, kështu çdo muaj do të zgjedhim një kampion dhe atij kampi-



Në foto: Ambasadori Arvizu dhe Drejtoresha e Shqiptarja.com, Anila Basha



Tenderi

Ende i bllokuar projekti i linjës Kosovë-Shqipëri

■ ■ ■ TIRANE

Vendimi për ndërtimin e linjës së re të rrethimit të Shqipërisë dhe Kosovës pritet ende të merret. Zyrtarë gjermanë kanë konfirmuar dje se ende po vazhdojnë bisedimet me qeverinë shqiptare për zgjidhjen e kësaj çështjeje. Sipas tyre, Edmond Haxhinasto,



kreu i METE-s ka premtuar se do të gjendet një zgjidhje në lidhje me këtë çështje. Linja 400 kV Tiranë-Prishtinë, ndonëse kanë kaluar më shumë se dy vjet nga zhvillimi i tenderit për ndërtimin e saj, është bllokuar nga pala shqiptare në muajin tetor. Qeveria pretendoi se, kompania fituese ofroi një vlerë 24% më të lartë se kompania e

dytë pjesëmarrëse në tender. Ndërsa opozita deklaroi se punimet për ndërtimin e linjës po vonohen qëllimisht, për të mbrojtur interesat e kompanive serbe në shpërndarjen e energjisë. Linja do të ulte ndjeshëm varësinë e Shqipërisë dhe Kosovës nga linjat serbe dhe çmime më të ulëta në treg për importin e energjisë.

"Berisha shkeli ligjet në favor të Fazllicit"

Braçe: Porto Romano nën pushtim serb

Akuzat, pas deklaratave të Zafar Ansar

Lajmi

Sipas deputetit socialist Erjon Braçe, qeveria u ka krijuar kushte ekskluzive investimeve të kryera nga biznesmeni boshnjak Damir Fazllic në Porto Romano, falë lidhjeve të tij me të bijën e kryeministrit

■ ■ ■ TIRANE

GENC KONDI

Deputeti i Partisë Socialiste Erjon Braçe ka vijuar denoncimin e asaj që ai e quajti "zaptimi serb i Porto Romanos". Në një postim në Facebook, Braçe publikoi një dokument të ri, i cili paraqet hollësisht pronën, në një sipërfaqe prej 80 mijë metrash katrorë, të blerë nga "Crown Acquisitions", kompania në pronësi të biznesmenit boshnjak Damir Fazllic. Braçe ngre sërish pyetjet për vazhden e kryeministrit, Argita Berisha-Malltezi: "Si e mori në pronësi tokën Damir Fazllic? E bleu? Kujt ja bleu? Ai është shtetas i huaj? A është në përputhje me ligjin kjo procedurë përfitimi e pronësisë? Po tarifë suksesi për lejen e qeverisë a pagoi? Ku? Kujt? Sa ishte vlera?", thotë ai. Braçe thekson se terminali i naftës dhe gazit i kompanisë së Damir Fazllicit shtrihet buzë hekurudhës së re, me një degëzim të posaçëm për të; buzë rrugës së re, që lidh autostradën, Portin e Durrësit me këtë rajon, brenda Parkut Energjetik të Porto Romanos. "Të gjitha, lehtësi infrastrukturore të financuara me para publike dhe vendime të Qeverisë!", shprehet deputeti opozitar.

Skandal i për pronën në Porto Romano shpërtheu pas denoncimeve në Top Channel të biznesmenit pakistanez Zafar Ansar. Ai deklaroi se në Shqipëri donte të blinte fillimisht ish-Bankën e Kursimeve dhe më pas Ansar nisi eksplorimin e mundësive për të investuar në energjetikë. Në kuadër të kësaj, atij i është ofruar toka për ndërtimin e një TEC-i me nafte në Porto Romano. Për konsulentë ligjore në realizimin e projektit, biznesmeni pakistan-

Punësimi

Pas Katarit, shqiptarët mundësi edhe në Izrael

Shqiptarët do të kenë mundësi që të punësohen edhe në Izrael. Ministria e Punës është duke përgatitur marrëveshjen dypalëshe, që do t'i hapë dritën jeshile këtij projekti. Pala izraelite ka shprehur miratimin e saj nëpërmjet ambasadorit David Cohen. Gjatë 2012-ës, nga zbatimi i marrëveshjes së punësimit me Italinë përfituan mbi 400 shtetas shqiptarë, ndërsa u është hapur rruga punësimit të infermierëve shqiptarë në Gjermani dhe një marrëveshje u lidh edhe me Katarin.

ez ka kontaktuar, me ndërmjetësimin e ambasadorit shqiptar në Arabinë Saudite, Argita Malltezi. "Argita më ofroi shërbimet e saj dhe unë rashë dakord të bashkëpunoja me të. Ajo më dërgoi marrëveshjen për të siguruar pagesat e saja për

shërbimet ligjore, ku kërkonte edhe 3% si tarifë suksesi. Unë nuk e nënshkrova këtë marrëveshje pasi e konsiderova si rryshfet. Projekti im u arkivua jo nga kërkesat ekskluzive, apo çështje të naftës, por sepse nuk pranova kërkesat", deklaroi ai.



Harta e pronës së kompanisë së Damir Fazllicit në parkun Energjetik të Porto Romanos



KABINETI SALAJ

APARATE DËGJIMI

Mbi bazën e një experience 10-vjecare në fushën e vendosjes së APARATEVE të dëgjimit kabineti "SALAJ" ju vjen në ndihmë në këto shërbime:

- Matjen e dëgjimit (audiogram) FALAS.
- Marrjen e masës si dhe përgatitjen e saj (silikon apo akrilike) në kohë rekord brenda dy ditëve.
- Përcaktimin dhe programimin e aparatit sipas shkallës së dëgjimit.
- Shërbime (servis) për të gjitha tipet e aparateve.

Adresa: Pallatet e Shallvareve, Rr. Dëshmorët e 4 Shkurtit, përballë Taiwan Nd. 24, Shk. 4, Ap.5 - Tiranë
Tel: +355 4 2262 304 / Mob: 068 23 800 95
E-mail: info@salajakustik.com
Website: www.salajakustik.com

Energjetika Gjermania financon projektin e Jugut

■ ■ ■ TIRANE

Në muajin shkurt do të nisë ndërtimi i linjës unazore 110 kilovolt të furnizimit me energji për Jugun e Shqipërisë. Ky është një nga projektet më të mëdha të financuar për Shqipërinë nga Gjermania. "Gjermania mbështet ndërtimin e linjës 110 kV të energjisë në Jugun e Shqipërisë me një kredi prej 49 milionë euro. Ky është një nga projektet më të mëdha të asistencës financiare në historinë gjermano-shqiptare. Punimet pritet të përfundojnë brenda vitit. Nga kjo linjë do të përfitojnë qindra mijëra qytetarë shqiptarë dhe biznese, falë furnizimit me en-



Karola Myler Holtkemper

ergji elektrike", u shpreh ambasadorja gjermane në Tiranë, Karola Myler Holtkemper. Projekti do të realizohet nga kompania fituese e garës, Energoinvest, e cila nënshkroi dje marrëveshjen e bashkëpunimit me Operatorin e Sistemit të Transmetimit.

Kursi i këmbimit valutor

Për datën 31.1.2013



Burimi: Banka e Shqipërisë

Çmimet mesatare të ushqimeve në Tiranë

31.1.2013 (lekë/kg)

FRUTA	
■ Mollë	79
■ Portokall	93
■ Mandarina	132
■ Limon	132
■ Ullinj	172
PERIME	
■ Domate	124
■ Kastravec	245
■ Spec	250
■ Spinaq	179
■ Lakër	48
■ Lulelakër	191
■ Karrota	65
■ Patëllxhan	330
■ Kungull	327
■ Fasule	294
■ Qepë	71
■ Patate	82

Burimi: Ministria e Bujqësisë dhe USAID



Kapen 500 gramë hashash çokollatë "Made in Elbasan"



Dy persona u vunë në pranga dhe 500 gramë hashash i presuar në formë çokollatë u sekuestrua nga agjentët e anti-drogës në kryeqytet, gjatë operacionit të koduar "Parkingu". Burime zyrtare pranë policisë së Tiranës bënë të ditur arrestimin e 24-vjeçarit Aidi Dylberi dhe Edmond Islamajn, 28 vjeç, nga

qyteti i Elbasanit. Nga hetimet e kryera ka rezultuar se lënda narkotike e llojit hashash, përgatitej dhe presohet si çokollatë në qytetin e Elbasanit, dhe kishte si treg shitje Tiranën. Sipas burimeve mësohet se të rinjtë u kapën përgjatë mesditës të së enjtes në zonën e tregut ushqimor, në afërsi të Stacionit të Trenit në

kryeqytet. Ndërkaq, nga të tjera burime të besueshme bëhet e ditur se po hetohen edhe persona të tjerë të përfshirë të këtë rrjet kriminal, i cili dyshohet se vepron në të dy qytetet. Presimi i kanabisit dhe shitja e tij në formën e çokollatës, dyshohet të jetë një ndër format më të përhapura të shitjes në Tiranë.


Raporti: Ja si lëvizin narkotikët nëpër Ballkan

"Shqipëria, laborator droge e urë trafiku"

EUROPOL: Shqiptarët kanë rol kyç e BE

Në Itali

"Ika nga Shqipëria se më dhunon babai"



Një minoren shqiptar ka kërkuar ndihmën e policisë italiane, me pretendimin se është larguar nga vendi pasi dhunohet sistematikisht nga babai. Ngjarja e ndodhur përgjatë ditëve të fundit ka vënë në lëvizje policinë e Castelos, në stacionin e policisë të të cilit është bërë dhe denoncimi i 15-vjeçarit shqiptar. I quajtur me nofkën Ariel nga policia e shtetit fqinj, adoleshenti shqiptar mësohet të ketë deklaruar se kishte udhëtuar drejt Italisë me avion, dhe pas mbërritjes në Perugia kishte qarkulluar i pangrënë dhe pa një vend ku të sistemohej. "Kam ardhur në Itali me avion i shoqëruar nga dy shqiptarë të tjerë por nga ajo ditë kam humbur të gjitha dokumentet, paratë dhe kam qarkulluar nëpër Itali i frikësuar" - mësohet të ketë deklaruar Ariel në polici. Ndërkohë, policët italianë thanë para mediave se "edhe pse 15-vjeçari nuk di mirë gjuhën italiane, ai ka mundur të komunikojë me anë të gjeleve dhe të thotë se është i uritur." Pas kontaktit të parë, oficerët policorë të Castelos kanë vënë në dispozicion një përkthyes shqiptar, i cili nuk ka mundur të marrë shumë të dhëna nga i mituri. Pretendimi më i fortë i tij ka qenë se është larguar nga Shqipëria, për shkak se kishte një baba agresiv, që e keqtrajtonte gjithmonë.

Lajmi

Shqipëria vazhdon të mbetet në hartat me "pikë të kuqe", përsa i përket trafikut të drogës. Një raport i Europolit, e konsideron vendon tonë si vend kyç nga kalon droga drejt Perëndimit, ndërsa flitet edhe për laboratore heroinë, të cilat sipas raportit, posedohen nga Shqiptarët.

BRUKSEL

Organizatave kriminale shqiptare luajnë rol kyç në trafikimin e heroinës drejt vendeve të Bashkimit Europian. Kjo është theksuar në një raport të Qendrës së Monitorimit Europian të Drogës, Europol. Sipas të dhënave që parqiten në raport, lënda narkoke, heroinë, kokainë apo kanabis kalon në vendet e BE-së përmes Ballkanit dhe një rol kyç luajnë organizatat shqiptare.

"Rrjetet e organizuara ku shqiptarët kryejnë trafikun janë grupet, lituaneze, serbe, turke, bullgare, si dhe grupet moldave, të cilat në bashkëpunim me shqiptarët, përdorin pikat kufitare të Shqipërisë për të transportuar drogën drejt Italisë dhe Greqisë", thuhet në raportin e Europolit. Ndër të tjera, nënvizohet se organizatat shqiptare përdorin skafet për të transportuar lëndën narkotike dhe se janë të lidhura me grupe kriminale lituaneze dhe turke, për të realizuar këtë veprimtari kriminale. Sipas të dhënave të mbledhura për hartimin e këtij raporti, rezultoi se Italia është tregu më i madh i konsumit të heroinës.

"Rruga që ndiqet për të depozituar drogën drejt vendeve të Bashkimit Europian, është përmes Rumanisë në Bullgari dhe Shqipëri. Pastaj përmes skafeve, lënda narkotike shkon drejt Italisë e më tej edhe në vendet e tjera të Bashkimit Europian", theksohet ndër të tjera në raport. Ky i fundit nënvizon, se përdoren forma të ndryshme të trafikut, qoftë përmes rrugës detare edhe

asaj tokësore. Qendra për Monitorimin Europian të Drogës, thekson gjithashtu se, shqiptarët rezultojnë të përfshirë në disa aktivitete kriminale përsa i përket trafikut të drogës.

Raporti citon dhe arrestimin e 17 shqiptarëve me një sasi të konsiderueshme heroinë në muajin tetor, në veri të Francës, "ku klani shqiptar ishte tepër aktiv dhe komandonte një pjesë të mirë të tregut europian të shitjes me pakicë, në Holandë

"Rruga që ndiqet për të depozituar drogën drejt vendeve të Bashkimit Europian, është përmes Rumanisë në Bullgari dhe Shqipëri. Pastaj përmes skafeve, lënda narkotike shkon drejt Italisë e më tej edhe në vendet e tjera të Bashkimit Europian"

dhe Itali". Sipas Njësisë Qendrore të Policisë Europiane "Europol", shqiptarët janë aktivë dhe në tregun e drogave sintetike dhe kanë një peshe kryesore në prodhimin dhe trafikimin e hashashit.

Në raport përfshihen dhe mënyrat e komunikimit ndërmjet organizatave kriminale, ku janë shmangur metodat e komunikimit me telefon dhe me kontakte direkte,

duke përdorur gjithnjë e më shumë komunikimin "online" nëpërmjet internetit,

duke përdorur Skype dhe platformë të tjera komunikimi, siç janë rrjetet sociale.



EU DRUG MARKETS REPORT | A STRATEGIC ANALYSIS



Faksimile e raportit të Qendrës së Monitorimit Europian të Drogës dhe Europol



Precedentët

Vetëm dy ditë më parë, në Portin e Brindizit, karabinierët zbuluan plot 15 kilogramë heroinë, e cila kishte mbërritur nga Shqipëria me një peshkarexhë. Ndërsa në Francë, një familje shqiptare u kap me 11,5 kilogramë kokainë, sasi të cilën e sillte nga Spanja drejt Italisë.

Për sa i përket laboratorëve të përpunimit dhe paketimit të lëndës narkotike heroinë, raporti bën të ditur, se në Europë ndodhen disa, ndërsa dy prej laboratorëve që prodhojnë sasi të konsiderueshme droge dyshohet se ndodhen në Shqipëri dhe Moldavi.



REPUBLIKA E SHQIPERISE
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE



NJOFTIM PËR VEND TË LIRË PUNE

Bazuar në ligjin nr.8549, datë 11.11.1999 "Statusi i Nëpunësit Civil", Drejtoria e Burimeve Njerëzore në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, shpall konkurrim për vendin e lirë të punës, në pozicionin:

Specialist IT, në Drejtorinë e Teknologjisë së Informacionit

Kërkesat e përgjithshme:
Konkurruesi duhet të plotësojë kërkesat e përgjithshme të nenit 12 të ligjit nr. 8549, datë 11.11.1999 "Statusi i Nëpunësit Civil".

Kërkesat e veçanta:
➤ Arsimit të lartë në një nga degët Informatikë, Inxhinieri Elektronike ose Teknologji Informacioni.
➤ Të ketë përvojë pune jo më pak se 3 (tre) vjet në fushën e IT-së.
➤ Të zotërojë gjuhën angleze.

Paga:
Paga mujore bruto e pozicionit është sipas klasës III-b, përcaktuar në VKM nr.524, datë 16.08.2012.

Dokumentacioni:
Kandidati duhet të paraqesë brenda datës 04.03.2013 në zyrën e regjistrimit të akteve dhe dokumentacionit të KQZ-së, këto dokumente:

- Kërkesë me shkrim;
- Curriculum Vitae;
- Dokument identifikimi;
- Libreze pune (fotokopje e noterizuar), ose vërtetim zyrtar për afatin kohor të punësimit;
- Diplomë të shkollës së lartë, së bashku me listë notash (fotokopje e noterizuar);
- Dëshmi e Gjuhës së Huaj (fotokopje e noterizuar);
- Dëshmi kualifikimi (fotokopje e noterizuar);
- Vlerësim pune nga punëdhënësi ose dy rekomandime nga punonjës superior të institucionit ku janë ndërprerë së fundi marrëdhëniet e punës;
- Dëshmi nga komisioni mjekësor kompetent që vërteton aftësinë për punë.


Më datë 07.03.2013 në selinë e KQZ-së do të shpalllet lista e konkurrentëve që do të vazhdojnë më tej procedurën e testimit, si dhe datat e testit me shkrim dhe intervistës me gojë.

Testimi bazohet në njohuri për Kushtetutën, Kodin Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë, Ligjin "Statusi i Nëpunësit Civil", Kodin e Procedurave Administrative, Ligjin "Për rregullat e Etikës në Administratën Publike", si dhe njohuri për fushën përkatëse.



Krimi i dyfishtë

MEDIAT ITALIANE raportojnë për ekzekutimin e dyfishtë. E reja, kishte studiuar në liceun e Recanatit dhe ishte diplomuar në degën e Shkencave të Arsimit, në Universitetin e Maceratës



Në foto: Giulia Baldassarri dhe bashkëshorti i saj Sokol Ucaj, të vrarë dy netë më parë në Elbasan



Italiania e vrarë, vajzë zyrtari

Giulia Baldassarri, e cila u ekzekutua në Elbasan, së bashku me burrin, është e bija e kryetarit të Komunës së Loretos. Familja nuk ishte dakord për martesën. Trupi, sot drejt vendit fqinj

Lajmi

Vajza italiane, e vrarë dy ditë më parë së bashku me burrin në Elbasan, Giulia Baldassarri, mësohet të jetë e bija e kryetarit të Komunës së Loretos në provincën e Maceratës. Mediat italiane bëjnë me dije se prindërit e saj e mësuan lajmin nga Ambasada Tiranë. 24-vjeçarja dhe bashkëshorti u vranë në Elbasan nga vjehëri i saj.

ELBASAN

ELONA ELEZI



Në foto: (Majtas) Trupat e viktimave duke u nxjerrë nga shtëpia (Lart) Automatik i vrasjes

Kumuna e Loretos në Itali, është në zi. Vajza e vrarë dy ditë më parë në Elbasan, Giulia Baldassarri, është e bija e kryetarit të komunës e cila ndodhet në rajonin Macerata. Lajmi është konfirmuar nga burime të besueshme në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë, ndërkohë që pala italiane ka kërkuar të dhëna rreth ngjarjes së rëndë natën e krimit. Vrasja me kallashnikov e vajzës së re nga vjehëri i saj është pasqyruar edhe në mediat locale italiane. Në gazetën e Maceratës thuhet, se Giulia Baldassarri u qëllua për vdekje së bashku me bashkëshortin, në shtëpinë e vjehërit të saj në Elbasan, pas një konflikti familjar. Ajo kishte studiuar në liceun e Recanatit dhe ishte diplomuar në degën e Shkencave të Arsimit, në Universitetin e Maceratës. Dyshohet se edhe prindërit e saj, Giovanni dhe Mirella Baldassarri, kishin qenë kundër lidhjes mes të rinjve.

Ndërkohë, grupi hetimor i

2 plumba

Autopsia

Janë gjetur nga Mjekësia Ligjore në Tiranë, në trupin e vajzës italiane. Njëri në qafë, njëri e kishte kapur në krah dhe i kishte depërtuar krahërorin dhe i treti në gjoks, por pa prekur organet e brendshme.

ngritur në lidhje me ngjarjen, ka vijuar hetimet dhe disa orë pas vrasjes së dyfishtë, policia e Elbasanit ka dalë me një version zyrtar, ku sipas tyre shkaku i konfliktit familjar kanë qenë motivet ekonomike. Deklarata zyrtare e policisë ka qenë në kundërshtim me atë çka deklaroi natën e krimit autori 65-vjeçar Engjëll Ucaj. Burime të besueshme policore thanë se, pas arrestimit dhe shoqërim të tij në komisarjati, burri ka marrë përsipër autorësinë e krimit dhe ka rrefyer se motiv i ngjarjes ishte bërë fakti, se nuk i pëlqente një nuse e huaj në shtëpi. "Djalin e kisha si dritën e syve, por nuk desha

një vajzë të huaj në shtëpi. Grindeshim shpesh dhe ai ushtronte dhunë sistematike ndaj meje", mësohet të jetë shprehur ai përpara oficerëve policorë. Rreth orës 19:45 të datës 30 janar, policia e qytetit mori njoftimin nga një grua, se bashkëshorti i saj donte të vriste djalin dhe nusen e tij, në një pallat të ri në lagjen "Sul Paprri". Por, pak caste para se policia të mbërrinte, kryefamiljari Engjëll Ucaj, kishte shkrehur armën, duke lënë të vdekur në vend djalin e tij dhe nusen italiane. Nga këqyrjet e para në vendngjarje rezultoi se me anë të një kallashnikovit, armë

të cilën e mbante pa leje që nga viti 1997, ai kishte ekzekutuar të birin dhe nusen e tij. Sokol Ucaj, 27 vjeç, si dhe italiania 24-vjeçare Giulia Baldassarri, për të cilën pati dyshime se ishte 4-muajshe shtatzënë, gjetën vdekjen e menjëhershme si pasojë e plagëve të marra nga arma e zjarrit. Hetimet e vazhdueshme nxorën në dritë faktin, se mes babait dhe të birit ekzistonte një konflikt afro njëvjeçar, që nga momenti që Sokol Ucaj ishte kthyer të jetonte në Shqipëri me gruan e tij të huaj. I moshuari nuk është mësuar me këtë ide, dhe vazhdimisht drejtonte sharje dhe fyerje drejt vajzës. Konfliktet e herë-pashershme dhe dhuna sistematike që djali ka ushtruar ndaj të atit, degjeneroi mbrëmjen e së mërkurës, ngjarje e cila përfundoi me dy viktima.

Trupi i vajzës ka qenë dje në Institutin e Mjekësisë Ligjore, ku dhe i është bërë autopsia, ndërsa sot pritet të nisët drejt Italisë.

Fqinjët

"Nuk dinim të kishin probleme"

Krimi i dyfishtë në familjen Ucaj ka tronditur edhe banorët e komunitetit ku ata jetojnë. Të shokuar dhe duke mos besuar ende ekzekutimin e Sokol Ucaj dhe gruas së tij italiane Xhulia Baldassarri, ata rrezojnë kategorikisht versionin e policisë, se konflikti në familjen e tyre mund të ketë ardhur si pasojë e problemeve ekonomike. Leonard Bega, një fqinj i viktimave, thotë se autori i dyshuar i ngjarjes, 65-vjeçari Engjo Ucaj sipas përpjekjeve për një shtet të mirë në lagje. "Unë e njihja Engjon dhe gjithmonë kam pasur një komunikim të mirë dhe të vazhdueshëm por nuk gjej dot



filatë që ta përshkruaj se si u shua kjo familje në këtë mënyrë. Për mendimin tim nuk qëndron versioni se kjo familje ka qenë në gjendje të vështitë ekonomike sic thotë policia" - shprehet ai. Sipas një tjetër fqinje, Violeta Begës, edhe pista tjetër e ngjarjes për mospëlqim të nuses italiane, mbetet sërisht absurde sipas saj.

Deklarata

Policia: Sherret për shkaqe ekonomike

Me anë të një njoftimi zyrtar për shtyp, policia e Elbasanit bëri të ditur se pas hetimeve paraprake, është arritur në konkluzionin se shkak për vrasjen e dyfishtë janë bërë motivet ekonomike. "Ngjarja ka ndodhur si pasojë e konflikteve familjare të vazhdueshme që ka patur shtetasi Engjëll Ucaj me djalin e tij Sokol Ucaj, për shkaqe ekonomike, ku më pas autori

ka qëlluar me arme zjarri tip automatik në drejtim të djalit si dhe nuses së tij, duke u shkakuar vdekjen e menjëhershme" - thuhet në njoftim. Sipas të njëjtave burime bëhet e ditur se në cilësinë e provës materiale u sekuestrua arma e krimit, tip Kallashnikov si dhe një thikë. Ndaj 65-vjeçarit Engjëll Ucaj rëndojnë akuzat e "vrasjes në rrethana të tjera cilësuese" si dhe "armëmbajtje pa leje."



Rrëfimi

INTERVISTA e ish-Sekretarit të Parë të Rinisë së Punës, sjell detaje të panjohura rreth jetës dhe punës mes shefave ideologjikë të PPSH dhe sfidave e problemeve që iu desh të përballlej në rininë e tij

LISEN BASHKURTI: Sali Berisha të përgatisë largimin e butë nga politika

Flet diplomati dhe politikani: Berisha narcizist. Dikur respektonte betimin e Hipokratit. Sot respekton atë të hipokritit

ARMAND PLAKA

Në fakt është ftuar të flasë më shumë për të shkuarën, por në fund shpreh mendimin e tij edhe për të tashmen, me vështrimin nga e ardhmja. E mbyll, duke folur për Kryeministrin Berisha, për karakterin e tij, porse ajo që ka rëndësi, është apeli që lëshon për një largim të butë të tij nga politika. Pohon me sinjoritë hapat e karrierës së tij në një kreshendo interesante në fazat e fundit të sistemit të vjetër, duke vërtetuar edhe një herë perceptimin e hershëm publik, mbi karakterin dhe rolin e tij reformator në etapat më të rëndësishme të demokratizimit të vendit. Përmend emra ish-shefash, miqsh e kolegësh, të cilët i vlerëson për atë që kanë bërë, por nuk heziton të kritikojë hapur ish-bosin e tij për përgjyeshëni historike që mbart për vonimin e procesit të demokratizimit. Flet për "Katovicën" e Gorbaçovin, në një rrëfim të pazbuluar kurrë më parë, duke na sjellë më të detajuar karakterin e Ramiz Alisë. Nuk ka se ç'të thotë për "spastrimet" e mëdha të fillimviteve '80, pasi le të kuptohet se i ka përjetuar si gjithë shqiptarët e tjerë, në kohën kur sapo kishte nisur të jepet mësim në Liceun Artistik të Shkodrës, pasi nëse ka që s'e dinë, edukimi i tij primar, është ai muzikor. Për më shumë, le të ndjekim të plotë intervistën e Prof. Dr. Lisen Bashkurit për Shqiptarja.com.



Prof. Dr. Lisen Bashkurti

Prof. Bashkurti, ju përveç karrierës suaj të gjatë si politikan e diplomat gjatë demokracisë, keni edhe një karrierë që arriti deri në njërin ndër postet më të larta të hierarkisë edhe në kohën e sistemit të vjetër. Cfarë mund të na veconi ndonjë detaj për kohën apo rrethanat kur ju u emëruat në atë post?

Në tre vitet e fundit përpara rënies së regjimit të kaluar unë kisha mbrojtur gradat shkencore "kandidat i shkencave" dhe "doktor" për kritikë artesh. Menjëherë mbas kësaj eventimenti shkencor personal rrjedha ime e karrierës ndryshoi fare papritur. E them këtë, sepse unë nuk kisha qënë në asnjë organ politik partiak, as në nivel të thjeshtë organizate partie, as në nivele plenumi rrethesh dhe në asnjë forum politik partiak. Kisha pasur vetëm aktivitet rinor si sekretar rinie i universitetit ku kisha studiuar në vitet '80 dhe kaq. Mesa duket, siç e gjykova më pas, udhëheqja politike e kohës, po bënte përpjekje për të zgjedhur disa eksponentë me tituj e grada shkencore, me kualifikime e gjuhë të huaja perëndimore që të shërbenin si një koperturë përpara botës me arsyetimin se "Shqipëria po rinovon e modernizon

kapacitetet njerëzore". Në këtë kontekst, në tetor 1987 mua më thirrën në Komitetin Qëndror të Rinisë dhe në Kongres më zgjodhën Sekretar për Edukimin dhe Marrëdhëniet me Jashtë. Në dhjetor 1989, pra vetëm një vit pas ndryshimit të madh politik, më zgjodhën Sekretar të Parë të Rinisë. Edhe në këtë post, unë kurrë nuk kam qënë në hierarkinë e Partisë së Punës, as në bazë, as në rrethe dhe në asnjë forum politik të lartë të saj. E nisa dhe e përfundova karrierën time vetëm si drejtues i organizatës së rinisë, në të cilën bënim pjesë rreth 600 mijë antarë që nuk ishin antarë të PPSH. Fare pak prej tyre ishin antarë partie.

Ndjeja një presion shtypës në rritje prej udhëheqjes partiake konservatore, për t'iu kundërvënë rinisë... Kam përjetuar një gjëndje... , si në një pneumatik të dyfishtë

Cilat ishin detyrat tuaja dhe çfarë ndryshimi pritej të sillnit ju, në krahasim me paraardhësit tuaj në kontekstin e kohës në të cilën po flisim?

Puna me rininë ka qënë sfidante sidomos në atë periudhë. Unë, si drejtues i rinisë përjetova atë vit, pra në vitin '90, kohë kur isha në krye të saj, një situatë shumë interesante. Nga poshtë ndjeja presionin demokratik në rritje të rinisë, e cila më kishte zgjedhur me vullnet të lirë. Nga lart ndjeja një presion shtypës në rritje prej udhëheqjes partiake konservatore, për t'iu kundërvënë rinisë. Gjatë tërë kohës, për afro një vit që kam qënë në krye të rinisë, kam përjetuar një gjëndje të tillë, si në një pneumatik të dyfishtë. Në këtë rrethana që erdhën duke u

përkeqësuar, unë bëra gjithçka që të afrohesha me rininë dhe t'i largohesha lidhshpirt politik konservator. Në këtë proces përzgjedhje personale gjatë gjysmës së dytë të vitit 1990, kryesisht kalova në krye të rinisë në terren. Qëllimi im ishte të kontribuoja sa kisha mundësi me gjithë autoritetin e ndikimin tim për evitimin e konfrontimeve që mund të shkonin në gjakderdhje. Natyrisht, gjakderdhja ndodhi. Për këtë arsye e me këtë mision pajtues e qetësues kam qënë i vetmi nga Tirana që i kam bërë vizitë familjes së Josif Budës në Kavajë në verën e vitit 1990, që u vra nga forcat e sigurisë. Kam qënë në shtëpinë e Arben Brocit, që u vra pa-besisht në ngjarjet e Shkodrës 1991. Kam qënë në tërë procesin e krijimit të opozitës demokratike së bashku me Azem Hajdarin, që e kam pasur mik nga origjina e familjes time prej Tropojës, Eduard Selamin që e kisha shok universiteti, Shinas Ramën që ishim miq familjarë e komshi në Shkodër etj. Edhe me doktor Berishën kisha njohje të thellë prej shumë vitesh. E kam ndjekur këtë proces tranzicioni me shumë sforc, sepse herë pas herë më kërkohet të jepja llogari përpara Ramiz Alisë për atë që ndodhte jashtë orientimit të lider-shpirt partiak. Unë nuk isha pjesë e asnjë forumi politik partiak, prandaj në jo pak raste më kanë fyer e quajtur si "macja e zezë" në krye të rinisë. Në fakt unë nuk bëja asgjë më shumë, por paraqisja raporte shumë të sinqerta në rastet kur më kërkoheshin. Të gjitha janë në arkivat e Shtetit. Kështu që unë me vullnetin tim, pa vendim forumesh që ishin shumë të diversifikuara në atë tranzicion, ndoqa çdo fazë; nga ideja e Godinës 15, deri te takimi i studentëve me Ramiz Alinë për lindjen e opozitës demokratike. Më pas rinia që drejtoja, bëri një flakje masive të taserave në dhjetor 1990, duke u shkëputur nga varësia e PPSH me një vendim të Komitetit Qëndror të Rinisë, organizuar në Pallatin e Pionierëve në Tiranë. Këto ngjarje janë pasqyruar shumë realisht nga gazetata "RD", "Republika" dhe "Koha Jonë". Këto tre media kanë qënë shumë të hapura e mbështetëse ndaj meje. Mjerisht, gazeta "Zëri i Rinisë" nuk më bindej tërësisht, ndonëse ishte në varësinë time direkte. Shkaqet mund t'i marr me mend. Unë përdoza tribunën opozitare për shpalosjen time. Të gjitha janë në arkivat e mediaeve. Vendimi, që u mor pak ditë mbas lindjes së opozitës, organizatën e rinisë që unë drejtoja në dhjetor 1990 e shkëputi tërësisht nga roli udhëheqës i Partisë së Punës. Në një takim në Komisionin për ndryshime Kushtetuese, ku bëja pjesë edhe unë, Ramiz Alia, në sy të Foto Çamit, Adil Çarçanit, Manush Myftiu, Haxhi Leshit, Aranit Çelës etj, më sulmoi haptazi me akuzën se "po tradhatoja gjakun e Qemal Stafës dhe dëshmorëve të kombit". Unë nuk fola, por u trondita jashtë mase. Akuzua më bëhej zyr-



tarisht në prezencë të gjithë udhëheqës së shtetit e partisë. Nga ajo ditë, marrëdhëniet e mia me Ramiz Alinë erdhën duke u ftohur e distancuar, deri në ndërprerje të plotë të takimeve e komunikimeve. Ndërkohë, unë u bëra pjesë e lëvizjes për shmangjen e konfrontimeve përgjakëse të Liceu Artistik në fillim të dhjetorit 1990, ku ka qënë i pranishëm edhe doktor Berisha e Besnik Mustafaj; u përpoqa për shmangjen e ngjarjeve në Shkollën e Bashkuar dhe mënjanimin e ballafaqimit të rinisë studentore civile me rininë ushtarake të armatosur të Shkollës së Bashkuar; mbështeta nga brenda dhe në "Radio Tirana" me deklaratë publike, grevën e urisë së studentëve për heqjen e emrit "Enver Hoxha" të UT, së bashku me Abdi Baletën, asokohe ishte drejtues i Komitetit Shqiptar të Helsinkit; isha pjesë në turmen për procesin e rrëzimit të monumentit të diktatorit pa incidente; personalisht, me Spiro Deden mbështetëm grevën e urisë së minorëve të Valiasit me grevistë ish-të burgosor politikë, si Roland Përmeti etj; më së fundi mora pjesë personalisht në zgjedhjet e para demokratike për parlament, si pjesë e opozitës antikomuniste, ku dola për herë të parë deputet i koalicionit anti-komunist shqiptar. Në parlament qëndrova 6-muj dhe më pas, me kërkesë timen kalova në shërbimin diplomatik, prej të cilit nuk jam larguar asnjëherë deri më sot, qoftë në shërbim shtetëror, qoftë në shërbim personal diplomatik dhe akademik në këtë fushë.

Vendimi, që u mor pak ditë mbas lindjes së opozitës, organizatën e rinisë...në dhjetor 1990 e shkëputi tërësisht nga roli udhëheqës i Partisë së Punës

Përtej kësaj, si i përjetuat ju në rininë tuaj valën e fundit të "spastrimeve" që u mbyll me dosjen "Haxhiu & Co." dhe fillimin e një ere të re pas vdekjes së Hoxhës dhe ardhjes në krye të shtetit të Ramiz Alisë?

Mua më kanë zgjedhur në organizatën e rinisë në shtator të vitit 1987. Këto ngjarje që pyetni juve, kanë ndodhur shumë vite më parë, kur unë kam qënë arsimtar në Liceun Artistik në Shkodër. Nga ana tjetër, unë nuk kam qënë edhe mbas viteve 1987 në asnjë forum

PAS '90 jam njohur me letrën e Katovicës, që ishte projekt i përbashkët i udhëheqjes së PK të BRSS dhe KGB..Ramiz Alia më shumë iu referua..modelit të Katovicës sesa.."Perestrojkës" dhe "Gllasnostit"



◀ **Në foto:** (Në rreth) Në krah të djathtë të ish-Presidentit Ramiz Alia, Lisen Bashkurti, në takimin me studentët, në dhjetor 1990

politik të Partisë së Punës dhe në asnjë funksion ekzekutiv në qeveritë e regjimit të kaluar. Përveç sekretar rinie nga 1987 deri në vitin 1990, nuk kam pasur asnjë detyrë apo funksion tjetër. Kam qënë jashtë çdo rrjedhe politike në Tiranë për periudhën që pyetni.

Cilat ishin rrymat konservatore dhe ato liberale të perceptuara nga ju e miqtë tuaj brenda kupolës komuniste të kohës? - Çfarë mund të na tregoni ndonjë detaj që ilustron sjelljet apo karakteret e ndonjërit prej krerëve të lartë të Byrosë, me të cilët ju është dashur të punoni, në mënyrë më të spikatur? - Ndonjë moment nga puna në zyrat e PPSH, Rinisë (BRP-SH) etj?

Në fund të viteve '80, duke qënë në organizatën e rinisë, e kam pasur shumë të vështirë të identifikoja rrymat konservatore e liberale në udhëheqjen e PPSH. Nuk më është dhënë rasti të jem pjestar i asnjë forumi politik, siç ishin Sekretariati i KQ të PPSH, Byroja Politike, Komiteti Qendror, Presidiumi i Kuvendit Popullor apo Qeveria Komuniste e kohës. Nga pozicioni jashtë tyre, si Sekretar rinie unë i analizoja rrymat në atë udhëheqje shumë të mbyllur ndaj rinisë, vetëm nëpërmjet informacioneve, takimeve publike, shtypit apo ndonjë qëndrimi që lidhej vetëm e vetëm me punën e problemet e rinisë. Në mënyrë direkte varesha nga Foto Çami. Ai ishte një njeri i butë, me kulturë të gjërë, dëgjonte shumë, ishte i përmbytur dhe me prijje intelektuale liberale. Me Foto Çamin konsultohesha më shpesh, sidomos kur dilja me delegacione jashtë shtetit. Në krah të tij më ndihmonte shumë profesor Agim Popa, gjithashtu njeri shumë pozitiv dhe mjaft

i kulturuar. Me Ramiz Alinë janë shpeshuar kontaktet e mia, kur filloi kriza politike në pjesën e dytë të vitit 1990. Por, edhe ato nuk zgjatën shumë, për arsye të përshpejtimit të ngjarjeve. Ndërkohë, miqtë e mi të asaj kohe ishin Ismail Ahmeti, Ministër Ndërtimi, Fehri Hoxha, Ministër Energjitike, Skënder Gjini, Ministër Arsimit, si dhe Alfred Uçi, Ministër Kulture e Dritëro Agolli, Kryetari i Lidhjes së Shkrimtarëve. Me to takoheshim shpesh dhe bisedonim në një frymë krejt tjetër nga ajo që karakterizonte udhëheqjen e lartë politike të kohës. Gjithë këto emra që përmenda, nuk shiheshin me admirim nga lidhshipi konservator i PPSH. Të gjithë këto emra përfaqësonin njerëz shumë të ditur, me shumë përvojë, patriotë të modernë. Unë u jam mirënjohës tërë jetën atyre për rolin që kanë luajtur në atë kohë kritike për Shqipërinë.

Qëndrojmë tek Alia. A mund të thuhet se ai të paktën diti t'i japë një frymë liberalizuese të gjithë rrugëtimit në krye të shtetit deri në ardhjen e demokracisë dhe se të paktën, në krahasim me kolegët e tij brenda byrosë, ai mbetej zgjedhja më e mirë në këtë rast?

Ramiz Alia ishte trashëgimi e udhëheqjes së Enver Hoxhës. Ishte më i ulët se Hoxha si profil. Ishte më pak i ditur dhe më pak i lexuar se Hoxha. Por ishte njëkohësisht më tolerant, më i qetë dhe më elastik. Stili i tij qeverisës ishte ambig. Ambiguiteti e ndihmonte për të manovruar midis konservatorëve brutalë e injorantë dhe liberalëve të pakët e të trembur. Ai mban përgjegjësi historike për vonimin e procesit të demokratizimit, për moskonsiderimin e mendimeve alternative që i vinin nga brenda e nga jashtë, për kurajo të kufizuar në ndërmarrjen e kthe-



Foto nga protestat e dhjetorit 1990

RAMIZ ALIA ishte trashëgimi e udhëheqjes së Enver Hoxhës. Ishtë më i ulët se Hoxha si profil. Ishtë më pak i ditur dhe më pak i lexuar se Hoxha. Por ishte njëkohësisht më tolerant, më i qetë dhe më elastik.

ISH-PRESIDENTI KOMUNIST

Bashkurti: Ramiz Alia ka qënë pjesë e shkollës së KGB

save të mëdha, për paqartësi, konfuzion, mungesë vizioni dhe frymë e filozofi tërësisht Lindore. Gjykoj se ishte i fundit udhëheqës tipik Lindor në Evropë. Por tip Lindor më pranë formatit çek, hungarez a polak, sesa i formatit sovjetik. Unë, një pjesë e kuadrove të Qeverisë, mjaft intelektualë e gazetarë kemi pasur shumë më tepër prishmëri nga Ramiz Alia. Të gjithë kemi përjetuar zhgënjim prej tij.

Si u pritën lëvizjet e para demokratizuese në Bllokun Sovjetik në Tiranë dhe a pati përpjekje për t'iu bashkuar përpjekjeve të Gorbaçovit, apo ato e kishin rrugën të mbyllur deri në fund të regjimit?

Shpalosja e dy dokumentave të Gorbaçovit, "Perestrojka" dhe "Gllasnostit" mbetën shumë sekrete në Shqipëri. Unë i pata lexuar imtësisht nga azhanset që na jepte ATSH. Mbas këtyre dy dokumentave publike, Gorbaçovi shpërndau më pas edhe një letër, që njihet si "Projekti i Katovicës". Kjo letër është mbajtur strikt në duart e liderit kryesor, Ramiz Alia. As ATSH nuk na e ka shpërndarë siç ndodhte me lajmet e tjera ndërkombëtare që nuk botoheshin për publikun. Pas viteve '90-të, jam njohur me letrën e Katovicës, që ishte projekt i përbashkët i udhëheqjes së PK të BRSS dhe KGB. Për mendimin tim, Ramiz Alia më shumë iu referua në rolin e tij modelit të Katovicës sesa dy dokumentave të hapur të Gorbaçovit, "Perestrojkës" dhe "Gllasnostit". Ky vlerësim i Katovicës më shumë sesa i reformave të hapura të Gorbaçovit, të shpie në konkluzionin se Ramiz Alia ka qënë edhe pjesë e shkollës së KGB. Në mos direkt i rekrutuar, ka qënë preferues i stilit të drejtimit të KGB mbi Partinë. Ky është deduksion imi analitik dhe jo faktik, nisur nga analiza krahasuese e qëndrimit të Alisë ndaj tërë dokumentave, "Perestrojkës", "Gllaznostit" dhe "Letrës së Katovicës", ndër të cilat Alia ndoqi më së shumti orientimet e kësaj të fundit, ku roli e ndikimi i KGB ishte më i madh.

Po fakti se Berisha, dje një ish-Sekretar partie, sot kryedemokrat, përbën ndonjë element intrigus për ju? Si e shihni sot qeverisjen "Berisha" dhe tipologjinë e karakterit të tij, meqenëse ju jeni nga e njejtat krahinë?

Unë e kam njohur Berishën shumë vite përpara se ai të përfshihej në politikën e lartë. E kam njohur si mjek dhe e kam admiruar për profesionalitetin, korrekteshën dhe respektimin e lartë të betimit të Hipokratit për mjekun. Më pas e kam takuar shpesh në spital, në Hotel "Dajti" ku kemi pirë kafe, në zyrën time të rinisë. Kam konstatuar herët tek ai pasion të madh për politikën. Ishte dinamik,

pasionant, me temperament dhe mjaft karizmatik për të bërë miq e për të ndikuar mbi bashkëfolësit. Për jetën e tij si Sekretar Partie nuk di asgjë. Kemi qënë shumë larg dhe nuk na lidhte asgjë. Gjatë tërë fazave nga fillimi i dhjetorit deri në zgjedhjen e tij President, kemi qënë në kontakte personale shumë frekvente dhe mjaft miqësore. Pastaj puna ime jashtë si ambasador dhe si diplomat në lëvizje, na largoi së tepërmi. Miqësinë dhe komunikimin e kemi ruajtur deri vonë, jashtë

dhe pavarësisht nga diferencat politike në thellim të vazhdueshëm midis nesh. Për hir të së vërtetës, duhet thënë se gjithë ky tranzicion i gjatë mban një emër - Sali Berisha, me gjithë dritë-hijet e tij. Liderët e tjerë kanë qënë profile më të ulta, me më pak ndikim dhe me më pak mbështetje individualisht. Asnjëri nuk i ka dhënë emrin kohës deri tani më shumë sesa Sali Berisha. Natyra ime, tipi im, preferenca ime politike dhe mënyra e sjelljes dhe komu-

nikimit tim publik e mediatic që në tërësi më dallojnë, janë të ndryshme dhe në mjaft raste të kundërta me Sali Berishën. Berisha është karakter malësori me temperament të lartë. Në malsinë e Trojopjës ka edhe tipik malësor të urtë e të përmbytur. Të dy këto tipe ekzistojnë në malsinë e Trojopjës. Berisha është kolorik, reagues i menjëhershëm, i ashpër, këmbëngulës, kokëfortë, insistues që nuk tërhiqet nga e vetja kollaj, i zgjuar deri në dinakëri, lexues e i ditur, i mirëorganizuar e punëtor i palodhur, karizmatik në komunikimet populiste dhe manipulator i mediave dhe komunikimeve ndërkombëtare. Berisha është lojtar i fortë dhe i qartë politik, por është shtetar i dobët dhe kaotik. Stili i tij qeverisës është autokratik. Mbi vehte nuk lejon askënd, edhe nëse shkel me dy këmbët pavarësinë institucionale e kushteuese. Vuan nga narcizizmi. Më parë ka qënë shumë etik, pra ka respektuar Hipokratin. Tani e ka humbur shumë etikë dhe po respekton hipokritin. Berisha ka ndryshuar, mjerisht jo ashtu siç do dëshiroja unë. Mund të kenë ndikuar për keq edhe faktorë shumë pranë tij, që unë nuk i identifikoj dot. Gjykoj se për vetë Berishën do ishte mirë të mendonte një tërheqje të butë nga politika. Çdo ditë që po kalon, po e rëndon. Çdo vonesë në

edhe kërcënon. Çdo kohë që ecën errëson edhe kontributin e tij. Sa më shpejtë t'i hapë rrugë procesit, aq më shumë e aq më mirë koha do i ndriçojë edhe kontributet e tij. Në politikë ka më shumë rëndësi mënyra sesi largohesh, sesa mënyra sesi futesh. Berisha ka hyrë me dinjitet. Por, po nuk u tërhoq butë, do largohet pa dinjitet. Largimi pa dinjitet mund të errësojë hyrjen me dinjitet në politikë. Vepra e fundit në histori është prealvesha mbi gjithçka që politikani ka bërë më parë.



Ramiz Alia

Preferenca ime politike dhe mënyra e sjelljes dhe komunikimit tim publik e mediatic që në tërësi më dallojnë, janë të ndryshme dhe në mjaft raste të kundërta me Berishën



Ministri i Shëndetësisë, akreditimi i spitaleve brenda dy viteve

Hyrja në fuqi e ligjit të ri për sigurimet shëndetësore në mars të këtij viti bën të domosdoshëm akreditimin e institucioneve shëndetësore për të mundësuar një treg konkurrent shëndeti, tha dje ministri i Shëndetësisë, Vangjel Tavo, gjatë një takimi me drejtorët e spitaleve lidhur me procesin e akreditimit të institucioneve shëndetësore. "Do të

emërojmë menjëherë koordinatorët në të gjitha institucionet shëndetësore për ta përshpejtuar këtë proces. Ata drejtues të cilët do ta pengojnë këtë proces, pa dyshim që do të ketë masa ndëshkuese. Do kërkojmë nga ISKSH që të mos tolerojë në blerjen e shërbimeve, po të blejë ato shërbime cilësore dhe të sigurta dhe të akredituara", u shpreh Tavo. Më tej ministri tha se spitalet e vendit

brenda dy viteve duhet të jenë të akredituar. Drejtori i Qendrës së Cilësisë, Sigurisë dhe Akreditimit të Institucioneve Shëndetësore Isuf Kalo, tha se spitalet nuk do të akreditohen nëse nuk kalojnë 70 pikët. Ai sqaroi se kur plotësojnë nga 70 deri 80 pikë ata mund të marrin akreditim njëvjeçar dhe ata që kalojnë mbi 80 pikë akreditohen për 5 vjet.

Denoncimi "Fiks Fare" për tregtinë e paligjshme

Fishekët shiten në dyqanet e bukës

Kamera në Velipojë, Milot dhe Fushë Krujë

Lajmi

Fishekët vrasës shiten lirshëm në dyqanet e bukës në shumë prej dyqanëve të bukës në veri të Shqipërisë. Pamjet dhe rrëfimet janë dhënë mbrëmë në emisionin "Fiks Fare", ndërsa policia nuk ndërhyr

TIRANE

Fishekët e armëve të zjarrit shiten në dyqanet ushqimore dhe në treg. Askush nuk kontrollon dhe ndalon shitjen e municioneve të armëve të zjarrit të gjuetisë. "Fiks Fare" ka investiguar tregtimin e paligjshme të municioneve të armëve të gjahut, të cilat janë po kaq të rrezikshme sa edhe armët luftarake. Investigimi ka nisur që nga Shkodra e deri në Tiranë. Shitës ambulant, por edhe të dyqaneve ushqimore, tregtonin municionet në dyqanet e tyre pa u trembur nga rreziku që u kanoset, ndërsa policia nuk ndërhyr për ndalimin e kësaj tregtie. Edhe pse këta fishekë, përdoren për gjueti ata mund të marrin edhe jetë njerëzish. Fishekë që shiten lirshëm në dyqanet ushqimore apo treg gazetarët e "Fiks fare" gjetën në Velipojë, Trush, tregun e Milotit dhe atë të Fushë Krujës.


Gazetarët e Fiks fare u paraqitën tek këto dyqane dhe tregtarët si qytetarë që kërkonin të blihin fishekë për armë gjaku. Asnjë prej tregtarëve të fishekëve, nuk u ka kërkuar gazetarëve të "Fiks Fare" që të tregonin lejen për mbajtjen e armëve të gjahut. Ndërkohë që ligji Nr. 7566, datë 25.5.1992 "Për Armët", neni 3 dhe 9, nuk lejon tregtimin e municioneve apo armëve të gjahut pa leje si dhe prodhimin e tyre.

Fiks Fare e ka nisur investigimin e tij në Velipojë, në një dyqan ushqimor. Gjatë bisedës me këta tregtarë kuptohet se ata nuk kanë informacion mbi përdorimin e fishekëve dhe apo rrezikun e tyre. Por të gjithë këta tregtarë pranojnë se fishekët që ata shesin nuk janë prodhim artizanal dhe janë të fuqishëm, sa mund të vrasin edhe njerëz.

Në tregun industrial të Milotit dhe të Fushë Krujës,



Foto nga filmimet me kamera të fshehtë në dyqanet e zonës së Veriut



nëpër tezga gjen edhe fishekë. Ato shiten hapur dhe madje tregtarët e reklamojnë mallin e tyre duke treguar se fishekët që kanë për shitje janë të kalibrave të ndryshme për çifte. Këta tregtarë pranojnë që t'ua shesin edhe minoreneve. Gjatë bisedës me një nga gazetarët e Fiks fare të paraqitur si gjuetarë, një tregtar fishekësh në tregun e Milotit, kur gazetarit i thotë se do të dërgojë një djalë 15 vjeçar për të blerë fishekët, pranon se do t'ia japë

Investigimi

Fiks Fare e ka nisur investigimin e tij në Velipojë, në një dyqan ushqimor. Gjatë bisedës me këta tregtarë kuptohet se ata nuk kanë informacion mbi përdorimin e fishekëve dhe apo rrezikun e tyre.

Më pas investigimi i gazetarit ka vazhduar në një dyqan që shite armë gjahu në Vorë. Ky tregtar shet pajisje që shërbejnë për prodhimin e fishekëve të armëve të gjahut. Ai i ka sugjeron gazetarit që të blejë dy makineri artizanale dore, që përdoren për montimin e fishekëve të çiftes. Sipas tregtarit "i makinat janë fare të thjeshta në përdorim. Kam të gjitha pajisjet e fishekëve, duke nisur nga saçmet, kapsollat, kallamin, tapat, barutin etj, që i duhen

një fisheku". Më pasi ai ka nisur të mësojë gazetarin mënyrën e prodhimit të fishekëve të çiftes. Tregtari ka renditur çmimet e përbërësve të fishekëve duke filluar nga baruti, kapsollat, gotat. Kostoja e këtyre fishekëve nëse i prodhon në mënyrë artizanale është me e ulët. Gjatë gjithë bisedës dhe pazarit tregtari në asnjë moment nuk ka kërkuar lejen e armës. Ndërkohë që ligji ndalon prodhimin e municioneve të armëve të zjarrit në mënyrë artizanale.

LAJME SHKURT

■ Has, mbi 30% e mësuesve pa arsimin përkatës

Në Has, largimi i të rinjve drejt zonëve fushore, apo në emigracion ka bërë që të këtë rritje numri i mësuesve pa arsim përkatës në sistemin arsimor parauniversitar. Një gjë e tillë është këthyer në pengesën kryesore për rritjen e cilësisë në procesin mësimor. Drejtoresha e zyrës arsimore të rrethit, Nazlie Laci, thotë se, "Aktualisht mbi 30 për qind e personelit arsimor është pa arsimin përkatës. Ky është një nga problemet më shqetësues që kemi, një problem që vështirë se gjen zgjidhje të shpejtë, pasi është i pranishëm thuajse në të gjitha shkollat e rrethit". Mungesa të ndjeshme vërehen në lëndët e gjuhës se huaj, matematikës, fizikës etj, çka ka bërë që të punësohen mësues pa arsimin përkatës në shumicën e shkollave të rrethit.

■ Nis rikonstrukcioni i rrugës "Agush Gjergjevica"

Me një investim prej 94.7 milionë lekësh Bashkia e Tiranës do të mundësohet rikonstrukcioni i rrugës "Agush Gjergjevica", me gjatësi rreth 1.8 km. Kryebashkiaku Basha ka inspektuar dje nisjen e punimeve për këtë rrugë e cila do të ketë një gjatësi prej 7 metrash dhe me trotuaresh në të dy anët e rrugës, nga 1.5 deri në 2 metra. Ndonëse kjo rrugë në një gjatësi prej 500 metrash, gjendja e saj është tejet e amortizuar, pa kanalizime, trotuaresh, ndriçim dhe gjelbërimi as nuk mund të mendohet, - thonë banorët e zonës. Kreu i Bashkisë Lulzim Basha ka garantuar se kjo rrugë do të ketë të gjithë parametrat e nevojshëm dhe se në Tiranë ka përfunduar koha e asfaltave elektorale.

Punimet te "Petro Nini Luarasi"

Shkatërrohet bulevardi, lejohet qarkullimi

TIRANE

Punimet për rikonstrukcionin e bulevardit "Petro Nini Luarasi", vazhdojnë me ritme të ngadalta, shkaku për këtë është bërë qarkullimi i mjeteve në këtë bulevard, ndonëse Bashkia e Tiranës, ka ndaluar qarkullimin e mjeteve në pjesën ku po behën punimet. Nga një vëzhgim të bërë nga gazeta "Shqiptarja.com", në këtë rrugë shpesh herë punimet ndërpritën për shkak të kalimit të automjeteve. Drejtuesit e automjeteve thonë se kjo është e vetmja mënyrë për të kaluar në këtë rrugë, për të shkuar në



Bulevardi "Petro N. Luarasi"

destinacionin ku ata duan. "Unë jetoj këtu pranë tregut elektrik dhe vetëm këtu mund të kaloj nuk kam nga të kaloj tjetër për të shkuar në shtëpi" thotë ai. Për punimet që po kryhen te bulevardi "Petro Nini Luarasi", bashkia ka nxjerrë një njoftim ku thuhet se "Ndalohet qarkullimi i mjeteve në bulevardin "Petro Nini Luarasi", në anën veriore, nga bulevardi "Bajram Curri", rruga "Zonja Çurre", deri tek rruga "Taulantia" (nga perëndimi në lindje), deri në përfundimin e fazës së parë. Ndalohet qarkullimi i mjeteve në bulevardin "Petro Nini Luarasi", në anën jugore, nga bule-

vardi "Bajram Curri", rruga "Zonja Çurre", deri tek rruga "Taulantia" (nga perëndimi në lindje), deri në përfundimin e fazës dytë" Në segmentin rrugor gjithashtu është i ndaluar edhe parkimi dhe qëndrimi i automjeteve, nuk zbatohet. "Ndalohet qëndrimi dhe parkimi në të gjithë segmentin rrugor të bulevardit "Petro Nini Luarasi", sipas fazave ndërtimore" thuhet në njoftimin e bashkisë. Ndonëse në këtë segment rrugor shikon punonjësit e Policisë Bashkiake, qarkullimi dhe parkimi i mjeteve vazhdon të jetë i njëjtë si ai para fillimit të punimeve.

Biskota me tërshërë dhe pene me specia shumëngjyrësh

Dy receta për ata që duan të jetojnë si veganistë. Teknika të gatimeve dhe ushqimeve vegan

TIRANE

NGA DHURATA THANASI

Mirësevegani në rubrikën time! Jo nuk kam gabuar, por dua t'ju flas pak për menyrën e jetesës Vegan. Të jetosh vegan

është bërë tashmë një stil jete e shumë njerezve. Për arsye shëndeti por dhe për respekt për respekt kundrejt natyrës shume njerëz preferojnë të mos i zgjedhin prodhimet e mishit, peshkut apo dhe nënproduktet e tyre si qumështi, djathi, gjiza, dhe cdo gjë me prejardhje shta-



zore. Impakti në shëndetin e tyre ka qënë i jashtëzakonshëm por dhe në të mirë të planetit tonë. Duke adoptuar nismën "Një ditë pa mish një javë" i tërë planeti ynë do të përfitojë jashtëzakonisht! Vetëm në Itali, emetimet e dioksidit të karbonit, do të

redukoeshin në një masë të tillë që do t'i duhej një automjeti sportiv të përshkonte një rrugë prej 1 miliardë e 600 milionë kilometra. Për më tepër, në qoftë se një dietë e tillë do të ndiqej nga 1000 nxënës, jeta e 5000 pulave dhe 5400 lepujeve do të... ► vijon në faqe 17

VITI II NR: 4 E PREMTE, 1 SHKURT 2013

SUPLEMENTI I SË PREMTE S T E [SHQIPTARJA.COM]

Fundjava



E-MAIL: FUNDJAVA@SHQIPTARJA.COM

INTERVISTA E PLOTE

PAS KONCERTIT NE ROME, VIOLINISTI PREZANTON IDETE PER VENDLINDJEN

OLEN ÇEZARI: JU RREFEJ SI E SHOË SHQIPERINE TIME

"Kanë dëmtuar afresket e Onufrit? Çfarë tmerri... Po si mund ta ruajmë kulturën tonë????"

TIRANE

ANILA BASHA


Ai nuk është një emër i panjohur për Shqipërinë. Madje, vitin e kaluar gjithë verës qëndroi në vendin e tij. Olen Çezari, violinisti me famë botërore, javën e kaluar e gjeje në Romë, në një skenë gjigande, në një performancë madhështore, aq sa gjithë mediat italiane u morën me koncertin dhe agjencia Ansa agjencia numër 5 në botë e bëri si lajm te ditës. Në 25 janar Olen Çezari, shqiptari me violinë, shkëlqeu. Ishte një koncert bamirësie për "Marevivo" një shoqatë që merret me përkujdesjen dhe për shërbimin ndaj detin dhe bregdetin. Dhe Oleni, s'ka sesi të ndodhë ndryshe, kur takimin e parë me jetën në këtë tokë, e kishte me detin, Durrësin, qyteti në të cilin ka lindur. Gjatë një interviste në skype, Oleni rrëfen për Shqiptarja.com, emocionet e koncertit, por nuk harron të ndalet te realiteti shqiptar: votimi i tre ligjeve, peticioni... ► vijon në faqe 14



Në foto: Olen Çezari duke performuar në violinë dhe Kledi Kadiu duke kërcyer



LIBRI NE FUNDJAVE



"Revolta e Atlasit" të lexosh krizën

Vëllimi i dytë i trilogjisë "Revolta e Atlasit" i on heronjtë në një situatë ekonomike të vështirë, ku armiqtë janë identifikuar, por mbetet ende sekreti i motorit "magjik", i zhdukjeve të mistershme dhe i "kush është Xhon Galtti?". A do arrijnë Denji dhe Riardeni të... ► Faqe 17

FILMI NE KINEMA



Një komedi për Kevin James e Salma Hayek

Një Shqipëri Etnike me 64 mijë kilometër katrorë, pasaportë shqiptare për cilindo shqiptar që e do, apo çdo të huaj që... Një Shqipëri nike me 64 mijë kilometër katrorë, pasaportë 64 mijë kilometër katrorë, pasaportë shqiptare për cilindo shqiptarë huaj që... ► Faqe 16

Intervista

VENDLINDJA Pas koncertit të bamirësisë në skenat e Romës, violinisti na prezantohet me idetë për Shqipërinë

OLEN ÇEZARI:

Ju rrëfej si e shoh Shqipërinë time

"Kanë dëmtuar afresket e Onufrit ? Çfarë tmerri...Po si mund ta ruajmë historinë dhe kulturën tonë ????"

■ ■ ■ TIRANE

NGA ANILA BASHA

vijon nga faqja 13

...shkatërrimi i monumenteve të kulturës, çështja e nacionalizmit, pse jo dhe gjendja e rënduar e turizmit dhe infrastrukturës në Shqipëri. Një violinist me famë botërore si Oleni, na rrëfen sesi një shqiptar i sheh gjërat me syrin e një shqiptari të evropianizuar.

Olen, sa bileta u shitën?

Oh shumë, gjithë salla ishte plot me njerëz. Kisha shumë frikë, se çmimet e biletave ishin në fakt shumë të kripura. Por në sallë nuk gjeje vende.

Po sa ishte çmimi i biletës? A kishte shqiptarë të famshëm në koncert?

Po aty ishte gjithë ajka e Romës, biletat ishin 100 euro dhe më tepër.

Por ishte një koncert bamirësie mos me keqkupo: Nga Shqipëria më thanë se ambasada jonë në Romë kishte blerë 10 bileta. Në fakt, sikurse e kam thënë në një intervistë të Shqiptarja.com, unë nuk kisha ftuar asnjëri nga ambasada, sepse kam qenë i zhgënjyer nga një koncert që bëra shumë kohë më parë për jo ne Itali. Këtë rradhë vendosa të mos thërres askënd nga ambasada jone.

Por erdhen dhe per kete u ndjeva i lumtur.

Po ti nuk ftove asnjë shqiptar? Unë mora vesh se ishte Elsa Lila, e cila ka këngën "A kanë ujë ato burime" në albumin tuaj, por edhe Klejdi Kadriu...

Po të ftuarit ishin 6. Ishe fituesi i festivalit të San Remos Simone Cristicchi, pianisti cantautor Sergio Cammariere një super guest me te cilin u colaboroj ka 15 vjet dhe nje nga ikonat e viteve 80/90 ne bote Massimo di Cataldo, por edhe bandedonisti me i famshem ne europe Daniele di Bonaventura. Nga këta ishin edhe dy miqtë e mi Shqiptare që jetojnë në Romë, Elsa që është ekselencia jone për këngën dhe Klejdi për baletin. Elsa e këndoi në skenë këngën e saj live, po ashtu edhe Klejdi pati një debutim në zhanrin e tij të baletit sebashku me balerinen e pare te baletit te Romes Claudia Vecchi dhe interpretuan se bashu me mua dhe grupin tim Libertango te Piazolles. Nje mrekulli e papare.

Dhe kam dashur gjithmonë të të pyes: Si e presin këngën shqiptare "A kanë ujë ato burime" kur këndohet në skena të ndryshme në botë, dhe që në fakt është në albumin tuaj?

Kenga shqiptare është më e bukura dhe për të kanë shumë kuriozitet të gjithë. Është e tëra me nje rritem te



Violinisti Olen Çezari gjatë koncertit në Romë

theksuar shqiptar. Të huajt nuk janë mësuar të dëgjojnë këngë, rritme e melodi të tilla. Ajo madje, kam shumë sukses nga të gjitha.

Pse kjo këngë duartrokitet më shumë?

Nuk është problemi vetëm te duartrokijtjet. Por sapa mbaron koncerti, miqtë e mi në prapaskenë, por edhe nga publiku, interesohen në mënyrë të veçantë për këtë këngë.

Po e shkruan edhe mediat italiane që në këtë koncert bamirësie ju dolët me albumin e fundit "Unexpected" apo jo? Edhe aty ke një këngë për detin, me mikun tënd Lucio Dalla...

Po, po, ishte i njëjti album për të cilin performova në skenë bashkë me bandën time International Clandestine Orchestra. Albumi, ka pasur shumë sukses falë edhe faktit që Lucio Dalla këndoi ne këtë album

E di, edhe unë e kam një album tendin në makinën time. Vitin e kaluar në Shqipëri po ashtu bëri bujë...

Unë vitin e kaluar, gati gjithë pushimet, i kalova me koncerte në Shqipëri. Nëper sheshe. Dhe kam

performuar në Tirane, Sarande, Vlorë, në Durrës, edhe në Shkodër.

Po mirë, si të duket, e kuptojnë shqiptarët muzikën tuaj?

Çfarë thua!!!! Muzika ime është e marrë nga pjeset me te famshme boterore. Kam parë kaq shumë njerëz në shesh, në Durrës po e po, mua më dukej se ishin mbi pesë mijë veta në shesh. Por edhe në Sarande e Shkodër. Madje në Shkodër deri në rrugë, ishte dingas me njerëz. Të gjitha rrugët u bllokuan. Unë në fakt, mezi po i prisja këto koncerte në shesh, pa bileta, dhe me qytetarët shqiptarë që shijonin muzikën falas.

Më duket normale, Shkodra e ka këngën traditë muziken, pra e kupton.

E di Anila, më thanë se në Vlorë, ai baneri që është vendosur për koncertin tim, është ende në qytet i vendosur...

Po, e kam parë edhe unë. Madje kujtoja se ishte ende në Shqipëri. Le të kthehemi sërish te koncerti. Me këtë album keni

Bregdeti

Unë jam rritur në det. Ishte tmerr në fakt që isha në Shqipëri verën e kaluar dhe Durrësin e pashë...si të them...copë-copë. I vetmi vend që mund të bëje plazh, është diku poshtë të Bishti i Pallës. Portez quhet, pak më poshtë se Curriat

bërë tur rreth botës apo jo?

Ideja e fillimit ishte që udhëtimi të fillonte në Argentinë e të mbaronte në Australi. Dhe ky koncert i ishte dedikuar detit. Dhe kesaj rradhe ne vecanti udhëtimi ishte ne vij ujore.

Pse Olen? Ti nuk shkëputesh dot nga deti më duket mua...

Po patjetër. Unë jam rritur në det. Ishte tmerr në fakt që isha në Shqipëri verën e kaluar dhe Durrësin e pashë...si të them...copë-copë. I vetmi vend që mund të bëje plazh, është diku poshtë të Bishti i Pallës, Portez quhet, pak më poshtë se Curriat. Vetëm aty kam shkuar në plazh dhe ke edhe nje vend tjetër te mirë qe me duket quhet Aragosta . Shkova edhe tek plazhet e tjera rreth Adriatikut, por aty nuk qëndroja dot. Ishte e shkatërruar gjithëcka. Kurse nga Vlorë deri ne Ksamil bregdetit është një perle . Shpresojme ta mbajme ashtu dhe te bejme gjera me mend qe te mos ta shkatarrojme si plazhin e Durresit.

Mua më duket se shumicën e viteve të tua i ke kaluar jashtë. Kjo është përshlytja që krijon pas pushimeve të gjata në Shqipëri? E pisët e pa rregull?

Për mua ishte hera e parë që qendrova në vendlindjen time kaq gjatë. Dhe po ashtu ishte stresuese për të organizuar një gjë të tillë sic ishte nje "tur". Po kërkim të bënim një gjë shumë të madhe dhe me pak buxhet. Dua të falenderoj Florin dhe kompaninë e tij, që u moren me menaxhimin e skenës. Kam bere nje pune me



Në foto: Violinisti Olen Çezari gjatë koncertit në Romë

shume kualitet edhe pse fondet ishin te pakta dhe per kete e falenderoj shume. Nga ana tjetër dua të falenderoj ambasadorin e delegacionit të Komisionit Evropian në Tiranë, Et-tore Sequi dhe Ministrin e Kultures Aldo Bumci qe mundesuan kete tur. Ideja fillestare ishte që të bëja një tur koncertesh me sponsora private, por më pas, u ula me ato, dhe vendosëm ta bënim bashkë kete projekt. Një gjë e hapur, koncerte neper sheshet e Shqiperise gratis per te gjithë popullin. Dhe kjo ide u realizua.

E meqë të ka pëlqyer ky tur, do të kthehesh sërish për koncerte në Shqipëri apo jo?

Qejfi ma ka të organizojmë një tur të ri, siç e bëmë verën e kaluar. Ta bëjmë akoma më të bukur. Po mundohem ta realizoj. Ndërkohë, i kam dërguar sërish një projekt të tillë komunitetit europian ne Bruksel dhe shpresojme qe ta marrin ne konsiderate. Tani shumë shpejt do të shkoj për një koncert në Azerbajxhan. Në fund të shkurtit do të jem në SHBA për çmimet Oscar ku jam i ftuar. Mandej nga fundi i marsit apo nga prilli kam plane që të rikthehem në Shqipëri do shoh e do bej, por ma ka qefi te organizoj dicka te bukur sic e beme vitin qe kaloi ke i vetmi jazz club serioz ne Shqiperi ke Boom Boom Room .

OLENI DHE POLITIKA

Oleni për shumë vite u shkëput nga Shqipëria. Por këto kohë e fundit që ka filluar të rikthehet më shpesh në vendin e tij, padyshim i ndjek me vëmendje zhvillimet politike të brendshme. Unë nuk ngurroj ta ngacmoj për këtë pjesë, për të kuptuar sasa mund të ndikojë jashtë e brenda, një artist i madh si ai. Dhe dëgjoj disa rrëfime interesante për mënyrën sesi e sheh Oleni politikën.

Më the se do të vish në fund të marsit apo në prill. Po e di Olen, s'do



ta kemi shumë mendjen te koncertet. Është një fushatë e ëthshme zgjedhore. Sepse nuk e di nëse e ke dëgjuar, por do të kemi zgjedhje parlamentare në 23 qershor...

E di, e di. E kam dëgjuar. Unë i ndjek lajmet që vijnë nga Shqipëria. Po unë nuk kam ndërmend të ndikoj. Unë nuk jam as majtas, as djathtas. Jam i Shqiptarve. Më intereson politika që merret me zhvillimin e Shqipërisë, si brenda vendit ashtu edhe jashtë. Fakti që ka të majtë e të djathtë, nuk ka të bëjë me artistin. Artisti i perket popullit. Por dua t'ju kujtoj fjalët e një politikani të madh që thoshte: "moraliteti i personazhit politik qendron në ushtrimin e pushtetit që populli i ka dhënë me qellim që te ndjekë dhe te realizoj te mirën e te gjithëve".

E duke e ndjekur politikën, çfarë të ka bërë përshtypje më së fundi?

Po ja, më vjen keq për punën e tre ligjeve të famshme që nuk po bëhen. Dhe kur flasim me të huaj këtej, është e pabesueshme që na pyesin dhe na thonë: Po mirë si është e mundur që në Parlamentin tuaj nuk miratohen këto ligje që të zhblokohen fondet e Bashkimit Evropian për Shqipërinë. Dmth, të huajt nuk e kuptojnë dot faktin që të digjen fondet, gjithë kjo hyrje e madhe lekësh për vendin, në momentin që pjesa më e madhe e Evropës është në krizë. Kjo është një pikë, që as unë vetë nuk e kam kuptuar.

E bukur kjo e ligjeve. S'ma priste mendja të ma thoshe. Po mirë, ti e di se kush janë këto tre ligje që duhet të miratohen?

Jo, nuk i di. Por ky fakt për mua është sekondar, dytësor. Nuk e di fare pse nuk bëhen këto tre ligje. Unë nuk i di specifikat e kësaj gjëje, por është i pakonceptshëm fakti që nuk gjendet një akord mes të majtës

dhe të djathtës, në mënyrë që të hyjnë më shumë para dhe më shumë investime për Shqipërinë.

Po si mund të jepet një vlerësim pa e njohur konkretisht këtë çështje?

Nuk po jap një vlerësim... Në që nuk jetojmë në Shqipëri, dhe na pyesin kështu e konceptojmë. Këtu nuk arrin dot ideja se e majta dhe e djathta nuk janë në gjendje të zhblokojnë situatën për shkak të çështjeve të tjera. Këtu te ne, vjen vetëm fakti ekonomik. Ka kaq shumë fonde për t'u dhënë, dhe nuk jepen për këtë motiv. Kjo është pjesa e asaj që arrinë këtë. Dhe këtu arrin kjo gjë që e majta dhe e djathta nuk janë në gjendje te zgjidhin kete pune por po



bejne si tommy and jerry.

Ka një peticion që i kërkon opozitës të votojë tre ligjet. Ti e ke firmosur këtë?

Jo nuk e kam dëgjuar këtë gjë dhe nuk ma merr mendja që peticioni do arrij ndonjë qellim. Unë nuk e kuptoj se pse dy partitë kryesore të politikës, majtas e djathtas, nuk ulen në

tryezë të vendosin të zhblokojnë situatën. Ne kete menyre më duket se çështja do ishte me të thjeshtë.

Po të rikthehem te arti. Ke dëgjuar një lajm "tragjik" nga Shqipëria se janë dëmtuar afresket e Onufrit në një kishë të Elbasanit?

Ua çfarë tmerri. Nuk e kam dëgjuar. Po si ka mundësi, si ka ndodhur?

Nuk ka autor. Ministria ka thënë se nuk i ruan dot këto objekte. Njerëzit janë të varfër, ndoshta kanë dashur ti marrin e ti shesin dhe i kanë dëmtuar...

Po varfëri ka edhe në mes të Italisë dhe te Europës. Ka nga ata që fitojnë 800 euro ne muaj dhe 700 euro duhet të paguajnë qiratë e shtëpive. Nuk është ky problemi. Problemi është se italianëve nuk ju shkon në mendje të shkojnë e të vjedhin një Kishë apo ta demtojnë.

Ndoshta duan të vjedhin pasanikët, por gjërat e artit jo! ato jane te shenjta sepse bejne pjese ke historia e kombit. Dhe e shikoj tragjike këtë për Shqipërinë. Ne na i kanë vjedhur të gjitha gjërat e bukura në këto vite, dhe tani kanë dëmtuar edhe afresket e Onufrit?

Po, tragjike, por nuk është vetëm kjo. Gjithëka duket si në mëshirë të fatit...

E kam vënë re, ja është Amfiteatri i Durrësit që po ta shohësh, çfarë nuk i kanë bërë vërdallë dhe brenda. I kullontë kanali i ujërave te zeza ne tribunën e imperatorit! tmerri total! Për atë vepër, edhe italianët që kane nje perqindje te madhe te artit dhe te arkeologjise boterore na heqin kapelen. Më vjen shumë keq që e shoh në një gjendje të tillë.

Muzeu arkeologjik i Durrësit ishte nje vend me te cilin mbureshim ne europe tani eshte i mbyllur fare..

Mamaja e një shoqes sime këtu në Itali, ka dhënë 1 milionë e 250 mijë euro për të restauruar Fontana di Trevi. Po pasanikët e famshëm shqiptarë pse nuk dalin të thonë se

po japin ndonjë fond dhe këto para ti investojnë te Arti dhe ke historia e kombit? Dhe aty të mbajnë markën e tyre që thot kjo kompani e restauraj dhe po mirmban kete vend? Madje mund të ketë edhe politika qeveritare, e shtetërore për këtë çështje: psh, shteti të mos taksojë ato para të biznesmenëve që hidhen për ruajtjen e kulturës dhe traditës shqiptare ose ti sh-

POLITIKA shkëputja për shumë vite nga Shqipëria. Rikthimi gjithnjë e më shpesh në vendin e tij, padyshim i ndjek me vëmendje zhvillimet politike të brendshme

Në foto: Olen Çezari duke performuar në violinë dhe Kleidi Kadlu duke kërcyer



Përfshirja

Unë nuk jam as majtas, as djathtas. Jam i Shqiptarve. Më intereson politika që merret me zhvillimin e Shqipërisë, si brenda vendit ashtu edhe jashtë. Fakti që ka të majtë e të djathtë, nuk ka të bëjë me artistin. Artisti i perket popullit

karikoj nga taksat. Ne kemi shumë të huaj që duan të shohin Durrësin, Butrintin, Beratin, Krujën, e këta biznesmenë mund të investojnë dhe të vënë aty markat e tyre që ti bejne te njohura edhe neper bote.

E meqë kam hyrë në këtë bisedë për shumë çështje, ti Olen e ndjen veten Patriot? Nacionalist? Pra thua gjithandej në botë se je Shqiptar? Këtu në Shqipëri ka "shpërthyer" një ndjenjë nacionalizmi e madhe...

Nacionalizmi nuk mendoj se është një fenomen i mirë. Nuk i ka prurë askujt mirësi, edhe po ta shohësh ne historinë e botës. Nacionalizmi duhet të vijë në një moment kur dikush po te sulmon. Po ja psh, kam dëgjuar për Preshevën. Nëse atje dhunohen duhet të ketë reagim kombëtar dhe ndërkombehtar institucional. Por nuk besoj se nacionalizmi është një vegël e mençur për t'u përdorur. Ibrahim Rugova të cilin e konsideroj Gandin e Ballkanit, dikur ka thënë se nacionalizmi nuk është rruga e duhur por diskutimi dhe komunikimi jane armet e duhura.

Ndoshta kjo ndodh se ne Shqiptarët kemi akoma ide të së kaluarës?

Po mendoj se duhet të kalojnë edhe disa vite, sepse ne kemi ende reaksionet e vjetra brenda nesh. Pse e bëri dicka një person, dhe hajt tja prishim ne vend që te themi hajde ta bejme me mire se ai. Ndërkohë që

duhet të bëjmë të kundërtën. Ashtu sikurse e shoh se ka reaksion që lidhet ende me Komunizmin. Por them se gjeneratat e reja, pra ata që kanë lindur pas viteve '90, nuk e kanë këtë gjë brenda ne DNA. Por prindërit e tyre, sikurse e kuptoj unë, janë ende të lidhur me atë realitet te vjeter.

Po ty Olen, çfarë të bën krenar që je shqiptar? Dmth, nga ato gjëra që themi shpesh: Bujaria? Mikëprija?...

Jo, jo. Motivi i parë është se ne kemi një histori që kërkon vlerësimin e vet. Që do të thotë se nëse dikush sheh Amfiteatrin, Butrintin, Krujën, Beratin, duhet të kuptojë se shqiptarët kanë një histori të jashtëzakonshme dhe shume te lashte që duhet ta mbrojme dhe promovojme dhe kjo është gjë-

ja e parë. Në momentin që ti nuk do të dish për këtë, atëherë këtu e ke humbur fillin. Unë dua të zbris në Aeroport dhe ti shoh mrekullitë e historisë shqiptare të ekspozuara aty. Turistët që vijnë në Shqipëri, kur zbrisin nga avioni, nuk e dinë se ne i kemi këto perla historike. Atëherë ne duhet t'u prezantojmë. Kështu mendoj se historia vjen e para. Mandej është Kultura. Dhe për këtë, duhet t'i themi vetes: shyqyr që e kemi. Dhe të mendosh për Polifoninë shqiptare që nuk e dëgjon askund tjetër në bote. Por ne duhet të krenohemi për polifoninë tonë, muzikën tone, origjinalitetin dhe vecanerine e tyre. Veshjet dhe kostumet popullore kombetare. Pastaj vijnë këto elemente si besnikëria, mikëprija, të cilat kanë qenë vlera, por tani nuk e di nëse i kemi akoma apo jo.

Atëherë të gjitha këto të bëjnë të rikthehen në Shqipëri apo jo?

Ndaj të thashë se po planifikoj një koncert tjetër dhe nje tur tjetër ne Shqiperi

Kur erdha në Shqipëri, u ndjeva mirë. Kam gjetur gjithçka kam kërkuar. Por gjëja që më bezziste më shumë, ishte shqetësimi gjatë udhëtimeve. Isha vetëm me makinën time, i rashë si të them qark për qark Shqiperise dhe e kam ngare makinën pothuajse në gjithë botën, por gro-pa në rrugë si në Shqipëri nuk kam parë askund tjetër.

Dhe akoma e pyes veten... si është e mundur te lehen gropa te hapura ne autostrada ose puseta pa pakap neper qytete?

Ose pershembull policët në rrugë, nga Shkodra deri në Tiranë më ndaluan tetë herë dhe kjo është shumë bezdisëse kur kuan kanë asnjë motiv për të ndaluar.

Aha, të kërkuan lekë?

Po ndonjëherë dokumenta ndonjere nje kafe.

Këto janë gjëra që i dinë të gjithë. Por se kisha aty qellimin e bisedes

Dëshironi të shihni një film

PREMIERA Një komedi e vlerësuar për ritmin dhe kastin. Misioni i një profesori biologjie që shndërrohet në hero të arteve marciale

Premiera e fundjavës në kinema sjell "Here comes the Boom"

Një komedi për James e Hayek

Një film që dhuron të qeshura dhe kërshtëri deri në minutat e tij të fundit

PROGRAMET E KINEMASE

NE FUNDJAVE



Filmat në sallë

"Here come the boom"

(Në të gjitha oraret)

"Django Unchained"

(Në orën 15:00)

"Les Miserables"

(Në orën 20:30)

Orari dhe Çmimet

Filmi 2D

ora 10:30 - 300 lekë
 ora 13:00 - 300 lekë
 ora 15:00 - 500 lekë
 ora 18:00 - 500 lekë
 ora 20:30 - 500 lekë
 ora 23:00 - 500 lekë

Filmi 3D

ora 10:30 - 500 lekë
 ora 13:00 - 500 lekë
 ora 15:00 - 700 lekë
 ora 18:00 - 700 lekë
 ora 20:30 - 700 lekë
 ora 23:00 - 700 lekë

NE FUNDJAVE



Filmat në sallat Agimi

"Django Unchained"

(Në orën 12:00 dhe 18:00)

"Les Miserables"

(Në orën 15:00 dhe 21:00)

Orari dhe Çmimet

ora 13:00 - 500 lekë

Qendra Kristal

ora 18:00 - 500 lekë

Qendra Kristal

ora 12:30 - 500 lekë

AGIMI

ora 17:30 - 500 lekë

AGIMI

ora 20:00 - 500 lekë

AGIMI

ora 22:00 - 500 lekë

Scott Voss është një profesor i biologjisë që tash më mbyll ditët e tij të punës në një rutinë të mërzitshme. Por energjia e tij rikthehet kur në shkollë vijnë vendimi për të mbyllur programin muzikor të të pasionuarit profesor Streb, për shkak të mungesës së fondëve. Voss atëherë ofron ndihmën e tij për të gjetur 48 mijë dollarët e nevojshëm për të shmangur pushimin e kolegut të tij nga puna. E vetmja mënyrë që gjen për të arritur këtë shumë parash është që të bëhet një lojtar artesh marcialë e të marrë pjesë në disa ndeshje. Në fund të aventurës së tij, përveç shumë goditjeve në ring, ai arrin të fitojë edhe respektin e nxënësve dhe kolegëve të tij.



Vjen kështu historia e një mësuesi nëpërmjet filmit "Here comes the Boom", një komedi familjare kur komici-

teti dhe aksioni ndërthuren në një. Projektionet shqiptare të filmit fillojnë të premen, më 1 shkurt në kinema Mil-

lennium.

Filmi drejtohet nga regjisori Frank Coraci me protagonistin Kevin James, i

njohur tashmë nga "Zookeeper" dhe "Crown Up" dhe Salma Hayek, e cila sipas medias është rikthyer në formën e saj të dikurshme si një aktore simpatike dhe e dashur për publikun. Ndonëse tema e filmit është e thjeshtë, realizimi i tij është i tillë që dhuron të qeshura dhe kërshtëri deri në minutat e fundit kjo falë edhe lojës së aktorëve ku shquan interpretimi i James i cili këtë herë vjen me një rol pak më serioz se zakonisht por që vë më në pah aftësitë e tij aktoriale. Por James është gjithashtu edhe një nga skenaristët e filmit. "Here Comes the Boom" vlerësohet për profesionalizmin e tij dhe sidomos ruajtjen e ritmit, duke mos lënë mënjandë edhe kastin e mjaft të mirë të aktorëve.

"Django ..." tris fundjavash në Tiranë

Me 2 çmime Golden Globe për skenarin më të mirë nga Quentin Tarantino dhe aktorin më të joprotagonist nga Christoph Waltz, si edhe me 5 nominime Oscar, "Django Unchained" vijon projektionet shqiptare në fundjavën e tij të tretë. Produksioni me firmën Tarantino dhe një kast të sofistikuar aktorësh si Christoph Waltz, Jamie Foxx, Leonardo Di Caprio, Samuel L. Jackson dhe Kerry Washington vijon të shfaqet në kinema në të paktën një seancë në ditë. Ngjarjet e filmit vendosen në jug të Shteteve të Bashkuara të Amerikës para luftës civile. Django (interpretuar nga Jamie Foxx) është një skllav historia e tmerrshme të



cilit me ish pronarët e tij e con ballë për ballë me Dr. King Schultz (interpretuar nga Christoph Waltz) i cili është

në kërkim të kriminelëve vwlezwzr, Brittle. Vetëm Django mund ta drejtojë për tek ata, ndaj Schultz ble

SKEDA E FILMIT

Titulli: "Django Unchained"

Regjia: Quentin Tarantino

Skenari: Quentin Tarantino

Aktorë: Jamie Foxx, Leonardo DiCaprio, Christoph Waltz, Samuel L. Jackson, Gerald McRaney, Dennis Christopher

Gjinia: Aksion aventure

Kohëzgjatja: 156 minuta

ni e bind Schultz që të lërë të lirë Django. Por edhe pas kësaj ata të dy nuk ndahen nga njëri tjetri. Ndërsa Schultz drejtohet në jug për të kapur kriminelët e shumëkërkuar falë ndihmës së Django, ky i fundit përqendrohet në lirimin e gruas së tij, skllaves Broomhilda (interpretuar nga Kerry Washington), të cilën e humbi vite më parë.

Filmi i Tarantinos është vlerësuar maksimalisht si nga kritika ashtu edhe nga publiku amerikan. "filmat e Tarantino"- shkruan Roger Ebert gjatë recensionit të tij për "Django Unchained" - "janë një sfidë e drejtpërdrejtë për shumë tabu të shoqërisë sonë ...".

"Les Miserables", vijon muzikali i të mjerëve

Ndërsa është në pritje të verdiktit nga Bafta dhe Oscar për 17 nominimet në këto dy gara të rëndësishme kinematografike, "Les Miserables" shënon fundjavën e dytë në kinema. Me kritika pozitive, arkëtime të bujshme dhe tre statuja Golden Globes, dy nga të cilat për aktorin më të mirë Hugh Jackman dhe për aktoren më të mirë joprotagoniste, Anne Hathaway muz-

SKEDA E FILMIT

Regjia: Tom Hooper

Skenari: William Nicholson

Aktorë: Hugh Jackman, Russell Crowe, Anne Hathaway, Amanda Seyfried

ikali "Les Miserables" po përjeton ditët e tij të famës ndërsa gjeografia e projeksioneve është



të shtrirë thuajse në mbarë botën. Filmi, i vlerësuar nga Golden Globe si prodhimi më i mirë në gjininë e komedisë dhe muzikalit, është një produksion britanik i realizuar nga regjisori i Tom Hooper, i njohur për filmin "Fjalimi i mbretit". Ai është shkruar nga William Nicholson, Boubil, Schönberg dhe Herbert Kretzmer, ndërsa në rolet kryesore janë aktorët e njohur Hugh Jackman, Russell

Crowe, Anne Hathaway, apo Amanda Seyfried. Në krah të tyre interpretojnë edhe aktorët Sasha Baron Cohen dhe Helena Bonham Carter. "Les Miserables" është përshatja kinematografike e muzikalit të shkruar në vitin 1980 nga Claude-Michel Schönberg (muzika) dhe Alain Boublil (teksti). Ky ishte muzikali më i gjatë në historinë e Ëest End që zuri vend në ekranin e madh që u bazua në ro-

manin e fashmëm të Viktor Hugo. Në Francën e gysmës së dytë të shekullit 18, protagonist i historisë Jean Valjean, sapo ka dalë nga burgu. Me një emër të rremë, bëhet një sipërmarrës fatlum dhe kryetar i bashkisë së një qyteze franceze. I përndjekur nga inspektori Javert, është i detyruar që të lëvizë vazhdimisht, duke marrë me vete jetimen Kozeta, të cilën e rrit si bijën e tij.

Dëshiron të qëndrosh në shtëpi

"WEG WEDNESDAY" starton rubrika e re që jep receta dhe teknika të gatimeve dhe ushqimeve vegan

Luga
e argjendtë

Receta nga Dhurata Thanasi

Biskota me tërshërë dhe pene me specia

vijon nga faqja 13

...shpëtohet dhe secili prej nesh do të kursejë me ekuivalentin e konsumit të një llaambe të ndezur vazhdimisht për 277 ditë. Imagjinoni çfarë do të ndodhte në Shqipëri, ku mishi dhe nënproduktet e tij janë konsumi kryesor i popullatës!

Prej këtij numri, Luga e Argjendtë Receta propozon rubrikën "Weg Wednesday", e cila jep receta dhe teknika të gatimeve dhe ushqimeve vegan. Të jesh vegan nuk do të thotë të jesh vegetarian, pasi veganizmi është mënyrë të jetuari në respekt me natyrën dhe gjallesat e saj dhe nuk pranon në menunë e saj mishin dhe nënproduktet e tij si qumështin, vezët, djathin etj. Për sot po e filloj me një recetë biskotash foton e së cilës e botova ca ditë më parë në Facebook si dhe një pjatë me pasta tip Pene me zarzavate.

Shumë janë njëzërit që kanë zgjedhur të jetojnë vegan por unë përmend dy prej tyre që i kam më për zemër; Bill Clinton dhe Ellen DeGeneris.

PENE ME SPECIA SHUMËNGJYRËSH

Përgatitja:

Fillojmë me përgatitjen e salcës duke pastruar specat nga farat dhe bishti dhe i prerë në copa drejtkëndore dhe i hedhim në një tigan me bazë të gjerë ku më parë kemi hedhur vajin e ullirit dhe hudhrën dhe pak spec të kuq. I kaurdisim të gjitha derisa të jthi shteruar lëngu që nxjerrin specat. Shtoni domatet-qershi të prepra në katërsh dhe lërinë të ziejnë me salcën derisa të shterojë uji që kanë. Në një tenxhere me ujë të bollshëm,

Detaj

Përbërësit për katër persona
300 gr tërshërë (të pabluar)
1-2 lugë gjelle miell integral
2-3 lugë pekmez
frutash ose mjalte
Fruta të thata (bajame ose lajthi)
2-3 lugë gjelle rrush të thatë
Qumësht orizi/ soje ose ujë
1 lugë vaj ulliri




ku kemi hedhur dhe kripën e duhur, lërinë të valojë ujin dhe shtoni pastën. Mundohuni të mos e zieni shumë, domethënë derisa të fryhet në maksimum por ta lini "al dente", që do thotë: nëse merrni një pene dhe e vendosni në një pjatë, kur ta coptoni me pirua të shihni që shtrësja ka një pjesë të bardhë ndërmjet. Kjo do thotë që nuk është zier e plotë dhe që zgjat në varësi të miellit të përdorur. Mundohuni ta lini aq kohë sa është treguar në mbështjellësen e pastës. Gjithsesi, në këtë moment kullojeni pastën dhe shtoheni në salcën e përgatitur më parë. Mos harroni të lini gati 1 gotë uji me ujë të pastër, që do ta shtoni mbi pastën dhe salcën e përgatitur dhe ta lini në tigan derisa të shterojë. Mund të shtoni dhe pak vaj ulliri të freskët dhe trazojeni mirë. Ndajeni në pjata dhe zbukurojeni me djath Parmigiano Reggiano dhe majdanoz të freskët.



Profil

Mirësitë e tërshërës



Tërshëra është një drith me vlera të jashtëzakonshme që parandalon depresionin dhe gjendjet e ankthit apo ndikon në qetësimin e sistemit mendor. Ky drith gjithashtu parandalon Alcahiner dhe sëmundjen e Parkinsonit. Gjendet me kile në të gjitha pikat e Shtijes së Insulitit Kulinar Neraxhi. Gjithashtu tërshëra njihet edhe si një bimë mjaft e dobishme për dietat. Sipas profesorit francez Pierre Dukan, Tërshëra dhe produktet e sojës të shoqëruara me proteina ndihmojnë në uljen e peshës.

Libri

"Revolta e Atlasit", të lexosh krizën



Vëllimi i dytë i trilogjisë "Revolta e Atlasit" i con heronjtë në një situatë ekonomike të vështirë, ku armiqët janë identifikuar, por mbetet ende sekreti i motorit "magjik", i zhdukjeve të mistershme dhe i "kush është Xhon Gallti?". A do arrijnë Denji dhe Riardeni të jenë të lumtur së bashku? Si do i vejë filli industrive dhe hekurudhave? Dhe mbi të gjitha, pse zhduken njerëzit më të zotë të botës nisur nga Elis Viati, Hamond etj? Këto e shumë më shumë, do i gjeni në volumin e dytë të "Revolta e Atlasit", mjeshtërisht përthyer nga Amik Kasoruhio. "Revolta e Atlasit" u botua në vitin 1957 dhe që atëherë ka qenë në mënyrë të vazhdueshme një nga librat më popullore në SHBA.

Libri u rendit në vendin e gjashtë në listën e librave më të shitur të "New York Times"-it, tri ditë mbas botimit. Ai mbeti në listë për 21 javë dhe arriti në vendin e katërt. Në një sondazh të vitit 1991, "Revolta e Atlasit" rezultoi si libri i dytë më influencues pas Biblës. Libri ka shitur mbi 30 milion kopje gjatë gjithë historisë së tij dhe është botuar në 23 gjuhë të ndryshme. Ai ka shitur 3 milion kopje vetëm në tri vite, nga 2008-a deri në 2010-n, periudhë kur libri u "rikthye në modë". Sipas "The Economist", shitjet e librit duket se përkojnë me publikimin e të dhënave ekonomike. Sa herë që në ekonominë botërore dhe amerikane ndihen efektet e një krize, lexuesit i rikthehen Atlasit. Autorja e kwsaj trilogjie, Ayn Rand ishte një shkrimtare e filozofe amerikane, e para që ka mbrojtur në mënyrë të flaktë një ideologji të bazuar në lirinë individuale, egoizmin racional dhe etik.

Receta 2

Si të përgatisësh biskota me tërshërë

PËRGATITJA:

Merrni tërshërën, hidheni në një tas të madh, shtoni qumështin, (personalisht e bëj me ujë dhe më dalin të mrekullueshme) dhe lërinë të zbutet tërshëra. Nëse tërshëra nuk fryhet shtoni miellin që të lidhet. Merrni frutat e thata dhe shkërmoqini ose kalojini në grirës, por jo aq shumë sa të bëhen pluhur. Shtojni të tërshëra dhe më pas shtoni pekmez ose mjalatin. Pëzjejini mirë dhe me një Lugë të Argjendtë (bëj shaka!) ndajeni në një tavë të thjeshtë, të lyster me vaj ose ku keni vendosur një letër furre, të cilën do ta fusni në furrë me temperaturë 170



gradë celcius për 15 minuta. Fëmijët i hanë me shije sepse bëhen shumë krokante.

Përbërësit

350 gr makarona të tipit pene
3 specia mesatarë (të verdhë, jeshil, i kuq)
4-5 domate tip qershie
1 thelb hudhër, pak majdanoz,
4 lugë gjelle vaj ulliri ekstra i virgjër
Pak spec i kuq
Djath i tipit Parmigiano, Reggiano

Vila 12
KARAOKE NIGHT
LOUNGE BAR
RRUGA "MUSTAFA MATOHITI", PËRBALLË PALLATIT ME BIRRILA
Cel. 0696070651



RRETHE

Gjendet vajza e zhdukur, u dhunua në Rrëshen. Pranga të riut



Gjendet vajza 15-vjeçare e zhdukur pak ditë më parë në Kamëz. Ajo është lënë e lirë nga një ri, i cili e kishte marrë dhe dërguar në Rrëshen, ku dhe e ka përdhunuar. Policia e Mirditës ka arrestuar një 22-vjeçar, banues në Kamëz, pasi është denoncuar nga 15-vjeçarja për dhunë seksuale. Në

prangat e policisë ka rënë Bajram Bellova, i cili sas denoncimit të bërë nga e mitura me iniciale R.T, ajo është marrë me forcë nga vendi i saj i banimit, një javë më parë dhe është dërguar në Rrëshen. Sipas denoncimit të vajzës, ajo është dhunuar seksualisht dhe më pas e ka lënë të lirë. Denoncimi është

bërë ditën e djeshme në komisaratin e Kamzës, ndërsa kjo e fundit kishte kërkuar ndalimin e të riut. Pak më vonë, është arrestuar 22-vjeçari Bellova. Denoncimi për zhdukjen e vajzës një javë më parë, është bërë public në emisionin "Urbanika", në televizionin A1 Report, nga e ëma e saj.

SARANDE "Piccolino", i ndërtuar me lekë kamerash

Sekuestrohet hoteli i hajdutit "gjerman"

I riu, probleme me drejtësinë në Mynih

Lajmi

Drejtesia shqiptare vendosi sekuestron e hotelit "Piccolino" në Sarandë, në pronësi të Klaudio Dervishit. Ky i fundit akuzohet se ka vjedhur pajisje televizive në shtetin gjerman, në një dëm që kap shifrën e 3.1 milion eurove.

SARANDE

ELONA ELEZI

Një prokuror gjerman mbërriti të merkurën në Sarandë, për të marrë pjesë në sekuestron e hotelit të një personi, i cili dyshohet se ka vjedhur mallra, që arrijnë shumën e 3.1 milionë eurove në Mynih. Burime zyrtare pranë Prokurorisë së Përgjithshme bënë të ditur vënien e sekuestros së hotelit luksoz, i cili rezultoi të jetë në pronësi të Klaudio Dervishit. Nga të dhënat e vëna në dispozicion nga drejtësia gjermane, rezultoi se Dervishi, pjesë e një bande kriminale, është i përfshirë në vjedhjen që kap shifra të majme. Sipas burimeve, mësohet se në letërporsinë e nisur, kërkohet konfiskimi i aseteve dhe ushtrimi kontrolli dhe sekuestrimi i sendeve në kuadër të procesit hetimor që po zhvillohet në ngarkim të Dervishit dhe disa personave të tjerë të dyshuar si bashkëpunëtorë të tij. Burimet thonë se aktualisht, drejtësia gjermane vijon verifikimet për Klaudio Dervishin dhe personat e tjerë të përfshirë në rrjet, të cilët akuzohen për "vjedhje të pasurisë më shumë se një herë, në përmasa të mëdha" duke vepruar në kuadër të një bande kriminale.

Pas disa muajsh bashkëpunim mes prokurorive të të dy shteteve dhe pasi janë mbledhur provat e mjaftueshme se Klaudio Dervishi, së bashku me personat e tjerë të implikuar, kanë realizuar vjedhje me thyerje. Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda, pranoi kërkesën e Prokurorisë pranë kësaj gjykatë që të vendosë sekuestron konservative ndaj hotelit në pronësi të Dervishit. Burimet bënë të ditur se gjatë kontrollit në hotel "Piccolino" u sekuestruan në



Hoteli i sekuestruar në Sarandë

cilësinë e provës materiale një sërë dokumentacionesh të dyshimta si dhe pasaporta të falsifikuara.

Burime nga Prokuroria, kanë bërë të ditur se, sipas materialeve të ardhura nga gjermania, Klaudio Dervishi, me origjinë nga Tepelena, por me banim në Sarandë, akuzo-

het se në Gjermani ka vjedhur plot 2 kamionë me kamera televizive dhe aparatura transmetimi, të cilat mendohet se ua ka shitur shumë televizioneve në Tiranë e rrethe. Më pas, me ato lekë, ai ndërtoi hotelin katër katësh në Sarandë, të cilin ditë më parë iu vunë dhe shiritat e sekuestros.

Hetimet

Prokuroria: Të tjerë persona të përfshirë në vjedhje

Për drejtësinë gjermane, Dervishaj nuk ka qenë i vetëm. Nga të njëjtat burime zyrtare pranë Prokurorisë së Përgjithshme, bëhet e ditur, se së bashku me Klaudio Dervishin po hetohen dhe dhjetëra persona të tjerë, nënshetas shqiptarë dhe gjermanë. Në bazë të hetimeve të deritanishme të kryera nga prokuroria e Mynihut, ka rezultuar se në bashkëpunim me njëri-tjetrin, personat kanë realizuar një sërë vjedhjesh me thyerje, përgjatë një periudhe të gjatë kohore, në një dëm që kap vlerën e 3.1 milionë eurove. Sekuestrimi i hotelit të



Dervishit duket se nuk i ka dhënë ende fund punës së përbashkët mes prokurorive të të dy shteteve. Siç mësohet, urdhër-sekuestroje është lëshuar edhe për pronat e disa bashkëpunëtorëve të Dervishit, në Shqipëri, por edhe jashtë saj.

LAJME SHKURT

■ Pogradec, zjarr në karburant

Një pikë karburanti në hyrje të qytetit të Pogradecit është përfshirë nga flakët, por fatmirësisht nuk ka patur të lënduar. Ndërsa dëmet material kanë qenë të mëdha. Ngjarja ka ndodhur rreth orës 16:40, ndërkohë që nga policia konfirmohet se shkak për këtë është bërë çarja e tubit të gazit, në momentin që një kamion po furnizohej. Në vendin e ngjarjes kanë mbërritur zjarrfikëset, të cilat kanë mundur të lokalizojnë flakët, duke vënë kështu në kontroll situatën. Pikës së karburantit i janë shkaktoar dëmet të mëdha material, megjithë ndërhyrjen e menjëhershme të zjarrfikësve.

■ Korçë, dy në pranga për rëmbim

Një tentativë rëmbimi, është parandaluar dhe nga policia e Korçës, pas njëkonflikti për shërbimin taksi mes disa personave. Sipas policisë, Lulëzim Jazexi dhe Ermal Gora, banues në Tiranë, kanë tentuar të marrin pa dëshirën e tij, Izet Sulejmani, banues në Maliq. Konfirmohet se dy të arrestuarit në datën 30 janar, kanë hyrë në makinën me targa AA 166 FG, në pronësi të Izet Sulejmanit dhe e kanë detyruar këtë të fundit t'i çonte në Tiranë. Kur ai nuk ka pranuar, ata e kanë detyruar të nisët. Ndërsa dy personat, Jazexi dhe Gora u arrestuan në flagrancë dhe akuzohen për veprën penale, "Heqje e paligjshme e lirisë së tjetrit".

■ Vlorë, ekstradohet i kërkuar

Inperpoli britanik ka sjellë në Rinas një të kërkuar për vrasje. Policia e Vlorës njoftoi dje se, Vanjel Bregu, 27 vjeç, është ekstraduar nga Anglia, për llogari të Gjykatës së Vlorës. Ky person ishte shpallur në kërkim nga Drejtoria e Policisë Qarku Vlorë, pasi më datë 04.04.2005, në Selenicë, për motive të dobetë ka tentuar të vrasë shtetasin me iniciale M.D. Ai është dërguar dje në Burgun e Sigurisë së Lartë 302 në Tiranë, ndërsa pritet që ndaj tij të nisë procesi gjyqësor.

ITALI Ndjekja

Për 50 euro, shqiptari dhe italianja vdesin në aksident

TERNI



Maria Elena e vdekur në aksident

Një 25-vjeçare italiane ka vdekur në vend, gjatë një aksioni policor për kapjen e dy shqiptarëve, të cilët kishin vjedhur 50 euro. Ndërsa viktimë mbeti dhe një prej shqiptarëve. Ngjarja e rëndë ndodhi në Terni, dy shqiptarët po ia mbathnin me një makinë e tipit "Fiat Panda". Mjeti i tyre u përplas me makinën në të cilën ndodhej vajza, teksa mundohet t'i shpëtonte policisë italiane. Njëri nga djemtë, 28 vjeç, vdiq në vend, ndërsa tjetri, 21 vjeç është plagosur rëndë dhe ndodhet në gjendje kritike për jetën, bën të ditur agjencia e lajmeve ANSA. Aksidenti ndo-

dhi ndërmjet zonës Terni e Spoleto. Policia italiane bëri me dije, se po i ndiqte të rinjtë, pasi në bashkëpunim

me dy të tjerë, i kishin vjedhur një të moshuari 64-vjeçar, 50 eurot që ai kishte në portofol. Më pas, hajdutët ia kanë mbathur e për këtë arsye policia, e lajmëruar nga i grabituri, është vënë në lëvizje për t'i arrestuar. Në orën 5 të mëngjesit, ka ndodhur edhe përplasia mes makinave, prej të cilit vdiq shtetasja italiane Maria Elena, shqiptari 28-vjeçar dhe u plagos tjetri 21 vjeç. Ndërkohë, policia është vënë në kërkim të dy të tjerëve që morën pjesë në vjedhje. Mediat italiane nuk bëjnë të ditur identitetin e viktimës shqiptare, ndërsa ajo e vajzës italiane u publikua. Ndërkohë, ende nuk dihet me saktësi, se si ka ndodhur vjedhja e eurove të të moshuarit, nëse ia kanë marrë portofolin nga xhepi, apo në ndonjë ambient tjetër.



**Gjirokastër, kapet
pistoleta që do
shitej në Athinë**

Situata jo e qetë në Greqi, kryesisht në Athinë, duket se e ka rritur kërkesën e vendasve për armë. Madje, duket se armën kanë filluar të pëlqehen masivisht. Ndërsa në këtë trafik, duket se po përfshihen gjithnjë e më shumë element të ndryshëm që kërkojnë të kalojnë të tilla edhe nga Shqipëria. Dje në mesditë, policia e Kakavijës, ka ndaluar, kalimin për në Greqi, të një pistolette tip "Zastava",

prodhim serb, së bashku me karikatorin e mbushur me shtatë fishekë. Ka qenë ora 12:30, kur Ervin Hunçi, 22 vjeç nga Durrësi, është arrestuar nga ana e Policisë së Kakavijës, teksa tentoi të trafikonte për në shtetin fqinj, pistoletën. Gjithëka është zbuluar gjatë një kontrolli sekondar në vijën e dytë kufitare në Kakavije nga ana e kontrollorëve të pikës kufitare, në bagazhet e autobuzit të linjës me Athinë.

Autobuzi ishte nisur nga kryeqyteti shqiptar në mëngjes dhe kishte për destinacion Athinë në bordin e të cilit, ndodheshin 35 pasagjerë. Pas disa minutash kontrolli, policët, kanë zbuluar pistoletën, brenda valixhes që ishte pronë e 22-vjeçarit durrsak. Siç ka thënë i arrestuari në polici, armën do ta shiste në Athinë, kundrejt 750 eurove, tek një shtetas grek.

GJIROKASTER Policia: Materialet, nga kishat ortodokse

Blokohehen objekte të vjedhura në kisha

Çanta çohej në Greqi, pranga pronarit durrsat

Lajmi

Një sasi e madhe objektivisht kishtare me vlera të mëdha, është ndaluar të kalojë kufirin me Greqinë, nga Policia e Kakavijës. Objekte kishtare, kryqë, ikona, të cilat mendohet se janë të vjedhura nëpër kishat në Shqipëri, janë zbuluar në çantën e Edjon Abazit, 24 vjeç nga Durrësi.



Objektet kishtare të bllokuara dje në Kakavije

kryq, ikona të ndryshme, si dhe pjesë të ikonostasit të epitaftit. Ndërsa menjëherë është sekuestruar malli me vlera të mëdha monetare, nëse do të dërgohej për t'u shitur në Greqi, i janë vënë prangat edhe trafikantit të këtyre veprave. Të gjitha këto objekte, sipas policisë, rezultojnë të grabitura në disa kisha ortodokse në Jug të vendit, por që nuk dihet se në cilat.

Policia e Gjirokastrës, prej kohësh, është vënë në ndjekje të autorëve të grabitjeve të objekteve të kultit, disa prej të cilëve, ende nuk i ka prangosur. Kisha të tilla, si ajo e Leusës, e Shën Triadës, si dhe të tjera në zonën e Dropullit në Gjirokastrë, kanë rënë prehtë e grabitjeve të dhunshme dhe mendohet se disa prej objekteve të kapura ditën e djeshme në Kakavije, i përkasin pikërisht atyre. Policia Kufitare ka bllokuar poseduesin e veprave të kultit, duke vënë në dijeni grupin hetimor, i cili ka mbërritur



Objektet kishtare të bllokuara dje në Kakavije

menjëherë në vendngjarje, së bashku me specialistët e Seksionit Kundër Trafikeve Ilegale, në Drejtorinë e Policisë së Qarkut. Këta të fundit, po punojnë për zbardhjen e plotë të këtij trafiku dhe origjinën e këtyre veprave, përfshirë dhe pjesëtarët e tjerë të implikuar në këtë trafik. Ka qenë kjo arsyeja, përse nuk bëhen të ditura të dhënat e personit që është kapur në tentativë për t'i kaluar ato, drejt Greqisë.

GJIROKASTER

Informacionet duket se kanë tradhëtuar një person, i cili tentoi të dërgojë në Greqi, një sasi të mëdha objektivisht kishtare. Megjithatë i qetë në makinën e tij, i shoqëruar dhe nga një person tjetër, është munduar të mos ngjallë asnjë dyshim për policinë kufitare të Kakavijës. Por, siç mësohet, informacioni për çantën e mbushur me objekte me vlerë, ishte marrë tri orë para se makina të mbërrinte në kufirin me shtetin grek. Policia Kufitare në Kakavije, ka mundur të bllokojë kalimin e tyre për në Greqi, duke zbuluar sasinë më të madhe të kapur ndonjëherë në këtë nyje kufitare. Ka qenë ora 15:00 e ditës së djeshme, kur efektivat e Policisë Kufitare të Kakavijës, mundën të identifikonin objektet kishtare, të cilat do të trafikoheshin nga një i ri nga Durrësi, i ruajtur Edjon Abazi, 24 vjeç. Akcioni, sipas Drejtorisë së Policisë së Kufirit në Gjirokastrë, u mirëkoordinua nga kreu i Drejtorisë së Kufirit, Admir Abrija, i cili kishte dijeni për trafikimin e objekteve kishtare, tri orë para se ato të mbërrinin në Kakavije, për të kaluar më tej kufirin. Duke identifikuar automatjetin në të cilën ndodheshin objektet e grabitura, policët e Kakavijës, e kanë ndaluar atë, duke ushtruar më pas, një kontroll të imtësishëm në vijën e dytë kufitare. Në au-

tomjet, sipas të njëjtave burime zyrtare, udhëtonte shoferi, Abazi dhe një pasagjer. Ky i fundit, çantën e

madhe, e kishte të tejmbushur me një numër të konsiderueshëm objektivisht kishtare ortodokse mes të cilave,

KURBIN Misteri

Var veten me litar vajza 17-vjeçare prindërit në polici: S'kishte arsye

KURBIN

Një vajzë 17-vjeçare i ka dhënë fund jetës, duke u vetëvaruar, në rrethana krejt të misterishme dhe për shkaqe që nuk dihen. Adoloshentja është gjetur pa jetë në banjon e shtëpisë nga e ëma, ndërsa policia deklaroi se nuk kishte shenja dhune në trup. Nderkaq, familjarët e pyetur në polici, kanë treguar se nuk dinin ndonjë arsye që mund ta kishte çuar vajzën A.L. të vetëvarej në litar. Ngjarja ka ndodhur dje paradite, në në fshatin Mal-Bardhë të rrethit të Kurbin. Sipas burimeve zyrtare të policisë së këtij rrethi, mësohet se 17-vjeçarja ka qenë e vetme në shtëpi, ndërsa prindërit e saj ishin në punë. Vajza, siç mësohet, ka marrë një litar



dhe ka shkuar në banjon e shtëpisë, ku një hekur i taracës, i cili ishte i dalë, i ka shërbyer për të vënë litarin. Kaq është dashur dhe pas pak minutash adoloshentja ka qenë pa jetë. Nëna e saj, rreth

orës 10 është kthyer nga puna dhe kur ka hyrë në shtëpi, nuk e ka gjetur të bijën. Pasi ka thirrur disa herë dhe nuk ka marrë përgjigje, ka parë në të gjitha dhomat e shtëpisë. Kur nuk e ka gjetur, ka shkuar në banjë dhe aty është përballur me skenën e dhimshme. Ajo ka gjetur vajzën në litar. Menjëherë e ka ulur në tokë, por ishte e kotë. Vajza kishte ndëruar jetë. Ndërsa janë lajmëruar familjarët tjerë, në fshat ka mbërritur edhe policia, e cila ka marrë në pyetje familjarët, si dhe më pas ka kqyruar trupin e viktimës. Burime nga policia e Kurbinit njoftuan, se në trupin e vajzës nuk janë gjetur shenja dhune. Ndërsa lidhur me shkaqet, familjarët e saj kanë ngritur supet. Megjithatë, mendohet se një depression i momentit, apo i kohëve të fundit dhe i pavënë re nga prindërit, të kenë qenë shkak.

Vlorë

U vetëdogj tentoi edhe 3 herë të tjera

Në lidhje 47-vjeçar. Ni cili u vetëdih pas një peme, më pas i vuri flakën vetes, të afërm dhe fqinj të tij tregojnë se ai kishte tentuar edhe tri herë të tjera të njëjtën gjë. Fatmir Hysi, sipas fqinjëve dhe disa kushërinjve, prej 17 vitesh është kthyer në Shqipëri, pasi kishte emigruar në Gjermani për pak vite. Por, qëkur është kthyer, gjëndja e tij mendore nuk ka qenë mirë. Të afërmit tregojnë se, 3 herët tjera e kanë ndaluar njerëzit dhe nuk e kanë lënë të vetëdijet, ndërsa para dy ditësh, ia ka dalë. Me qëllim që të mos e zgjidhnin shpejt, ai ka kthyer trupin në një pemë, në oborrin e shtëpisë, duke lënë duart e lira. I ka hedhur benzinë vetes dhe ka nxezur çakmakun. Sapo njerëzit e kanë parë, kanë tentuar ta shpajnë, por ka qenë vonë.

Intervista

■ ■ ■ TIRANE
DHURATA HAMZAI

Në Akademinë e Arteve mbrëmë u dha një koncert i veçantë simfonik. Specialistët e muzikës pohojnë se një krijimtari e tillë instrumentale nuk është dhënë asnjëherë në Shqipëri. Trompisti i njohur, pedagog në Universitetin e Arteve, Tiranë, prof. Sokol Saraçi, është shfaqur si solist me risi instrumentale me muzikë "Baroque" nga A. Vivaldi, shogëzuar me violinë nga studentja Rozarta Luka. Në intervistën për "Shqiptarja.com" Saraçi rrëfen se në këtë koncert u përdorën për herë të parë disa instrumente, përfshi edhe Klavicembalon, gjë që bën të mundur sjelljen në variantin sa më origjinal të muzikës. Në koncert ishte i ftuar tenori Kastriot Tusha. Ky koncert u bë kinse për instrumentin e trompës, duke thyer traditën e kufizuar të lojës në trompë. Për vite me radhë në Shqipëri në trompë është mësuar të luhet vetëm në Si Bemol, thotë Saraçi duke theksuar "se këto janë nivele të ulëta ekzekutimi". Pas disa përpjekjeve të tij muzikanti profesionist rrëfen se në këtë koncert për herë të parë është luajtur me instrumentet Trompa Pikolo dhe Flikorno Soprano. Hera e parë nuk është vetëm për Universitetin e Arteve, por sipas tij, në të gjithë Shqipërinë "është një promovim për herë të parë". Në repertorin e koncertit mbrëmë u ekzekutuan muzikë nga kompozitorët të ndryshëm si Mozart, Sibelius, K.Laro, etj.

Zoti Saraçi, më rrëfeyt se mezi e keni pritur këtë koncert. Cilat janë arsyet e entuziazmit tuaj?

-Për ne dhe për studentët përbën një hyrje të re të një loje moderne. Luhet në instrumentin e Trompës Pikolo, gjë që ma bëri të mundur shkolla ime në Amerikë. Luhet për herë të parë. Pas kësaj do të luhet edhe një adaxhio nga Rodrigues. Është një adaxhio që vjen nga një transimision me kitarë dhe këtë do ta luajë nga një instrument tjetër i ri, Flikorno Soprano. Kjo është e shkruar nga mjeshtërit botërorë pikërisht me këtë instrument. Domethënë vjen një krijimtari muzikore e shkruar për këto instrumente që deri tani Shqipëria nuk e ka promovuar dhe nuk kanë pasur mundësi të ekzistojnë si instrumente.

Pra, ky ishte shkak kryesor i idesë së këtij koncerti?

-Po. Pasi u ktheva nga Amerika në 2011-n kam pasur idenë që këtë instrument shpesh kam folur edhe me instancat drejtuese të universitetit që punoj që është mirë t'i kemi dhe t'i luajmë këto familje instrumentesh, sepse trompa ka 6 familje instrumentesh.

Pse pikërisht juve shfaqët



Trompisti Saraçi me llojet e reja të instrumenteve që ekzekutuan në koncertin e mbrëmshëm

TROMPISTI i parë i operës rrëfen risitë e koncertit që u dha mbrëmë në Universitetin e Arteve. Instrumentet që luhen për herë në Tiranë. Tenori Tusha shoqërohet me Flikorno Soprano

Koncerti

Me drejtuesin e orkestrës, kolegun tim Alqi Lepuri biseduam dhe vendosëm të vijmë në këtë koncert me një risi shumë interesante që plotëson edhe mungesën aktuale në marrëdhënie edhe me orkestrën e operës.

dhe të përhapet kjo gjë e re. Me drejtuesin e orkestrës, kolegun tim Alqi Lepuri biseduam dhe vendosëm të vijmë në këtë koncert me një risi shumë interesante që plotëson edhe mungesën aktuale në marrëdhënie edhe me orkestrën e operës.

SOKOL SARAÇI: Kriza e instrumenteve te Universiteti i Arteve "Trompës i binim vetëm në Si Bemol"

këtë interes të veçantë?

-Unë jam pedagog dhe jap lëndë speciale të trompës. Dhe në mësimdhënie që unë përdor jam i prirur në shkollën liberale dhe kam synuar t'i prekin vetë studentët këto instrumente dhe jo thjesht t'i imagjinoj. Sepse për hir të së vërtetës në vitin 2012 gjithë

bota ka arritur të luajë me këto instrumente, ndërsa për fat të keq në Shqipëri mungojnë. Ndaj ka kam bërë me universitetin një punë që e kemi lidhur edhe me licetë si me Liceun e Beratit, për të evoluuar dhe dhënë një kontribut në instrumentet e tunxhit. Unë u thashë se i kam blerë këto instrumente sigurisht

me shpenzimet familjes sime dhe ëndrra ime është jo thjesht t'i demonstroja vetë, por të dalim me një koncert që të promovojmë në Shqipëri këto instrumente që të njihen, jo vetëm nga specialistë e fushës së instrumentistëve, nga ata të tunxhit si i themi ne, por të njihen edhe nga mbarë publiku i gjerë

Ceremonia

Lëvizja Shqipëria e Re promovon librin "Turqia, nga fuqi rajonale në superfuqi botërorë"

■ ■ ■ TIRANE

Lëvizja Shqipëria e Re ka organizuar dje ceremoninë e promovimit të librit "Turqia, nga fuqi rajonale në superfuqi botërorë", botim i Qendrës së Mendimit Pozitiv pranë kësaj lëvizjeje. Ceremonia u zhvillua në hotel Sheraton dhe mblodhi dhejtra miq të Lëvizjes Shqipëria e Re, përfaqësues të trupit diplomatik dhe krerët e ambasadës turke në Tiranë. Promovimin e këtij libri e hapi drejtuesja e Qendrës së Mendimit Pozitiv, Mira Përlala, e cila falenderoi të pranishmit dhe tha se ky libër vjen si një vazhdim i studimit mbi Turqinë pas librit tjetër "Turqia e Re e Erdoganit të Madh". Ndërkohë gazetari Cerciz Loloçi që është marrë posaçërisht me mbledhjen e materialeve për botimin e këtij libri tha se "në këtë libër të dytë ne kemi përzgjedhur 77 raportime nga katër agjenci prestigjioze: Balkantimes, BBC, Zëri i Amerikës dhe Dojçe Velle që flasin për trans-



Takimi i lëvizjes Shqipëria e Re

formimet e thella që kanë ndodhur në këtë shtet të rëndësishëm". Ceremoninë e përshëndeti kryetari i Lëvizjes Shqipëria e Re, zoti Edmond Vlashaj, i cili tha se ky libër sjell një

këndvështrim të mediave më të rëndësishme mbi rritjen ekonomike dhe politike të Turqisë dhe rolin e saj në arenën botërore. Ai vlerësoi gjithashtu marrëdhëniet e mira mes Shqipërisë dhe Turqisë. Libri ka në fokus Turqinë e sotme, atë shtet të stërmadh mes Azisë dhe Evropës që, falë reformave të ndërmarrura nga Partia për Drejtësi dhe Zhvillim (PDZH) dhe liderit të tyre, kryeministri Erdogan, vijon të shfaqet si një mrekulli ekonomike, vendi i dytë për ritmet e rritjes, anëtare e kahershme e NATO-s, partnere e ngushtë e SHBA-së dhe një nga kontribueset më të rëndësishme të paqes në botë. Ndërsa në librin e parë "Turqia e Re e Erdoganit të Madh" u sollën në shqip nga turqishtja të dhënat zyrtare të PDZH-së dhe të selisë së kryeministrisë, në këtë botim janë përzgjedhur disa nga artikujt dhe raportimet më të spikatura të agjencive perëndimore, mes të cilave BBC, SETimes, Voice of America (VOA) dhe Deutsche Welle (DW).



Turizmi


AMBASADORI i SHBA-së, në Shqipëri, foli mbi rëndësinë e gjuhës angleze për shqiptarët dhe në takimin me Unionin Anglishtfolës

Arvizu: Nevojiten guida anglisht për monumentet

Zenel Hoxha: Takimi, një mësim i mirë për industrinë e turizmit

■ ■ ■ **TIRANE**
DHURATA HAMZAI

Ambasadori i SHBA-së, në Shqipëri, Aleksandër Arvizu i pranishëm në takimin me temë "Gjuha angleze dhe rëndësia që ka mbi turizmin në Shqipëri", organizuar nga ESU, Unioni Anglishtfolës, dega Shqipëri, pasi ka treguar disa nga përvojat e tij duke udhëtuar së paku për dy vjet në pikat turistike dhe arkeologjike të vendit tonë, ka pohuar se Shqipëria është një vend "me hapësira të mëdha turistike". Ambasadori i SHBA-së, deklaroi se mësimi i gjuhës angleze është prioritet për zhvillimin e turizmit vendas. Arvizu tha se turizmi i Shqipërisë varet nga mësimi sa më i gjerë i anglishtes, gjuhë të cilën e cilësoi si një mundësi që bashkon gjithë botë. "Qeveria duhet të vazhdojë të mbështesë mësimin e gjuhës angleze, sidomos për ata që punojnë në industrinë e turizmit", tha Arvizu, pasi përmendi disa prej investimeve të qeverisë në këtë sektor. Unioni Anglishtfolës në bashkëpunim me Ambasadën e SHBA-së, zhvilluan dje takimin me studentët, mbi rëndësinë e gjuhës angleze në turizëm, me qëllim ndërgjegjësimin e publiku mbi përdorimin e anglishtes. "Zgjedhëm turizmin, jo vetëm për t'ju motivuar që të studioni më shumë, por edhe për t'ju dhënë disa praktika pse anglishtja është e rëndësishme për biznesin dhe sektorin e ekonomik në vend", tha Aleksandër Arvizu. Me këtë rast ambasadori Arvizu tërhoqi vërejtjen për disa probleme që dalin me organizimin e turizmit në vendin tonë që lidhen pikërisht me gjuhën angleze. "Kenë nevojë për guida ne muze që të jenë anglisht,



Ambasadori Amerikan në Tiranë Aleksandër Arvizu dhe drejtori i Unionit Anglishtfolës, Zenel Hoxha

nevojë për shenja në anglisht që të shpjegojnë monumentet arkeologjike, nevojë për shërbyes në lokale që shpjegojnë në anglisht menynë", tha Arvizu. Sipas, ambasadorit, "anglishtja është një biletë për gjithë vendet që mund të vizitoni, ku tabelat dhe gjithçka tjetër shpjegohet në anglisht për turistët".

1 bilionë e gjysmë njerëz flasin anglisht në të gjithë globin, 400 milionë e konsideron atë si gjuhë të parë, kujtoi Arvizu për audiencën. I pranishëm në takim, drejtori i Unionit Anglishtfolës, Zenel Hoxha, tha se "ky takim është një mësim i mirë për industrinë e turizmit". Unioni Anglishtfolës në Shqipëri

është hapur në vitin 2009 me qëllim mësimin dhe përmirësimin e gjuhës angleze në të gjitha shtresat e shoqërisë e cila në mënyrë direkt dhe indirekt krijon mundësi të shumta komunikimi. Sot rreth, 1 bilionë e gjysmë njerëz flasin anglisht në të gjithë globin dhe rreth 400 milionë e konsiderojnë atë si gjuhë të parë.

Pronarja
"Mburojeni ose na dorëzoni shtëpinë e Kongresit"



Shtëpia e "Kongresit të Lushnjës"

Familja Fuga, e cila njihet si pronare e shtëpisë muze të Kongresit të Lushnjës, pasi ka parë gjendjen aktuale të kësaj godine historike u bën apel instancave përkatëse të kujdesen dhe të investojnë për shtëpinë muze. Mbresa e familjes Fuga, Nermin Vokopola, nëpërmjet Kameras së A1 Report, gjithashtu i kërkoi Bashkisë së Lushnjës të paguajë qiranë sipas marrëveshjes së bërë ose në të kundërt të kthejë shtëpinë ish-pronarëve të ligjshëm. Vokopola shprehet se është një ndër shtëpitë më të vjetra të Lushnjës. "Ajo shtëpi ka vlera jo vetëm muzeale, por edhe vlera arkitektonike pasi është 250 vjeçare. Me ardhjen e demokracisë Bashkia që e interesuar ta merrnin për muze sepse ka vlera. Ndërkohë që ne asnjëherë nuk kemi marrë qira të rregullt, në bazë të kontratave që kemi vendos me ta. Ata kanë vendosur një qira sipas normativave dhe asnjëherë nuk e kanë zbatuar këtë kontratë dhe fakti është që ne vuajmë akoma nëpër gjyqe, nëpër përparime edhe nuk marrim dot qiranë e shtëpisë. Nëse ata nuk duan ta mbajnë, nuk kanë mundësi ta mbajnë le ta dorëzojnë shtëpinë", - pohoi Nermini. Shtëpia muze e Kongresit të Lushnjës administrohet aktualisht nga Bashkia e qytetit. Ditën e mërkurë forumi për Mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore vizitoi shtëpinë e Kongresit të cilët kanë bërë apel për ndërhyrje pasi është e dhimbshme të shohësh shkatërrimin e monumenteve kulturore.

Forumi për Trashëgiminë

Ndërhyrje skandaloze në Kalanë e Ali Pashës

■ ■ ■ **TEPELENE**

Punimet për rikonstruksionin e kalasë së Tepelenës, e ndërtuar rreth vitit 1819, sipas burimeve zyrtare nga bashkia e këtij qyteti sapo kanë përfunduar, falë investimit prej 3 milionë e 600 mijë lekësh të reja, të akorduara nga qeveria shqiptare në institucionin e MTKRS-së. Po këto burime kanë deklaruar se "po kthehen në identitet disa nga mjediset dhe muret më të dëmtuara të kësaj kalaje nga më të rëndësishmet në jug të vendit", por këto fotografi të marra nga punimet e sapopërfunduara në hyrje të Kalasë së Tepelenës nga Forumi për Mbrojtjen e Trashëgimisë rrefejné raste flagrante të shkatërrimit të identitetit të kësaj kalaje. Siç mund ta shikoni nga fotot, punimet janë bërë shkel e shko. Eshtrë shkullur kalldrëmi origjinal dhe është zëvendësuar me pllaka duke sajuar edhe shkallët. Punimet janë



Në foto: Kalaja e Tepelenës pas restaurimit nga një firmë me president zotin F. Buçpapaj

bere nga një firmë me president zotin Flamur Buçpapaj me disa punëtorë nga Tirana. Kjo është ndërhyrja e vetme në këtë Kala të famshme këto 20 vitet e fundit dhe siç shikohet qartë punimet janë bere për faqe të zezë,

shprehen anëtarët e këtij forumi, ndërkohë që propozojnë se "duke mbajtur ritmin që ka pasur këto kohë mund të bëjnë një lëvizje në media për ta denoncuar edhe këtë ndërhyrje skandaloze ne Kalanë e Ali Pashës.

Kalaja e Tepelenës, e ndërtuar nga Ali Pasha rreth vitit 1819, ka shërbyer jo vetëm si një fortifikatë për banorët dhe luftëtarët e pashit, por së fundi ajo është kthyer në një objekt të rëndësishëm turistik.

Ad.Pe.



Editorial

Të vërtetat (jo)virtuale



NGA ARBEN ROZHANI

vijon nga faqja 1

...tetë vitesh në pushtet. Ide e mirë: Të prekësh me mijëra njerëz në ditë, të thithësh hallet e tyre, të komunikosh, të zonësh dhe të marrësh masa për përmirësimin e jetës së tyre.

Ndonëse jo në këtë mënyrë, me anë të Facebook, por me anë të telefonatave, PD, sipas urdhërave të kryeministrit Sali Berisha, para zgjedhjeve të qershorit 2009, thithi shumicën e halleve të panumërta të

popullit dhe për çdo rast, jepej këshilla se si të premtosej zgjidhja. Mund të duket si të qërosh oriz me doreza boksi, por luftëtari më i paepur në ringun politik në këto 22 vitet e fundit, Berisha, e praktikoi këtë strategji. Se sa u realizua është problem tjetër dhe përgjigjen e japin ato 58 mijë shqiptarë që dërguan sms-të e tyre te numri celular që qeveria Berisha vuri në dispozicion para zgjedhjeve të 28 qershorit 2009.

Po vjen 23 qershori 2013, Berisha po thith sërish hallet në centrifugën e tij të premtimeve. Jo se i do, por se ato vijnë vetë dhe vijnë pa fund. Dje ishte një ditë e veçantë. Me qindra mesazhe vërshuan në profilin zyrtar të kryeministrit Berisha, pasi nxorri statusin për miliarderin Fidel Ylli dhe ndëshkimin që duhet të marrë ai, si "armik i popullit" pranë PD-së. Komentet e popullit po i botojmë gati të tëra te "Shqiptarja.com" dhe, deri mbrëmë, çuditërisht nuk ishin fshirë nga administratorët e

faqes së kryeministrit. Populli real i Sali Berishës e thotë hapur: Nuk do t'ia dijë për Fidel Yllin. Do bukë, punë, ujë, drita. Njëri i thotë me emër dhe mbiemër që para se të akuzojë deputetin e PS-së të shohë të bijën, të sqarojë akuzat ndaj saj për milionat e vënë në rrugë të dyshimta, të shohë ministrat e tij, që kanë zaptuar gjithçka.

Kjo pjesë Shqipërie haleshëmë, është e njohur prej të gjithëve, përvç qeverisë. Ajo prej vitesh është mbyllur në guackën e vet, luksit të Tiranës dhe vizita jashtë vendit, mirëqenies hipotetike të vendit të katërt në botë, rritjes së pandalshme të ekonomisë, Shqipërisë që po vrapon drejt dixhitalizimit, që s'ka hall tjetër, përvç Facebook-un. Kjo pjesë Shqipërie që nuk është pak, si përherë ankohe të Berisha, si pardoni i mirëqenies së saj. Ai nuk po përgjigjet, por kjo nuk do të thotë se nuk mban shënime. Mos të habitemi kur "administratorët" e tij, jo ata profilin në FB që dje nuk fshinë



akuzat dhe hallet, t'i kontaktojnë për t'u premtuar sërish zgjidhjen si para qershorit 2009, ashtu një nga një. Sepse janë vota të bekuara, që për Sali Berishën përkthehen në shtim të mundësive për një mandat të tretë, pra edhe katër vite mbi shqiptarët. Dhe ai nuk bënë asnjë gabim në këtë rast. Gabimi do t'u

mbetej në derë ankuesve, atyre që ende presim qeverisjen. Ata që dje conin sms dhe pas katër vitesh komentojnë në FB-në e Berishës, nëse mashtrohen për herë të dytë nuk është faji i kryeministrit, por i atyre që besojnë zgjidhjen nga një qeveri, që prej vitesh i ka konsideruar një realitet virtual.

Koment

Premtimet elektorale pa këmbë mbi tokë



NGA ADRI NURELLARI

vijon nga faqja 1

... edhe premtimet kanë pasur prirjen që të jenë tejet agresive duke kapërcyer e qendruar vite dritë larg mundësive konkrete për t'vënë ato në jetë. Ky ekzagjerim i skajshëm i premtimeve është mbase edhe një kut matës i papjekurisë së politikës shqiptare e cila ende nuk i kushton vëmendjen e merituar programeve politike dhe platformave elektorale dhe bazohet akoma në pretendime të mëdha që i hedhi hi syve qytetarëve. Aq më tepër që disa prej veprimeve më të rëndësishme për të ardhmen e Shqipërisë mund të materializohen në parlamentin e ri vetëm nëse arrihet një kompromis i gjërë dhe sigurohet shumica e cilësuar.

Tradita e premtimeve populiste pa një bosht të qartë ideologjik dhe pa një angazhim të mirëfilltë programor, duket se po vazhdon edhe më e konsoliduar sivjet dhe po e lë votuesin shqiptar më të hutuar se më parë. Premtimi që më së paku është i realizueshëm nga një parti me vete është padyshim ai që jepet për integrimin. Situata qesharake e tre ligjeve të bllokua nga opozita për hir të një problemi periferik e nxjerr në pah faktin që pa 84 vota

pra pa shumicën e cilësuar vështirë se mund të shkohet përpara. Sikurse e ka dëshmuar tashmë legjislatura që po mbyllet, të qenurit mazhorancë nuk mjafton që të realizohen kushtet që çojnë para në procesin e anëtarësimit dhe është e kotë të thuhet votoni kundër bllokimit apo ne jemi forca e vetme që mund të sigurojë integrimin kur dihet që asnjë parti e vetme nuk ka gjasa që të sigurojë 3/5-at e deputetëve (përvçese nëse ka ndër mend të vjedhë votat dh eta çojë Shqipërinë drejt Kubës e Koresë së Veriut).

Një situatë e ngjashme është edhe me premtimet ekonomike të papërmbyjtura që jepen. Vështirë se mund të realizohen ato premtime për eleminim e varfërisë dhe papunësisë kur dihet që qeverisë shqiptare i kanë ngelur në dorë shumë pak mundësi për të patur të tillë impakt në ekonomi. Jo vetëm sepse ne shteti ynë ka privatizuar të gjitha ndërmarrjet e mëdha dhe ka pak instrumente në dorë për të sjellë ndryshim. Pra përtej politikave fiskale e monetare në dorën e qeverisë për ta përmirësuar ekonominë shqiptare duhen zgjidhur problem shumë më të mëprehta që kërkojnë edhe konsensusin e opozitës. Kështu nuk mund të flitet për një ekonomi të zhvilluar në vendin tonë nëse nuk përmirësohet zbatueshmëria e ligjit në vendin tonë gjë që kërkon reformim të sistemit të drejtësisë, zgjidhjen njëherë e mirë të problemit të pronës, përmirësimin e bazës ligjore për sa i përket veprimtarive ekonomike. Në këtë aspekt vota e opozitës, cilado që ajo do të jetë, është e domosdoshme për të mundësuar kësilloj reformash legjislative që kërkojnë shumicë të cilësuar. Për mos të folur pastaj që edhe ndryshimet ligjore nuk mund të kenë



impakt të menjëhershëm nëse nuk përmirësohet ndjeshëm administrata përkatëse dhe rritja e efikasitetit dhe profesionalizimit të administratës në vetëvete është një proces i gjatë dhe i mundimshëm.

Një pjesë dërrmuese e problemeve ekonomike të sotshme që hasin shqiptarët nuk vijnë vetëm nga përgjegjësia politike e qeverisë apo dobësia e institucioneve shtetërore por edhe nga kriza globale dhe rrethanat në të cilat gjenden tregjet ndërkombëtare. Po ashtu sjellja e gabuar konsumatore dhe mungesa e kapaciteteve sipërmarrëse janë po aq të dëmshme për sa i përket gjendjes ekonomike dhe këto të fundit duan shumë kohë që të ndreqen.

Prandaj do të nevojiteshin premtime ekonomike të realizueshme të mbështetura në një njohje të mirë të realitetit dhe potencialit tonë dhe në plane veprime e hapa konkretë që janë me të vërtetë të zbatueshëm. Është e pandershme që publikut shqiptar t'i premtohen qiçira në hell.

Premtimet më ekstravagante janë ato që premtojnë bashkimin e menjëhershëm territorial të copëve të ndryshme të kombit, të cilat jo vetëm që tallen me ndjenjat patriotike dhe ushqejnë me iluzione shumë qytetarë që e kanë ëndërruar një Shqipëri etnike në territoret e asaj të shpallur prej Ismail Qemalit, por edhe na vë në pozitë të vështirë me aleatët tanë ndërkombëtarë. Kur

dihet që parti të mëdha si PD apo PS nuk mund të realizojë dot pa konsensus një reformë apo një ligj në parlament, si mund të pritet që një parti e sapokrijtur të marrë aq shumë mbështetje sa të rrëzojë elitën aktuale politike shqiptare dhe të përmbyjë një konjunkturë të tërë ndërkombëtare për sa i përket copimit të trojeve etnike shqiptare. Në raste të tilla propozimet politike për një bashkim tak-fak Shqipëri-Kosovë tregojnë se disa demagogë janë me të vërtetë duke fluturuar me presh arihnes dhe retorika populiste po kalon kufijtë e fantashkencës.

Pavarësisht se kush do të fitojë në zgjedhjet e ardhshme, ajo që dihet është se vendi vuan nga problema aq të thella sa në mënyrë të pashmangshme nevojitet bashkëpunimi i rivalëve politikë për të mundësuar ato reforma e ndryshime që mund të adresojnë këto probleme. Është e pandershme që t'u thuhet votuesve se duke ngjeshur radhët në llogore, duke luftuar dhëmbë për dhëmbë me kundërshtarin dhe duke vazhduar me klimën e konfliktimit, bllokimit dhe revanshit do të jetë e mundur që Shqipëria të ecë përpara. Edhe po të ketë rotacion, mazhorancës së re do t'i duhen dendur votat e opozitës së ardhshme për të sjellë ato reforma thelbësore që do ia çlirojnë potencialin e zhvillimit vendit tonë. Pa një klimë bashkëpunimi dhe përfshirjen e shumë aktorëve nuk do të mund të votohet integrimi apo reformat të tjera që lidhen me drejtësinë, administratën, aspiratën kombëtare shqiptare dhe një radhë të gjërë sfidash që ne kemi për të ardhmen. Sot nevojitet prej partive politike që të qëndrohet me këmbë mbi tokë me premtimet dhe të mendohet seriozisht për platforma zgjedhore të vërteta e të realizueshme.


PARADE

FJALEKRYQESH

MINGA Kadri Vokopola



FJALEKRYQI SPORTIV



HORIZONTAL

1. Eshhtë vija e portës.
6. Campbell mbrojtës.
9. Ajri i Loondrës.
12. Ka merituar medakje e artë.
13. Lippi trainer.
15. Fillojnë rethimin.
16. Mema ish-mesfushor bardheblu.
17. Gjysmë tati.
19. Felix trainer gjerman.
24. Role pa çifte.
26. Bryan te Lakers.
29. Personazhi në foto.
33. Organizma Sportive Autonome.
34. Personazhi në foto.
38. Alain që thirret "Profesori".

VERTIKAL

1. Makina UNO.
2. Të parat në apel.
3. Kreshniku i volejbollit.
4. Gjysmë arrest.
5. Fillojnë lidhjen.
6. Sapo fillojnë.
7. I keni në dorë.
8. Louise Colet.
9. Para blacks për lojtarët e Zelandës së re në rugby.
10. Daja trainer.
11. Fillojnë romanin.
13. Indurain, ish-kampion i biçikletës.
14. Ente Autonome.
18. Ziu, ish-mbrojtës i

Partizanit.

19. Kuteli shkrimtar.
20. Minga i paharuar i futbollit tonë.
21. Mund të jetë i kondicionuar.
22. Taksit pa çifte.
23. Lika trainer.
25. Lajme kur nuk... je.
26. Një... shënohet nga pivot.
27. Një pjesë e oshëtimës.
28. Skuadra e "Robbery".

30. Vucinic te Juventus.

31. Ndoth në kufij.
32. Diftong në dialog.
34. Fundi i Loreley.
37. Qerre pa qe.
38. Fillojnë pohimin.
39. Fundi i Turandot.
40. Fillojnë sette.
42. Teze pa binjake.
43. Diftong për leader.

PËRGJIGJA E FJALEKRYQIT SPORTIV



FJALEKRYQI PA SKEME

DUHET TË NXINI 32 KUTI

	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13	14	15	16	17	
1																		
2																		
3																		
4																		
5																		
6																		
7																		
8																		
9																		
10																		
11																		
12																		

HORIZONTAL

1. Eshhtë gjakatar ai i diktatorëve despotikë.
- Ahmeti poete.
- Ekstre me kamp.
2. Janë edhe ato kozmike.
- Jack i beat generation.
- Iniciale e Altman.
3. Një mund të jetë fetar.
- Janë si kasolle.
- Gjysma e harkut.
4. Mbyllin fushatat.
- Eshhtë Kisha.
5. Janë shenja godijfjesh.
- Ishin pallate të beut.
6. Janë diktatorë despotikë.
- Një lloj njeriu.
- Gibernau motogjokist.
7. Kanë salla me ekran të madh.
- Mund të nxirren me duf.
8. Markarian e Në dog slinë.
- Mali ku ngeci Arka.
- Iniciale e Summer që qe këngëtare.
9. Janë kulla në xhami.
- Janë të parë në manstire.
10. Gjysmë alarmi.
- Mbyllin një tender.

VERTIKAL

1. Bernihard që qe aktore.
- Një si divan.
2. E prishin fraksionet.
- Chaney që qe aktor.
3. Ndërmonje Industriale Transë.
- Eshhtë temperatura më e ulët.
4. Fillojnë djathtas.
- Franco, ish-as i Milan.
- Iniciale e Asimov.
5. Diftong në dietë.
- Janë kapo kozakë.
6. Kufizojnë matjet.
- Eshhtë edhe ajo e rreptësisë.
- Këndohet në opera.

12. Zanore për trotuar.

- Mund të jenë fotografikë.
13. Zyrë Autonome Transporti.
- Një mund të jetë klasifikimi.
14. Iniciale e Carnus.
- Kanë shirit për të regjistruar këngë.
15. Janë plot mjalte në koshere.
16. Kush i kthen... braktis.
- Bo aktore.
17. Duhet fituar me djersë.
- Oliver regjisor.

PËRGJIGJA E FJALEKRYQIT PA SKEME



FJALEKRYQI I KRIPTOGRAFUAR

SHKRONJA E NJËJTË PËR NUMËR TË NJËJTË

	14		10		5	5		11	2	A	R	14	K
5	2	1	3	4	6	2		3	7	1	3		
3	9	3	5	3	7	1	2	4	3		4		
5	6	9	6	5	3	1	4	6	14	3			
2		3	4				2	11	10			10	
1	6	11	2	4	3	1		3		3	19		
	14	2	5	2	1	2		16	3	11	6		
5	15	1	6	18	6			5	6	10	6	4	
2		6	17	3		5	5	1	3	10	6		
16	5		2	9	5	2		3		15	1		
3	6	7			16	7	7		15	17	2		
1	2	11		18	2	7	17	2	9	3	1		

PËRGJIGJE E NUMRIT TË KALUAR

B	A	R	I	K	K	I	M	I	K
A	B	I	P	A	M	O	R	E	O
L	A	P	S	L	I	M	R	O	M
E	T	A	D	E	R	T	I	M	I
R	I	H	E	M	A	T	O	M	A
I	H	A	B	A	N	E	R	A	E
N	E	R	A	D	A	N	E	T	
A	R	B	I	R	A	L	G		
T	A	R	A	N	L	A	K	T	
K	A	N	T	A	T	A	T	R	A
A	I	A	G	A	B	A	I	R	
P	A	K	R	R	E	N	I	M	E

HOROSKOPI nga zozja MERI



DASHI

Sot do jetë një ditë e ngjeshur me shumë veprimtari. Jeta juaj mund të marrë një këthesë e cila me sa duket ka shumë mundësi të ketë të bëjë me punën por dhe me mënyrën se sip o oranzoni jetën tuaj të përditshme.



DEMI

Ka shumë mundësi që situatat në lidhje me marrëdhënien tuaj me partnerin në çift të përmirësohen dukshëm përsa i përket planifikimit apo vendimeve të rëndësishme që do merrni në këtë drejtim.



BINJAKET

Një përmirësim të dukshëm në çështjet familjare, do keni takime apo organizoni festa të rëndësishme. Në lidhje me karrierën apo punën do dëgjoni çështje që me sa duket nuk do jenë shumë të këndshme.



GAFORRJA

Dita e sotme premtan një veprimtari më të zgjeruar në fushën e planeve takimeve apo lagjeve të cilat do jenë shumë favorizuese për ju. Keni në dorë fillime të reja prandaj shfrytëzoni mirë njohjet e këtyre ditëve.



LUANI

Sot do vazhdoj për ju të ketë rëndësi në çështjet ekonomike. Jo vetëm do fillët për shpenzime por do keni mundësinë të ndihjeni më të sigurt edhe në lidhje me të ardhurat. Në aspektin sentimental gjërat do marin një drejtim shumë pozitiv.



VIRGJËRRESHA

Hëna dhe Merkuri në shenjtën tuaj ju gjallërojnë si në komunikim, edhe në psikologjinë tuaj. Shumë fat dhe lehtësira do sjell dita e sotme dhe sidomos në lidhje me punën dhe çështje të rëndësishme ligjore dhe familjare.



PESHORJA

Nuk do ju gjej shumë të gatshëm në lidhje me planit tuaja apo në lidhje me ndryshimet që keni menduar të bëni sidomos në aspektin e punës. Në lidhje me shoqërinë daljet apo erotizmin gjërat ecin në mënyrë më të ekuilibruar.



AKREPI

Miq dhe shokë të rinj pranë jush dhe kjo sjell si pasojë ringritje në aspektet e detyrave dhe qëllimeve që do ti vini vetes. Do keni propozime të rëndësishme pune të cilat duhet ti shikoni me përparësi pasi do kenë zgjidhje.



SHIGJETARI

Për ju do ketë rëndësi karriera si dhe lagjeve të mira që mund të vijin nga takime apo kontakte me njerëz të rëndësishëm. Do keni mundësinë e udhëtimeve të cilat jo vetëm do jenë qetësuese por edhe frymëzuese për projektet e së ardhmes.



BRICJAPI

Miq shokë dhe qëllime nga më të rignjeruarat do ketë. Takim me një person të rëndësishëm do sjell një këthesë në jetën tuaj të deritanishme sidomos përsa i përket aleancave. Në aspektin erotik ju prë një ditë e mrekullueshme.



UJORI

Dita e sotme me sa duket ka shumë imenijme në planet ekonomike si dhe balancë në jetën sentimentale apo botën tuaj të brendshme. Shpirtërisht do donit të merrim vendime por kjo nuk ndodh për sa kohë nuk pajtoheni me ndjenjat tuaja.



PESHQIT

Keni një ditë e cila mund të quhet përparësia e titaneve, i përket marrëdhënieve me të tjerët. Do keni njerëz të fuqishëm përball, ju jeni bindës në qëndrimet tuaja. Kjo nuk duhet tju pengoj të beheni tolerant.

SUDOKU

	5	8					4	1	
			5		8				
	3	2	1	7	4	5	6		
3	8			2			4	6	
	6	7		8			2	3	
4			7		6				1
2	7			1			8	5	
8					5				4
		6					3		

PËRGJIGJE E NUMRIT TË KALUAR

5	8	9	4	2	1	7	3	6
4	6	2	5	7	3	8	1	9
7	3	1	8	9	6	2	5	4
8	9	3	2	4	5	6	7	1
6	1	7	3	8	9	5	4	2
2	4	5	1	6	7	9	8	3
1	2	6	7	5	4	3	9	8
9	5	4	6	3	8	1	2	7
3	7	8	9	1	2	4	6	5

**LAJME
NGA BOTA**

■ Greqia, e gjitha në grevë
Greqia është përfshirë përsëri nga një valë grevash në sektorë të ndryshme të vendit. Nga mëngjesi i së enjtes në grevë 24 orëshe ndodhen drejtuesit e mjeteve të sherbitit publik, te autobuseve, tramvajit, trenave dhe disa pjesëve të metrose së kryeqytetit. Gjithashtu spitalet do të punojnë me personel sigurie. Unioni i Sindikatave të sektorit publik ka ndaluar punën për disa orë në shenjë solidarizimi me sindikatat e mjekëve dhe të nënpunësve spitalore.

■ Cameron viziton Libinë, takime me ministrant
Kryeministri David Cameron ka mbërritur në Libi, në etapën e dytë të turit të tij në Afrikë. Ai udhëtoi në kryeqytetin Tripoli pasi përfundoi vizitën në Algjeri. Downing Street kërkoi mosinformimin e mediave për vizitën në Libi për arsye sigurie, bën të ditur rrjeti informativ britanik, BBC. Kryeministri ka ecur në Sheshin e Martirëve në Tripoli, pasi ka folur me rekrutët e policisë libiane, të cilët po trajnohen nga kolegët britanikë.

■ Clarke: Dalja nga BE, gabim fatal
Braktisja e Bashkimit Evropian do të ishte një "gabim fatal" për Mbretërinë e Bashkuar ka deklaruar ish-kancelari Ken Clarke. Zoti Clarke, aktualisht ministër pa portofol, thotë se çështja e qëndrimit të Britanisë në BE dhe përfitimëve të saj duhet të bëhet "më e fortë dhe më koherente". "Ka pasur mundësi për një përfitim të madh nëse Britania do të ishte fokusuar në çështje me rëndësi", ka thënë Clarke. Nga ana tjetër, euroskeptikët dhe konservatorët thonë se zoti Clarke nuk është në të njëjtin hap me partinë dhe publikun për sa i përket nevojës për një referendum.

■ Trafiku i njerëzve, 103 të arrestuar në Europë
103 persona në 10 shtete të ndryshme europiane u vendosën në pranga gjatë javës, në një prej operacioneve më të mëdha të koordinuara të historisë, në luftën kundër trafikut të qënieve njerëzore. Operacioni madhor, i cili përfshiu mbi 1 200 forca policore, u konkretizua me arrestime në Kosovë, Francë, Gjermani, Greqi, Republikën Çeke, Poloni, Hungari, Sllovaki, Kroaci dhe Turqi.

■ SHBA, 6 shtete nën "mëshirën" e tornadove
Tornado dhe erëra të fuqishme janë duke shkatëruar dëme të mëdha materiale në shtetin e Xhorxhias dhe pesë shtete të tjera amerikane, raportuan mediat dje. Me dhjetëra makina janë përmbytur, shtylla elektrike janë rrëzuar dhe pemë të panumërtat janë shkulur, nga stuhia që ka përfshirë një zonë rreth 1 500 kilometra katrorë, që prej orëve të para të mëngjesit.

■ Skandal korrupsioni për kryeministrin spanjoll
Një ditë pasi të dhënat e përkeqësuar mbi ekonominë detyruan Parlamentin Spanjoll të thërriste një seancë të jashtëzakonshme për të kërkuar gjetjen e një zgjidhje për stimulimin e ekonomisë, gazeta me tirazhin më të madh në vend, e përditshmeja "El País", publikoi një afër korrupsioni që përfshin deri kryeministrin Mariano Rajoy. Sipas provave të gazetës, që publikoi një buletin faqesh të shkruara me dorë, vërtetohet me imtësi skema e përvetësimit të parave shtetërore dhe fshesjes së të ardhurave nga taksat, në dobi të disa drejtuesve të Partisë Popullore në pushtet.

■ Bllokimi i fondeve, Polonia kundër BE-së
Zyrtarët polakë shprehën "zhgënjimin e tyre të thellë" ndaj një vendimi të Bashkimit Evropian, i cili bllokoi projekte me vlerë prej pothuajse një miliard euro të financimit të përmirësimit të infrastrukturës rrugore të vendit. Brukseli vendosi të bllokonte pjesëmarrjen në projektet e Varshavës zyrtare në bazë të dyshimeve për korrupsion dhe përvetësim të paligjshme të fondeve.

DIGITALB

**TOKESORE
KANALI 48**

*Do na ndiqni në
gjithë Shqipërinë*

DIGITALB

**SATELITOR
KANALI 50**

*Do na ndiqni në gjithë Shqipërinë,
Maqedoni, Kosovë, Itali, Greqi
dhe në pjesën tjetër të Europës*

VALË UHF

**NË PREFEKTURAT:
TIRANE - DURRES - LEZHE - FIER**



kasketa

nga **KASTRO ZIZO**

**cdo të mërkurë
dhe të shtunë
ora 23:00**

NË TELEVISIONIN

A1 REPORT!

Origjina e Lajmit

• Alba Malltezi
Drejtoreshë e Përgjithshme
e Free and Fair Media Group

• Anila Basha
Drejtoreshë e Shqiptarja.com
• Arben Rrozhani
Kryeredaktor

• Genc Kondi
Zv. Kryeredaktor

Politika: Jakin Marena
Ekonomia: Genc Kondi
Sociale: Esmeralda Keta
Kulturë: Admirina Peçi

Design: Altin Aliaj
Genti Manelli
Website: Suela Gera
Indrit Maraku

Departamenti i Marketingut:
Cel: +355696060419
marketing@shqiptarja.com

Shpërndarja:
Saimir Zenelaj
cel: +355696060418
Ermal Kacaniku
cel: +355696088847